



AUTORITETI I MBROJTJES FINANCIARE

2022

Raport Vjetor

© 2023

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi jeni të lutur të citoni AMF.

Për çdo informacion të mëtejshëm, ju lutemi na kontaktoni.

Adresa: Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10, Tiranë

Tel: +355 4 2251 355/6

Faks: +355 4 2250 686

E-mail: amf@amf.gov.al

URL: www.amf.gov.al



Mesazhi i Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv	5
Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare	7
Bordi i Autoritetit	8
Përmbledhje Ekzekutive: Ngjarjet kryesore të vitit 2022	9
Negociatat me Bashkimin Evropian - Roli i AMF-së në Procesin e Integritit	14
Kapitulli 1	
ECURIA E TREGJEVE NËN MBIKËQYRJE	16
1.1 Tregu i Kapitalit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive	16
1.2 Tregu i Sigurimeve	21
1.3 Tregu i Fondeve të Pensioneve Vullnetare	24
Kapitulli 2	
AKTIVITETI MBIKËQYRËS	25
2.1 Mbikëqyrja e Tregut të Kapitalit e Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive	25
2.1.1 Pozicioni Financiar	25
2.2 Mbikëqyrja e Tregut të Sigurimeve	30
2.2.1 Pozicioni Financiar	30
2.2.2 Inspektimet	38
2.2.3 Mbikëqyrja e Grupeve	41
2.2.4 Provigjonet Teknike	42
2.2.5 Risigurimet	46
2.2.6 Ecuria e Fondit të Kompensimit	50
2.3 Mbikëqyrja e Tregut të Fondeve të Pensionit Vullnetar	53
2.3.1 Pozicioni Financiar	53
2.3.2 Inspektimet	58
Kapitulli 3	
AKTIVITETI RREGULLUES DHE LICENCUES	59
3.1 Rregullimi i Tregut të Fondeve të Pensionit Vullnetar	59
3.2 Rregullimi i Tregut të Kapitalit e Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive	60
3.3 Licencimi dhe Qeverisja	63
3.3.1 Tregu i Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive	63

3.3.2	Tregu i Kapitalit	67
3.3.3	Tregu i Sigurimeve	68
3.4	Masat Mbikëqyrëse dhe Administrative	72
Kapitulli 4		
BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL		74
4.1	Parandalimi i Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit	74
4.2	Bashkëpunimi Rajonal dhe Ndërkombëtar	75
4.2.1.	Memorandume Mirëkuptimi gjatë vitit 2022	75
4.2.2.	Bashkëpunime me Autoritete Homologe	77
4.2.3.	Bashkëpunimi me Organizata Ndërkombëtare dhe Rregullatore	79
4.3	Projekte	81
4.4	Bashkëpunimi me Institucionet e Vendit	86
Kapitulli 5		
MBROJTJA KONSUMATORE DHE TRANSPARENCA ME PUBLIKUN		87
5.1	Mbrojtja e Konsumatorit dhe Investitorit	87
5.2	Monitorimi i Ndërmjetësve Financiarë	89
5.3	Edukimi Financiar	90
5.4	Transparenca dhe Marrëdhëniet me Publikun	93
Kapitulli 6		
ORGANIZIMI INSTITUCIONAL		95
6.1	Burime Njerëzore	95
6.2	Sistemet e Teknologjisë së Informacionit	97
6.3	Auditi i Brendshëm	100
STRATEGJI DHE OBJEKTIVA		102
SHTOJCA		
A.	Struktura Organizative e AMF-së	105
B.	Raport i Audituesit të Pavarur	106



Në tërësi, për vitin 2022 edhe pse një vit i shoqëruar me pasiguri e luhatje, tregjet nën mbikëqyrjen e Autoritetit u paraqitën të qëndrueshëm sa i përket treguesve kryesorë të shëndetit financiar. Autoriteti ka treguar vëmendje të shtuar, duke ushtruar monitorim të kujdesshëm, marrë në konsideratë efektet e faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në tregjet financiare.

Viti 2022 ishte një vit i rëndësishëm në procesin e integritimit evropian. Me hapjen zyrtare të negociatave për Shqipërinë, Autoriteti, si institucioni drejtues i kapitullit 9 “Shërbimet Financiare” udhëhoqi grupin negociator në takimet me Komisionin Evropian, ku u prezantua niveli i përafrimit ligjor e rregullator me *acquis* të BE-së. Gjatë viteve të fundit është bërë një avancim domethënës i kuadrit ligjor, i nënvizuar edhe në vlerësimet e bëra në Progres Raportin e Komisionit Evropian.

Autoriteti ka thelluar bashkëpunimin me rregullatorët evropianë, si edhe organizatat ndërkombëtare, me qëllim avancimin e mëtejshëm në standardet e mbikëqyrjes dhe rregullimit të tregjeve. Në vlerësimin e përputhshmërisë me Parimet Themelore në Sigurime, të realizuar nga Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve në Sigurime (IAIS), Autoriteti rezultoi të ketë bërë përparim të ndjeshëm drejt standardeve ndërkombëtare, referuar akteve ligjore e nënligjore, praktikave mbikëqyrëse, procedurave të licencimit, si edhe pavarësisë institucionale.

Gjatë vitit 2022, tregu i sigurimeve vijoi konsolidimin e treguesve kryesorë financiarë, rritje të primeve të shkruara bruto dhe rritje të dëmeve të paguara në numër e në vlerë. Raporti i numrit të dëmeve pezull kundrejt totalit të dëmeve të raportuara në tregun e Jo-Jetës zbriti në nivelin më të ulët historik. Gjithashtu, u shënuar rritje e aktiveve dhe provigjoneve, si edhe përmirësim i mëtejshëm i treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit.

Ligji i ri për sigurimin TPL ka dhënë ndikim të konsiderueshëm në treg, duke sjellë uljen e shpenzimeve të marrjes në sigurim, reduktimin e praktikave të mbartura të Fondit të Kompensimit, ku ndikim pati edhe aplikimi i siguruesit të drejtpërdrejtë, si edhe përdorimin e Raportit Evropian të Aksidenteve për rreth 23% të rasteve të dëmeve të trajtuara. Ndërhyrjet ligjore sollën gjithashtu përmirësim të ndjeshëm të situatës me Byronë Shqiptare të Sigurimit, e cila doli nga monitorimi thuasje 10-vjeçar i Këshillit të Byrove.

Tregu i fondeve të investimit rezultoi më i prekuri nga cikli i shpejtë i rritjes së normave të interesit gjatë vitit të kaluar, gjë që ndikoi sjelljen e investitorëve. Ndërkohë, u shënuar rritje me 180% e pjesëmarrjes së investitorëve joprofesionistë



Ervin Mete

Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv
Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare


në ankandet për blerjen e titujve të Qeverisë. Fondet private të pensionit vijuan rritjen si në vlerë asetesh, ashtu edhe në numër anëtarësh. Ligji i ri që pritet të miratohet nga Kuvendi synon t'i japë më shumë zhvillim këtij tregu.

Vëmendje iu kushtua forcimit të kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit, si edhe mbështetjes së zhvillimit të tregjeve nën mbikëqyrje përmes rritjes së ndërgjegjësimit dhe njohurive financiare. Autoriteti organizoi për këtë qëllim dy konferenca ndërkombëtare mbi nevojën e diversifikimit të sistemit financiar përmes zhvillimit të tregjeve të kapitalit, si edhe zhvillimin e financave të gjelbra në Shqipëri. Modernizimi i tregjeve, si edhe avancimi i digjitalizimit dhe praktikave të gjelbra konsiderohen prioritetet strategjike dhe ndërsektoriale të Autoritetit, të nënvizuara edhe në Strategjinë 2023-2027 të institucionit.

Gjatë vitit 2023, Autoriteti do të përmbyllë miratimin e kuadrit rregullator në zbatim të ligjeve të reja, si edhe do të vijojë me përafrimin e mëtejshëm me direktivat evropiane. Do të synohet nisja e zbatimit të udhërrëfyesit për implementimin e *Solvency II*, avancimi i mëtejshëm drejt mbikëqyrjes së plotë me fokus rrezikun për të gjitha tregjet, si edhe modernizimi i sistemeve të raportimit, si edhe proceseve të tjera të digjitalizimit duke u ardhur më shumë në ndihmë qytetarëve.

Evin METE

Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv





Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) u krijua në bazë të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, si institucion juridik publik, i pavarur në ushtrimin e kompetencave të tij, që raporton në Kuvendin e Shqipërisë.

Ai licencon, rregullon dhe mbikëqyr aktivitetin e tregut të sigurimeve, tregut të letrave me vlerë, tregut të fondeve të pensioneve vullnetare dhe operatorëve të tyre, si dhe veprimtari të tjera financiare jobankare.

Misioni themelor i Autoritetit është të sigurojë funksionimin efektiv të tregjeve financiare jobankare nën mbikëqyrje, si dhe stabilitetin, promovimin dhe zhvillimin e tyre. Përmbushjen e misionit të tij, Autoriteti e ushtron me anë të funksionit rregullativ dhe mbikëqyrës. Objektivi parësor i Autoritetit është mbrojtja e interesave të konsumatorit dhe investitorit. Në ushtrimin e veprimtarisë rregullative dhe mbikëqyrëse, AMF udhëhiqet nga parimet dhe normat e pavarësisë, transparencës dhe integritetit.

BORDI I AUTORITETIT

Në vitin 2022, Bordi i Autoritetit përbëhej nga:

Kryetar:	Z. Olsi Çoku,	Kryetar Bordi, Anëtar Joekzekutiv
Anëtarë:	Z. Ervin Mete,	Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv
	Znj. Mimoza Kaçi,	Nëndrejtor Ekzekutiv
	Z. Ildir Gjata,	Anëtar Joekzekutiv
	Z. Deniz Deralla,	Anëtar Joekzekutiv

Funksionet dhe kompetencat e Bordit të AMF-së janë parashikuar në Ligjin nr. 9572, datë 03.7.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar. Në zbatim të tij, Bordi miraton politikat e strategjitë e zhvillimit të Autoritetit dhe të tregjeve nën mbikëqyrje, si edhe aktet nënligjore për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e këtyre tregjeve, institucioneve e personave që ushtrojnë veprimtari në tregjet financiare jobankare që mbikëqyren nga Autoriteti.

Gjatë vitit 2022, Bordi ka zhvilluar 14 mbledhje dhe ka marrë 259 vendime. Vendimet që lidhen me tregun e sigurimeve zënë numrin më të madh të vendimeve të miratuara. Bordi i ka kushtuar vëmendje edhe zhvillimit të tregjeve të tjera si ai i sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe tregut të titujve, për të cilat janë marrë vendime të rëndësishme për këto tregje.

Duke e cilësuar plotësimin e kuadrit rregullator për tregjet nën mbikëqyrje si një ndër prioritetet e punës së tij, Bordi i Autoritetit ka miratuar 3 rregullore të reja, 1 manual, si dhe ka ndryshuar 12 rregullore dhe 1 manual ekzistues.

Tabelë 1: Ndarja e vendimeve të Bordit të AMF-së gjatë vitit 2022 sipas llojit të vendimit

Llojet e vendimeve	Numër
Vendime për shoqëritë që veprojnë në tregun e sigurimeve	121
Vendime për Bursën dhe shoqëritë që veprojnë në tregun e letrave me vlerë	30
Vendime për shoqëritë që veprojnë në tregun e pensioneve private vullnetare dhe SIK	40
Vendime për bashkëpunimin institucional	2
Vendime për masa administrative e korigjuese ndaj subjekteve të mbikëqyrura	35
Vendime për kuadrin rregullues të AMF-së dhe tregjeve të mbikëqyrura	31
Vendime në tërësi	259



Tregjet nën mbikëqyrjen e Autoritetit, gjatë vitit 2022, ishin të qëndrueshëm sa i përket treguesve kryesorë të shëndetit financiar, duke konsideruar edhe efektet e faktorëve të brendshëm e të jashtëm. Autoriteti ushtroi kujdes të shtuar monitorues, duke vlerësuar në vijimësi ecurinë e këtyre tregjeve, si edhe duke ndërhyrë përmes masave në funksion të garantimit të stabilitetit financiar, ruajtjes së shëndetshmërisë dhe mbrojtjes së investitorëve dhe personave të siguruar.

Gjatë vitit 2022, totali i aseteve në tregjet nën mbikëqyrjen e Autoritetit pësoi tkurrje në rreth 96 miliardë lekë, kryesisht nën ndikimin e rënies së fondeve të investimit, si pasojë e rritjes së normave bazë të interesit. Megjithatë, tregu më i madh nën mbikëqyrjen e Autoritetit mbetet ai i fondeve të investimit, i cili përbën rreth 49% të totalit të aseteve të tregjeve.

Viti 2022 ishte një vit i rëndësishëm për Autoritetin në procesin e avancimit të mëtejshëm ligjor e rregullator, në kuadër të integritit evropian, hapjes së negociatave dhe kryesimit të Kapitullit 9 “Shërbimet Financiare”. Autoriteti drejtoi në Bruksel grupin negociator për Kapitullin 9, duke realizuar fillimisht procesin e *screening* lidhur me bazën ligjore e rregullatore, pasuar nga takimi bilateral i mbajtur në datat 13-14 shkurt 2023. Në këtë takim u prezantua në mënyrë të detajuar niveli i përafrimit të kuadrit ligjor e rregullator të tregjeve financiare me direktivat evropiane të fushës. Ekspertët e Komisionit Evropian vlerësuan progresin e bërë dhe angazhimet e marra në Kapitullin 9, sa i përket plotësimit të rekomandimeve dhe përafrimit të *acquis* në fushën e shërbimeve financiare.

Autoriteti komplotoi më tej bazën rregullatore, në zbatim të ligjeve të reja në tregjet nën mbikëqyrje, të përafruara me direktivat evropiane të fushës. Gjithashtu, AMF përfundoi hartimin e projektligjit “Për fondet e pensionit privat”, duke e përafruar atë në një masë të konsiderueshme me Direktivën (BE) 2016/2341 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit datë 14 dhjetor 2016 “Për veprimtaritë dhe mbikëqyrjen e institucioneve të pensionit profesional (IORP II)”. Projektligji “Për fondet e pensionit privat” me Vendimin Nr. 578, datë 12.12.2022 të Këshillit të Ministrave është propozuar për shqyrtim dhe miratim nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

Autoriteti iu nënshtroi gjatë vitit 2022 një procesi rigoroz vlerësimi nga Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS), në lidhje me përputhshmërinë e standardeve dhe praktikave të AMF-së, me Parimet Themelore në Sigurime (ICP). Grupi vlerësues i ekspertëve ndërkombëtarë mori në shqyrtim aspektin ligjor e rregullator, pavarësinë institucionale, praktikat mbikëqyrëse dhe ato të vlerësimit të rrezikut, procedurat e licencimit, mbikëqyrjen e grupeve të sigurimit, etj.

Në draft raportin e vlerësimit të përgatitur nga grupi i vlerësimit të IAIS-it, rezultoi përgjithësisht një nivel i lartë i përputhshmërisë me ICP-të, ku nga 24 parime bazë, 10 prej tyre rezultuan plotësisht të përputhura (*Observed*) me parimet ndërkombëtare dhe 12 të tjera me një nivel të lartë përputhshmërie (*Largely observed*). Ky vlerësim përbën një avancim të ndjeshëm kundrejt rezultateve të vlerësimit të vitit 2014, të kryer nga Banka Botërore dhe FMN, në kuadër të Programit të Vlerësimit të Sektorit Financiar (FSAP), ku vetëm një parim bazë rezultoi plotësisht i përputhur (*Observed*) me parimet ndërkombëtare.

Raporti përfundimtar i vlerësimit të përputhshmërisë me parimet bazë ndërkombëtare në sigurime, do të miratohet nga Komiteti Ekzekutiv i IAIS-it gjatë vitit 2023. Në linjë me rekomandimet e raportit përfundimtar të vlerësimit nga IAIS, Autoriteti do të angazhohet në rishikimin e kuadrit ligjor e rregullator në fushën e sigurimeve, me synim përafrimin e mëtejshëm me Parimet Themelore në Sigurime.

Tregjet financiare nën mbikëqyrjen e Autoritetit, edhe në fund të vitit 2022, paraqiten të mirëkapitalizuar dhe me tregues të mirë të shëndetshmërisë financiare.

Në tregun e sigurimeve u shënua një përmirësim i mëtejshëm i treguesve financiarë kryesorë që monitorohen nga Autoriteti. Aktivitetet e tregut të sigurimeve u rritën me rreth 3 miliardë lekë, ose 7.3% më shumë se në vitin 2021. Rritje u shënua edhe sa i përket nivelit të provigjoneve teknike me rreth 1.7 miliardë lekë, ose 7.7% më shumë sesa viti 2021. Përmirësim kanë shënuar edhe tregues të tjerë të shoqërive të sigurimit, si rezultati financiar, raporti dëme/prime, treguesi i mbulimit të provigjoneve teknike me aktive të përshtatshme për shoqëritë e sigurimit të Jo-Jetës, etj.

Tregu i sigurimeve e mbylli vitin 2022 me një rritje prej 9.2% të primeve të shkruara bruto, duke arritur në rreth 21 miliardë lekë të ardhura. Rritje shënuan edhe dëmet e paguara, si në vlerë ashtu edhe në numër, gjë që solli një reduktim të dëmeve të mbajtura pezull nga shoqërisë e sigurimit. Në tregun e sigurimeve të Jo-Jetës, numri i dëmeve pezull, në raport me numrin e dëmeve të raportuara nga shoqëritë e sigurimit, rezultoi të jetë në nivelin më të ulët historik në fund të vitit 2022. Nga analizimi i të dhënave të dëmeve, rezultoi se në fund të vitit 2022 dëmet pezull përbëjnë vetëm 13.4% të numrit total të dëmeve të raportuara.

Monitorimi i Byrosë Shqiptare të Sigurimit (BShS) ka qenë në fokus të Autoritetit, veçanërisht gjatë viteve të fundit, për t'u dhënë zgjidhje problematikave të mbartura ndër vite. Adresimi i tyre ishte një nga objektivat kryesore të Ligjit të ri 32/2021 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit".



Gjatë vitit 2022, problematikat e Fondit të Kompensimit kanë ardhur drejt eliminimit me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 32/2021, nga ku rezulton se 87% e aksidenteve të shkaktuara nga mjetet e pasiguruara, ose të paidentifikuara, janë trajtuar dhe paguar me procedura të përshpejtuara drejtpërdrejt nga shoqëritë e sigurimit. Gjithashtu, bazuar në shifrat e raportuara nga shoqëritë e sigurimit dhe BShS për dëmet e ndodhura pas datës 1 korrik 2021, objekt i Fondit të Kompensimit, asnjë prej tyre nuk është ankimuar në gjykatë.

Ndryshime të tjera ligjore që kanë pasur ndikim të rëndësishëm në përmirësimin e situatës së BShS, janë edhe krijimi i Fondit të Garancisë për Kartonin Jeshil dhe për Fondin e Kompensimit, mbajtja e provigjoneve për dëmet pezull të Fondit të Kompensimit, riorganizimi i Byrosë, etj. Përmirësimi i situatës solli edhe vendimin e Këshillit të Byrove për të nxjerrë nga monitorimi thuajse 10-vjeçar Byronë Shqiptare të Sigurimit.

Ndryshimet ligjore të vitit 2021 mundësuan kufizimin e komisioneve të ndërmjetësimit për produktet e sigurimit të detyrueshëm motorik. Autoriteti miratoi rregulloren që kufizoi komisionet në një nivel maksimal prej 20% të primeve të shkruara bruto duke nisur nga janari 2022, ndërsa nga janari 2023 jo më shumë se 18%. Rezulton se komisionet e ndërmjetësimit në fund të vitit 2022, janë ulur në një mesatare tregu prej 17.6%, nga 27.4% që ishin mesatarisht përpara hyrjes në fuqi të rregullores së Autoritetit (viti 2021). Raporti Evropian i Aksidenteve rezulton të jetë përdorur në rreth 23% të rasteve për dëmet e trajtuara gjatë vitit 2022. Kjo praktikë, një risi në ligjin e ri, mundësoi zgjidhjen me marrëveshje mes drejtuesve të mjeteve të përfshira në aksident, në rastet e dëmeve me vlerë deri në 30.000 lekë.

Në tregun e sipërmarrjeve të investimeve kolektive, gjatë vitit 2022 Autoriteti ndërmori disa masa, duke marrë në konsideratë efektet e zhvillimeve gjeopolitike, rritjen e presioneve inflacioniste dhe normave të interesit, si dhe ndikimin që pati kjo situatë në rritjen e kërkesave për tërheqje nga fondet e investimit. Masat e ndërmarra lidhen me monitorimin e treguesve të shlyerjeve neto, likuiditetit dhe rezultateve të stres-testeve, me frekuenca të shtuara raportimi. Autoriteti gjatë kësaj periudhe ka ngritur Komitetin Teknik për monitorimin e tregut të Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive, i cili mblidhet rregullisht për të diskutuar në lidhje me ecurinë e situatës. Bordi i Autoritetit mori disa vendime në funksion të zbutjes së efekteve që solli përgjithësisht rritja e normave të interesit të fondet e investimeve.

Totali i aseteve neto të tregut të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, përfshirë edhe fondet alternative, në fund të vitit 2022, ishte rreth 46 miliardë lekë, me një rënie prej 43.7% krahasuar me vitin 2021. Ndërkohë u shënuar një rritje prej 21 miliardë lekë, ose rreth 180% në vlerë nominale e investitorëve joprofesionistë, në ankandet e titujve të Qeverisë, duke arritur në rreth 52.5 miliardë lekë.

Nga mbikëqyrja e këtij tregu, gjatë vitit 2022, mbi bazën e raportimeve me frekuencë të shtuar nga shoqëritë administruese të SIK, si dhe nga raportimi financiar i shoqërive administruese, ka rezultuar se treguesit e likuiditetit për të gjitha fondet e investimit me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike kanë qenë në përputhje me kërkesat e bazës rregullatore për likuiditetin. Në muajt e parë të vitit 2023 konstatohet një normalizim i situatës. Megjithatë Autoriteti vijon monitorimin e kujdesshëm të të gjithë treguesve të fondeve të investimit.

Në kuadër të respektimit të kërkesave rregullatore për likuiditetin, shoqëritë administruese janë kujdesur që fondet e investimit me ofertë publike me pjesëmarrje të hapur, të cilat investojnë në tregje jo aktive, të mbajnë likuiditetin në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullativ në fuqi.

Tregu i fondeve të pensionit privat ka vijuar tendencën e tij në rritje, si në vlerën e aktiveve neto, ashtu edhe në numrin e anëtarëve. Në krahasim me vitin 2021, aktivet neto të këtij tregu më 31.12.2022 kanë pësuar një rritje me 24.32%, ndërsa numri i anëtarëve është 36,518 dhe ka shënuar një rritje me 8.78% krahasuar me fundin e vitit 2021. Vlera neto e aktiveve arriti në 5.7 miliardë lekë. Gjatë vitit 2022, në tregun e pensioneve vullnetare ushtruan aktivitetin e tyre katër fonde pensioni vullnetar të administruara nga katër shoqëri administruese, ndërkohë që u licencuan edhe dy fonde të reja të pensionit vullnetar.

Në tregun e kapitaleve edhe gjatë vitit 2022 vijoi procesi i përshtatshmërisë me kërkesat e Ligjit nr. 62/2020, datë 14.05.2020 “Për Tregjet e Kapitalit”, ndërkohë që u zgjeruan llojet e shërbimeve të investimit të ofruara nga subjektet e tregut. Kështu, për herë të parë u licencuan dy subjekte (banka) për ofrimin e shërbimit të nënshkrimit të titujve (*underwriting*), u licencua një bankë për ofrimin e shërbimit të administrimit të portofoleve individuale, si dhe për shërbimin e këshillimit në investime. Gjithashtu, subjektet e tregut (bankat tregtare) zgjeruan licencën e tyre për të ofruar një gamë më të gjerë të instrumenteve financiare, përtej titujve të Qeverisë, duke i dhënë mundësi investitorëve për më shumë alternativa investimi. Autoriteti autorizoi një subjekt (bankë) për të ofruar shërbimin e shitjes *online* të bonove të thesarit, nëpërmjet një platforme digjitale.

Përveç rritjes së interesit për blerjen e titujve të Qeverisë, si pasojë e rritjes së normave të interesit, edhe tregu i obligacioneve të emetuara me ofertë private shënoi



rritje të mëtejshme gjatë vitit 2022. Shuma e pashlyer e këtij instrumenti financiar arriti në rreth 14 miliardë lekë, me një rritje prej rreth 40%, krahasuar me fundvitin 2021. Gjatë vitit të kaluar, Autoriteti regjistroi 11 akt-oferta, të përgatitura nga 6 emetues për obligacionet me ofertë private, ku investitorët kryesorë janë individët.

Autoriteti përmbylli në vitin 2022 projektin 3-vjeçar të asistencës teknike, financuar nga Sekretariati Shtetëror Zvicëran për Çështje Ekonomike (SECO) dhe i mbështetur nga Banka Botërore për forcimin e kapaciteteve mbikëqyrëse, me fokus kryesor tregjet e kapitalit dhe tregun e sigurimeve. Në tregun e sigurimeve, me asistencën teknike të Bankës Botërore u hartua udhërrëfyesi për zbatimin e regjimit mbikëqyrës evropian Solvency II. Zbatimi i këtij regjimi është angazhim i Autoritetit edhe në kuadër të përafrimit të legjislacionit me direktivat e BE dhe praktikat më të mira ndërkombëtare në fushën e mbikëqyrjes.

Gjatë vitit 2022, Autoriteti organizoi dy konferenca ndërkombëtare mbi nevojën e diversifikimit të sistemit financiar përmes zhvillimit të tregjeve të kapitalit, si edhe zhvillimin e financave të gjelbra në Shqipëri, në kuadër të ndërgjegjësimit dhe rritjes së njohurive financiare.

Autoriteti ka forcuar bashkëpunimin me organizatat dhe institucionet financiare ndërkombëtare, si edhe autoritetet homologe rajonale dhe evropiane. AMF aderoi në Memorandumin Shumëpalësh të Mirëkuptimit, të Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS), duke u bërë rregullatori i parë në rajonin e Ballkanit Perëndimor që bëhet pjesë e këtij Memorandumi. Kjo pjesëmarrje i shërben shkëmbimit të informacionit dhe mbikëqyrjes efektive të grupeve ndërkufitare të sigurimeve. Autoriteti gjatë vitit 2022 nënshkroi marrëveshje bashkëpunimi me Autoritetin e Shërbimeve Financiare të Maltës (MFSA) dhe Komisionin e Mbikëqyrjes së Shërbimeve Financiare të Luksemburgut (CSSF). AMF ka vijuar bashkëpunimin me Autoritetin e Tregjeve Financiare të Austrisë (FMA), si dhe me rregullatorët e vendeve të rajonit. Gjithashtu, me rekomandim të Bankës Botërore, AMF asistoi Komisionin e Letrave me Vlerë të Ukrainës, në procesin e përafrimit ligjor me *acquis* të BE-së.

Autoriteti ka hartuar Strategjinë 5-vjeçare 2023-2027, e cila paraqet vizionin e tij në drejtim të stabilitetit financiar, për tregje të qëndrueshme dhe të sigurta, duke i dhënë prioritet procesit të integritetit në Bashkimin Evropian. Strategjia përcakton disa drejtime të rëndësishme për zhvillimin afatmesëm, si forcimi i stabilitetit financiar, rritja e efektivitetit të mbikëqyrjes dhe integritetit të tregjeve, përafrimi i legjislacionit me standardet evropiane zhvillimi dhe modernizimi i tregjeve, mbrojtja e interesave të konsumatorit dhe investitorit, financimi i gjelbër, si edhe digjitalizimi dhe përmirësimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit.

NEGOCIATAT ME BASHKIMIN EVROPIAN - ROLI I AMF-SË NË PROCESIN E INTEGRIMIT

Viti 2022 shënoi zhvillime të rëndësishme sa i përket rrugës së Shqipërisë drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Më 19 korrik 2022 u zhvillua Konferenca Ndërqeveritare për negociatat e anëtarësimit, ku Shqipërisë iu dha formalisht korniza e përgjithshme dhe kuadri negociues për anëtarësimin. Nga shtatori 2022 ka filluar procesi i shqyrtimit analitik të *acquis* të BE-së nga ana e Komisionit Evropian.

Në kuadër të negociatave, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare drejton Kapitullin 9 “Shërbimet Financiare”, si edhe kontribuon në një sërë kapitujsh, si pjesë e grupeve ndërinstitucionale. Në tetor 2022, Komisioni Evropian zhvilloi në Bruksel takimin shpjegues për Kapitullin 9, i cili rregullon shërbimet financiare në fushën bankare, atë të sigurimeve, pensione ve vullnetare, shërbimeve të investimeve dhe tregjeve të titujve.


Takimi Bilateral për këtë kapitull u zhvillua në 13-14 shkurt 2023 në Bruksel. Anëtarët e grupit negociator të drejtuar nga z. Ervin Mete, Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, me përbërje përfaqësues të Autoritetit, Bankës së Shqipërisë dhe Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, prezantuan në mënyrë të detajuar nivelin e përafrimit me direktivat evropiane të fushës.

Ekspertët e Komisionit Evropian theksuan se Shqipëria ka bërë progres të konsiderueshëm sa i përket plotësimit të rekomandimeve dhe përafrimit ligjor e rregullator në Kapitullin 9. Ata nënvizuan se Kapitulli 9 ka rëndësi të posaçme për zhvillimin ekonomik të Shqipërisë, si edhe shprehën mbështetje të plotë për Shqipërinë në procesin e reformave dhe të përafrimit të *acquis* në fushën e shërbimeve financiare.

Komisioni Evropian ka vlerësuar në vijimësi në vitet e fundit përparimin e bërë me përafrimin ligjor e rregullator me *acquis* të BE-së dhe praktikën mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. Në Raportin e fundit të Progresit, të vitit 2022, për Kapitullin 9, raporti nënvizon se “është bërë progres me sigurimet e detyrueshme dhe sipërmarrjet e investimeve kolektive”.

“Në fushën e sigurimeve dhe pensioneve private, legjislativi për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit është përafër me *acquis* më të rëndësishme të BE-së. Kuadri nënligjor u miratua gjatë periudhës së raportimit, duke mundur zbatimin e plotë të ligjit, përfshirë edhe një aplikacion për llogaritjen e dëmeve personale në rastet e aksidenteve rrugore,” theksohet në Progres Raport. Gjithashtu, në dokument përmenden edhe masat rregullatore të ndërmarra nga Autoriteti, si edhe avancimet e rëndësishme në drejtim të bashkëpunimit ndërkombëtar.

Gjatë viteve të fundit ka pasur një përparim domethënës të kuadrit ligjor e rregullator dhe Autoriteti është angazhuar në përafrimin e legjislativitetit të tregjeve nën mbikëqyrje me Direktivat dhe *acquis* të BE. Pas miratimit të ligjeve të reja



në fushën e shërbimeve financiare, ligji për tregjet e kapitalit, për sipërmarrjet e investimeve kolektive, për teknologjinë e regjistrave të shpërndarë, si edhe për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit, Autoriteti u angazhua në kompletimin e gjithë akteve nënligjore në zbatim të këtyre ligjeve.

Autoriteti hartoi gjithashtu projektligjin “Për fondet e pensionit privat”, i përafuar në një masë të konsiderueshme me Direktivën (BE) 2016/2341 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit datë 14 dhjetor 2016 “Për veprimtaritë dhe mbikëqyrjen e institucioneve të pensionit profesional (IORP II)”. Projektligji “Për fondet e pensionit privat” me Vendimin nr. 578, datë 12.12.2022 të Këshillit të Ministrave është propozuar për shqyrtim dhe miratim nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. Me hyrjen në fuqi të ligjit, Autoriteti do të vijojë me hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore në zbatim të tij.

Autoriteti ka vijuar të japë kontributin e tij në përbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, Progres Raportet e Komisionit Evropian, Nënkomitetet e përbashkëta BE-Shqipëri si dhe Planit Kombëtar për Integrimin Evropian. AMF ka vijuar bashkëpunimin me Zyrën e Kryenegociatorit si institucioni koordinues në procesin e integritit evropian. Autoriteti ka ndjekur në vijimësi zbatimin e Planit Kombëtar të Integritit Evropian (PKIE) për periudhën 2022-2024, duke hartuar dhe miratuar aktet nënligjore të parashikuara. Gjithashtu, AMF dhe institucionet e tjera kontribuese të Kapitullit 9 janë përfshirë në hartimin e PKIE për këtë kapitull për periudhën 2023-2025.

Në funksion të procesit të integritit, gjatë vitit 2022, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka zgjeruar bashkëpunimin me rregullatorët e vendeve të Bashkimit Evropian. Autoriteti nënshkroi Memorandume Mirëkuptimi me Autoritetin e Shërbimeve Financiare të Maltës (MFSA) dhe Komisionin e Mbikëqyrjes së Shërbimeve Financiare të Luksemburgut (CSSF). Synimi i këtyre marrëveshjeve është përfitimi i eksperiencave dhe praktikave më të mira mbikëqyrëse të rregullatorëve evropiane, shkëmbimi i informacionit, si edhe asistenca në drejtim të harmonizimit me kuadrin ligjor evropian.

AMF ka thelluar bashkëpunimin me Autoritetin e Tregjeve Financiare të Austrisë (FMA), si edhe ka vijuar shkëmbimin e informacionit dhe eksperiencave më të mira edhe me rregullatorë evropiane me të cilët ka marrëveshje bashkëpunimi, si Agjencia e Mbikëqyrjes së Shërbimeve Financiare në Kroaci (HANFA), Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Sllovenisë (AZN), etj. Autoriteti ka qenë gjithashtu pjesë e nismave evropiane dhe rajonale, me pjesëmarrjen e institucioneve rregullatore të BE-së, ESMA dhe EIOPA, ku është diskutuar për aspektet ligjore e rregullatore të mbikëqyrjes së tregjeve financiare, si edhe praktikat më të mira evropiane.

Kapitulli 1

Ecuria e Tregjeve nën Mbikëqyrje

Gjatë vitit 2022, totali i aseteve në tregjet nën mbikëqyrjen e Autoritetit janë rreth 96 miliardë lekë. Nga pikëpamja e aseteve, tregu më i madh për t'u mbikëqyrur vijon të jetë tregu i fondeve të investimeve, i cili përbën rreth 49% të totalit të tregjeve nën mbikëqyrje.

1.1 Tregu i Kapitalit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive

Tregu i sipërmarrjeve të investimeve kolektive

Tregu i Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive (SIK) vijon të përfaqësojë një pjesë të rëndësishme të tregjeve nën mbikëqyrje, pavarësisht presioneve inflacioniste dhe luhatjeve në treg gjatë vitit 2022, ndikuar kryesisht nga pasiguritë në tregjet financiare ndërkombëtare.

Rritja e normave bazë të interesit ndikoi në vlerën e portofoleve të fondeve të investimit me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike në Shqipëri, të cilat karakterizohen nga koncentrim i lartë i investimeve në tituj borxhi të qeverisë së Republikës së Shqipërisë (RSH). Këto tituj ndonëse kanë nivel të ulët të rrezikut të kreditit, konsiderohen aktive jolikuide, të cilat shfaqin luhatshmëri të lartë kthimi, veçanërisht në periudha stresi të tregut. Gjithashtu, luhatje patën edhe fondet e investimit, portofolet e të cilave përbëhen nga investime në tregjet ndërkombëtare, për shkak të luhatjeve në këto tregje gjatë këtij viti.

Rënia e vlerës së titujve në portofolet e fondeve të investimeve me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike, solli edhe rënien e çmimit të kuotave të këtyre fondeve, gjë që shkaktoi rritje të kërkesave për tërheqje nga investitorët. Kështu, viti 2022 u karakterizua nga rënie në asetet neto të tregut të fondeve të investimeve me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike, flukse neto negative, luhatshmëri të çmimit të kuotës dhe rënie të numrit të investitorëve. Nga informacioni i depozituar në Autoritet dhe monitorimi i të dhënave të tregut me pakicë të titujve të qeverisë, rezulton që në rritjen e volumeve të transaksioneve ka ndikuar ndjeshëm lëvizja e fondeve të investitorëve të fondeve të investimeve drejt tregut me pakicë të titujve të qeverisë. Kjo ka bërë të mundur qarkullimin e fondeve të investitorëve të tregut të fondeve të investimeve brenda sistemit financiar, duke mos shkaktuar rritje të rrezikut sistematik në vend.

Totali i aseteve neto të tregut të SIK për periudhën 31.12.2022 arriti në rreth 46.05 miliardë lekë, me një rënie 43.76% krahasuar me vitin 2021, ndikuar kryesisht nga rënia në asetet neto të fondeve të investimeve me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike. Totali i aseteve neto të fondeve të investimit me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike në fund të vitit 2022 është në vlerën rreth 41.47 miliardë lekë dhe ka



pësuar një rënie me 46.63% krahasuar me vitin paraardhës. Totali i aseteve neto të fondeve të investimeve alternative më 31.12.2022 rezulton në vlerën 4.59 miliardë lekë dhe është rritur me 9.21% krahasuar me vitin 2021.

Numri i investitorëve për 31.12.2022 në tregun e fondeve të investimeve është 28,953, nga të cilët vetëm 4 investitorë i përkasin fondeve të investimeve alternative. Numri i investitorëve të fondeve të investimeve me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike është 28,949 dhe ka shënuar një rënie me 27.72% gjatë këtij viti.

Në tregun e sipërmarrjeve të investimeve kolektive, asetet e SIK, u administruan nga pesë shoqëri administruese, tri prej të cilave kryejnë veprimtarinë e administrimit si për SIK ashtu edhe për fondet e pensionit vullnetar. Gjatë vitit 2022, për të kryer aktivitetet në tregun e SIK, është licencuar nga Autoriteti një fond investimi me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike, i cili ende nuk ka nisur aktivitetin, si dhe një shoqëri administruese e cila ushtronte veprimtarinë e administrimit të aseteve të fondeve të pensionit vullnetar.

Tregu i fondeve të investimit me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike dominohet kryesisht nga investimet në obligacione dhe bono thesari të Republikës së Shqipërisë, të cilat përbëjnë 75.93% të aseteve, nga 81.51% që ka qenë në fundvit 2021.

Në kuadër të respektimit të kërkesave rregullatore për likuiditetin, shoqëritë administruese janë kujdesur që fondet e investimit me ofertë publike me pjesëmarrje të hapur, të cilat investojnë në tregje jo aktive, të mbajnë likuiditet në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullativ në fuqi. Duke marrë në konsideratë situatën e rritjes së kërkesave për tërheqje gjatë vitit 2022, si dhe koncentrimin e lartë që tregu i fondeve të investimit me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike ka në titujt qeveritarë të borxhit, Autoriteti ka marrë disa masa në lidhje me monitorimin e treguesit të likuiditetit dhe treguesve të tjerë, duke shtuar frekuencën e raportimit. Kështu, Autoriteti ka marrë disa vendime të rëndësishme si më poshtë:

- Vendimi nr. 88, datë 28.04.2022, Vendimi nr. 136 datë 29.07.2022 dhe Vendimi nr. 187 datë 31.10.2022 “Mbi pritshmëritë rregullatore për tregun e sipërmarrjeve të investimeve kolektive (SIK) për periudhën Prill 2022 deri në 30 Qershor 2023”;
- Vendimi nr. 186, datë 29.09.2022 dhe Vendimi nr. 259, datë 20.12.2022 “Për miratimin e një ndryshimi në rregulloren nr. 106, datë 30.06.2021 “Mbi investimet, huadhënien dhe huamarrjen e sipërmarrjeve të licencuara të investimeve kolektive me ofertë publike” deri në 30.06.2023.

Në zbatim të vendimeve të sipërpërmendura, shoqëritë administruese të SIK kanë raportuar me frekuencë të shtuar për çdo fond, në lidhje me shlyerjet neto me

frekuencë javore, treguesin e likuiditetit me frekuencë mujore dhe rezultatet e testeve të stresit për muajt Mars, Qershor, Shtator dhe Dhjetor 2022. Nga mbikëqyrja e tregut mbi bazën e raportimeve mujore të bërë nga shoqëritë administruese të SIK, si dhe nga raportimi financiar i shoqërive administruese, rezultoi se gjatë vitit 2022 treguesit e likuiditetit për të gjitha fondet e investimit me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike kanë qenë në përputhje me kërkesat e bazës ligjore dhe rregullatore për likuiditetin.

Tregu i kapitalit

Ligjet e reja për tregjet e kapitalit dhe sipërmarrjet e investimeve kolektive, të cilat harmonizojnë legjislacionin tonë me atë të Bashkimit Evropian, kanë përmirësuar ndjeshëm kuadrin e nevojshëm ligjor, standardet e mbikëqyrjes dhe kërkesat për transparencë e mirëqeverisje, të cilat synojnë rritjen e besimit në mekanizmat e tregut, si element thelbësor të nxitjes së pjesëmarrjes së investitorëve në treg. Në linjë me legjislacionin evropian, aktet e reja ligjore kanë sjellë shumëllojshmëri të shërbimeve të investimit, mundësi për të zgjeruar ndërlidhjet me tregjet globale, si dhe një gamë të gjerë të instrumenteve financiare.

Gjatë vitit 2022, në zbatim të ligjit të ri për tregjet e kapitalit, për herë të parë dy subjekte (banka) kanë zgjeruar licencën për të ofruar shërbimin e nënshkrimit të titujve me apo pa angazhim shitje (*underwriting*), si element kyç në mikroinfrastrukturën e tregut, që mbështet procesin e emetimit të titujve me ofertë publike. Gjithashtu, gjatë këtij viti, për herë të parë, mbështetur në ligjin e ri u mundësua zgjerimi i licencës së një subjekti bankë për ofrimin e shërbimit të administrimit të portofoleve individuale, si dhe shërbimit të këshillimit për investime, të cilat i ofrojnë mundësinë investitorëve, kryesisht atyre jo profesionistë, të investojnë në tregjet e kapitalit nën këshillimin e subjekteve të specializuar të tregut.

Procesi i përshtatshmërisë së subjekteve që operojnë në tregjet e kapitalit, sipas kërkesave të ligjit të ri dhe rregulloreve të dala në zbatim të tij, ka vijuar edhe përgjatë vitit 2022. Ky proces u realizua për 6 banka që ofrojnë shërbime investimi dhe 1 shoqëri komisionere. Subjektet iu nënshtruan një procesi të plotë të rishikimit dhe përditësimit të rregullave dhe procedurave të tyre operacionale, rishikimit të kontratave me klientin, apo hartimit të rregullave dhe procedurave shtesë në këndvështrimin e kërkesave të reja ligjore. Pjesë e përshtatshmërisë ishte edhe implementimi i procesit të certifikimit nga vetë subjektet, të personelit kyç për të ofruar shërbime investimi.



Krahas procesit të përshtatshmërisë, duke shfrytëzuar mundësitë e krijuara nga ligji i ri për tregjet e kapitalit, subjektet, kryesisht banka, paraqitën kërkesën për zgjerimin e licencës për të ofruar një gamë më të gjerë të instrumenteve financiare, përtej titujve të Qeverisë, duke i dhënë mundësi investitorëve për më shumë alternativa investimi.

Në kuadër të digjitalizimit të shërbimeve të investimit, Autoriteti i akordoi të drejtën një subjekti bankë, për të ofruar shërbimin e shitjes *online* të bonove të thesarit, nëpërmjet një platforme digjitale. Ky shërbim është një risi për tregun financiar vendas në tërësi dhe pritet të ketë ndikim pozitiv në tregun sekondar të titujve të qeverisë, si dhe në rritjen e edukimit financiar të klientëve.

Pjesë e procesit të përshtatshmërisë me Ligjin nr. 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit”, gjatë vitit 2022, ishin edhe subjektet që përbëjnë infrastrukturën e tregut të kapitalit, Bursa Shqiptare e Titujve ALSE dhe Regjistri Shqiptar i Titujve ALREG. Në përputhje me përcaktimet e ligjit, shoqëria “Bursa Shqiptare e Titujve ALSE” sh.a., u përshtat për vënien në funksion të një tregu të rregulluar. Shoqëria Regjistri Shqiptar i Titujve ALREG, me pranimin si anëtare e sistemit AIPS është bërë funksionale dhe përmbush të gjitha aspektet teknike për të operuar si Regjistrar dhe Depozitar Qendror i Titujve. Krahas aktivitetit kryesor, ALREG u përshtat edhe për ofrimin e shërbimeve ndihmëse jobankare.

Në tregun e kapitalit, gjatë vitit 2022, ushtruan veprimtarinë e tyre subjektet e mëposhtme:

- 13 subjekte, nga të cilat 10 banka për ofrimin e shërbimeve të investimit dhe shërbimit ndihmës të kujdestarisë, 3 shoqëri komisionere (nga të cilat dy me status pezull);
- 1 Bursë titujsh;
- 1 Regjistrar Titujsh dhe 1 Depozitar Qendror Titujsh, i cili krahas shërbimit të regjistrimit kryen edhe shërbimin e klerimit dhe shlyerjes së titujve.

Tabelë 2: Pjesëmarrës dhe subjekte të tregut të kapitaleve, dhjetor 2022

(Në numër)

Shoqëri Komisionere/Banka	Banka që ofrojnë shërbimin e kujdestarisë të Titujve	Banka që ofrojnë shërbimin e administrimit të portofolit
13	10	1
Banka që ofrojnë shërbimin e këshillimit dhe dhënies së rekomandimeve për investime	Banka që ofrojnë shërbimin e nënshkrimit të instrumentave financiare	Banka që ofrojnë shërbimin e investimit <i>online</i>
1	2	2
Emetues të Obligacioneve me Ofertë Private	Bursë Titujsh (Tregu i Rregulluar)	Depozitar Qendror Titujsh
8	1	1

Tregu me pakicë i titujve të Qeverisë

Tregu i kapitaleve vijon të jetë i përqendruar në dy segmente kryesore: tregun e titujve të Qeverisë dhe tregun e obligacioneve me ofertë private.


Tregu i titujve të Qeverisë Shqiptare mbetet segmenti më i madh dhe aktiv që mbizotëron në tregun e kapitaleve. Titujt e qeverisë tregtohen në Bursën Shqiptare të Titujve dhe në Tregun me Pakicë, i organizuar në formën e tregut mbi banak (OTC).

Vëllimi i përgjithshëm i transaksioneve të realizuara në tregun me pakicë të titujve të Qeverisë në vitin 2022 arriti në rreth 77.5 miliardë lekë dhe sipas të dhënave statistikore për periudhën janar-dhjetor 2022, në këtë treg ka vijuar të dominojë transaksioni “Blerje në tregun primar” me 67.77%, kundrejt vëllimit të përgjithshëm të transaksioneve. Përsa i përket aktivitetit në tregun sekondar ai mbetet ende i ulët me rreth 11.98% të totalit të transaksioneve të kryera.

Gjatë vitit 2022, vëllimi i blerjeve në tregun primar nga investitorët jo profesionistë, nëpërmjet subjekteve banka të licencuara arriti në 52.5 miliardë lekë, me një rritje prej 179.58% në krahasim me vitin 2021. Kjo u shoqërua me rritje të numrit të klientëve, kryesisht klientë individë, në masën 220.19% në krahasim me vitin 2021. Rritja e normave të interesit, gjatë vitit 2022, rriti interesin e klientëve për investime në titujt e Qeverisë.

Grafik 1: Transaksione në tregun me pakicë të titujve të Qeverisë, 2022

(Në %)




Vëllimi i transaksioneve në tregun sekondar të titujve të Qeverisë për vitin 2022, u dominua në masën 50.52% nga transaksione në instrumente afatshkurtër (bono thesari) dhe 49.48% nga transaksionet në instrumente afatgjatë (obligacione).



Grafik 2: Vëllimi i tregimit në tregun sekondar sipas llojit të titujve, 2022

(Në %)



1.2 Tregu i Sigurimeve


Në tregun e sigurimeve edhe gjatë vitit 2022 ushtruan aktivitetin 12 shoqëri sigurimi. Vëllimi i primeve të shkruara bruto arriti në rreth 21 miliardë lekë, duke u rritur me rreth 9.21% krahasuar me vitin 2021. Të ardhurat nga primet e shkruara bruto u rritën si në aktivitetin e Jetës, ashtu dhe në atë të Jo-Jetës.

Në aktivitetin e Jetës, në vitin 2022, primet e shkruara bruto u rritën me 17.91% krahasuar me vitin 2021. Rritja erdhi kryesisht si pasojë e rritjes së kontratave në sigurimin e Jetës së debitorit, me afro 56.12% e totalit të rritjes së primeve në sigurimin e Jetës.

Në sigurimin e Jo-Jetës, primet e shkruara bruto, në vitin 2022 u rritën me 8.51% krahasuar me vitin 2021. Rritja e të ardhurave erdhi kryesisht nga portofoli i sigurimit të detyrueshëm motorik, me rreth 80.35% e totalit të rritjes së primeve në sigurimin e Jo-Jetës.


Grafik 3: Ecuria e primit të shkruar bruto në vite

(Në mld. lekë)



Grafik 4: Ndarja e primit të shkruar bruto, sipas llojit të sigurimit, viti 2022

(Në %)




Në nivel tregu, totali i dëmeve të paguara bruto për vitin 2022 arriti në 6.8 miliardë lekë, me një rritje prej 2.45%, krahasuar me vitin 2021. Dëmet e paguara në sigurimin e Jo-Jetës kapën shifrën 6.3 miliardë lekë, ndërsa në sigurimin e Jetës dëmet e paguara ishin rreth 293 milionë lekë. Pjesa tjetër prej rreth 290 milionë lekë të dëmeve të paguara i përkasin dëmeve të Fondit të Kompensimit dhe Dëmeve të paguara si sigurues i drejtpërdrejtë.



Pagesat e dëmeve nga Fondi i Kompensimit, në vitin 2022, janë realizuar në masën prej 108%, duke rezultuar me një tepricë prej rreth 19 milionë lekë mbi planifikimin e bërë në fillim të vitit. Gjatë vitit 2022, risi në dëmet e paguara në portofolin TPL e brendshme ishin dëmet e paguara me REA (Raporti Evropian i Aksidenteve) që kapin 29% të totalit të numrit të dëmeve të paguara në këtë portofol sigurimi.

Grafik 5: Ecuria e dëmeve të paguara bruto në vite

(Në mld. lekë)



Mbi programin e vlerësimit të nivelit të përputhshmërisë së standardeve dhe praktikave të AMF-së, me Parimet Themelore Ndërkombëtare në Sigurime (ICP), të kryer nga Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve në Sigurime (IAIS)

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare me qëllim përafrimin me standardet më të mira ndërkombëtare në fushën e sigurimeve, gjatë vitit 2022 me kërkesë të tij, iu nënshtrua një procesi rigoroz vlerësimi të përputhshmërisë së standardeve dhe praktikave të tij mbikëqyrëse me ICP-të, nga Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve në Sigurime (IAIS). Ndryshimet në kuadrin ligjor dhe rregullator të AMF, si edhe dinamika e zhvillimit të tregut dhe institucionit, sollën nevojën e një vlerësimi të ri të përputhshmërisë së standardeve të përdorura nga AMF, me ICP-të.

Ky proces vjen pas atij të vitit 2014, të kryer nga FMN dhe Banka Botërore, në kuadër të Programit të Vlerësimit të Sektorit Financiar (FSAP), rekomandimet e të cilit u reflektuan në miratimin e Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe ndryshimeve të rëndësishme të Ligjit nr. 9576, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”.

Procesi i vlerësimit të përputhshmërisë me ICP-të u krye nga anëtarë të IAIS-it, bazuar në Programin e Vlerësimit të Anëtarit (*Member Assessment Program*). Ky proces u realizua nëpërmjet vlerësimeve në distancë dhe në vend nga grupi i vlerësimit dhe përfshiu aspektin ligjor e rregullator, pavarësinë institucionale, procedurat e licencimit, praktikën mbikëqyrëse dhe ato të vlerësimit të rrezikut, mbikëqyrjen e grupeve të sigurimit, etj.

Në draft raportin e vlerësimit të përgatitur nga Grupi i Vlerësimit të IAIS-it, rezultoi përgjithësisht një nivel i lartë i përputhshmërisë me ICP-të, ku nga 24 parime bazë, 10 prej tyre rezultuan plotësisht të përputhura (*Observed*) me parimet ndërkombëtare dhe 12 të tjera me një nivel të lartë përputhshmërie (*Largely observed*). Ky vlerësim përbën një avancim të ndjeshëm kundrejt rezultateve të vlerësimit të vitit 2014, të kryer nga Banka Botërore dhe FMN, në kuadër të Programit të Vlerësimit të Sektorit Financiar (FSAP), ku vetëm një parim bazë rezultoi plotësisht i përputhur (*Observed*) me parimet ndërkombëtare.

Raporti përfundimtar i vlerësimit të përputhshmërisë me parimet bazë ndërkombëtare në sigurime, u miratua nga Komiteti Ekzekutiv i IAIS-it në qershor 2023. Në linjë me rekomandimet e raportit përfundimtar të vlerësimit nga IAIS, Autoriteti do të angazhohet në rishikimin e kuadrit ligjor e rregullator në fushën e sigurimeve, me synim përafrimin e mëtejshëm me Parimet Themelore në Sigurime.

1.3 Tregu i Fondeve të Pensionit Vullnetar

Gjatë vitit 2022 ka vijuar tendenca në rritje e kontributeve, aseteve, numrit të anëtarëve dhe çmimit të kuotës së fondeve të pensionit vullnetar dhe rritja e normave të interesit nuk ka pasur ndikim në këtë treg.

Ka pasur një interes të shtuar nga ana e shoqërive administruese për krijimin e fondeve të reja të pensionit vullnetar. Autoriteti ka miratuar dy fonde të reja të pensionit vullnetar, një prej të cilëve ka filluar veprimtarinë në muajin janar 2023.

Gjatë vitit 2022, Autoriteti përfundoi hartimin e projektligjit “Për fondet e pensionit privat”, i cili përafrohet në nivel të lartë me Direktivën e Bashkimit Evropian 2016/2341 “Për veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e institucioneve të pensionit profesional (IORP II). Në fund të vitit 2022, projektligji u miratua nga Këshilli i Ministrave dhe gjatë vitit 2023 pritet miratimi i tij nga Kuvendi i Shqipërisë.



2.1 Mbikëqyrja e Tregut të Kapitalit dhe Fondeve të Investimit

Tregu i Fondeve të Investimit me Pjesëmarrje të Hapur me Ofertë Publike


2.1.1 Pozicioni financiar

Gjatë vitit 2022, në tregun e SIK ushtruan aktivitetin e tyre njëmbëdhjetë fonde investimi me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike. Këto fonde investimesh janë administruar nga pesë shoqëri administruese, tre nga të cilat kryejnë veprimtarinë e administrimit për SIK dhe për fondet e pensionit vullnetar, ndërkohë që dy shoqëritë e tjera kryejnë veprimtarinë e administrimit vetëm për SIK.

Asetet neto të tregut të fondeve të investimeve me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike në 31.12.2022 janë në vlerën 41.47 miliardë lekë, duke pësuar një rënie me 36 miliardë lekë ose 46.63%. Në 31.12.2022 numri i investitorëve në fondet e investimeve me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike është 28,949 nga të cilët 99.92% janë investitorë individualë.

Grafik 6: Asetet neto të tregut të fondeve të investimit në vite

(Në mln. lekë)



Investimet e tregut të fondeve të investimit me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike konsistojnë në obligacione qeveritare brenda dhe jashtë R.SH., bono thesari të Qeverisë së R.SH., obligacione të shoqërive jashtë vendit, kuota në fonde investimi, si dhe aksione në shoqëri të huaja.

Tabelë 3: Të dhëna mbi portofolin e fondeve të investimeve me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike, sipas periudhave tremujore, 2022 (Në mln. lekë)

Përshkrimi	Vlera			
	31.03.2022	30.06.2022	30.09.2022	31.12.2022
Periudha				
Asetet neto të fondeve	76,793	71,243	53,759	41,466
Totali i aseteve të fondeve	77,199	71,843	55,075	41,712
nga të cilët:	-	-	-	-
Obligacione Qeveritare	50,441	47,635	31,992	27,862
Obligacione të Shoqërive	1,285	580	328	556
Bono Thesari	12,354	11,789	8,374	3,930
Investime në kuota të fondeve të investimit	2,160	2,144	1,663	1,343
Aksione në shoqëri të huaja	354	395	378	395
Mjete Monetare	9,924	8,551	11,856	7,136
Asete të tjera	681	749	484	490
Totali i Detyrimeve të Fondeve	406	688	1,316	246


Në tabelën e mëposhtme është pasqyruar ndryshimi i portofolit të tregut të fondeve të investimit me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike të vitit 2022 kundrejt vitit 2021, si dhe pesha që zë secili nga përbërësit e portofolit në totalin e aseteve në vitin 2021 dhe në vitin 2022.

Tabelë 4: Ndryshimi në përbërjen e portofolit të fondeve të investimeve me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike, 31.12.2021 - 31.12.2022


Përshkrimi	Vlera (Në mln. lekë)		Ndryshimi (Në %)	Pjesa ndaj totalit (Në %)	
	31.12.'21	31.12.'22		31.12.'21 31.12.'22	31.12.'21 31.12.'22
Periudha					
Asetet neto të fondit	77,691	41,466	-46.63		
Totali i aseteve të fondeve	77,862	41,712	-46.43	100	100
nga të cilët:	-	-	-	-	-
Obligacione Qeveritare (të R.SH. dhe të huaja)	50,027	27,862	-44.31	64.25	66.79
Obligacione të Shoqërive	2,355	556	-76.39	3.02	1.33
Bono Thesari	13,626	3,930	-71.16	17.50	9.42
Investime në kuota të fondeve të investimit	2,558	1,343	-47.50	3.29	3.22
Aksione në shoqëri të huaja	297	395	33.00	0.38	0.95
Mjete Monetare	8,221	7,136	-13.20	10.56	17.11
Asete të tjera	779	490	-37.10	1.00	1.18
Totali i Detyrimeve të Fondeve	172	246	43.02	0.22	0.59



Grafik 7: Struktura e aseteve të fondeve të investimeve me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike 31.12.2021 (Në %)




Grafik 8: Struktura e aseteve të fondeve të investimeve me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike 31.12.2022 (Në %)



Në zbatim të kërkesave të rregullores së likuiditetit, fondet e investimit me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike, kanë mbajtur asete likuide në përputhje me kërkesat rregullatore në fuqi. Siç shihet në grafikun e mëposhtëm, për 31.12.2022, investimet e tregut të fondeve të investimit me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike me maturim deri në një muaj janë 23.80%. Kjo shënon një rritje krahasuar me vitin 2021, si pasojë e masave të marra nga shoqëritë administruuese për të ulur ekspozimin në investimet me luhatshmëri të lartë dhe për të rritur nivelin e aseteve likuide, me qëllim menaxhimin sa më të mirë të kërkesave në rritje për shlyerje nga ana e investitorëve të fondeve të investimit me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike.

Grafik 9: Profili i investimeve të tregut të fondeve të investimeve me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike 31.12.2022 (Në %)



Tregu i kapitalit

Gjatë vitit 2022 vijoi puna për plotësimin e kuadrit rregullator në zbatim të ligjit për tregjet e kapitalit. Finalizimi i procesit të miratimit të akteve të reja nënligjore, të përafuara me direktivat evropiane të fushës do t'i shërbejë rritjes së standardeve mbikëqyrëse të aktiviteteve në tregjet e kapitalit.

Në funksion të forcimit të mbikëqyrjes dhe ruajtjes së integritetit të tregjeve të kapitalit puna e Autoritetit u fokusua në vendosjen e kërkesave si dhe krijimin e standardeve apo mekanizmave për identifikimin në kohë dhe parandalimin e rasteve që mund të përbëjnë manipulim dhe abuzim të tregut. Në varësi me zhvillimet e tregut, do të vlerësohet mundësia e krijimit të një sistemi të posaçëm monitorimi për identifikimin e rasteve të abuzimit me tregun. Për këtë qëllim Autoriteti do të mbështetet në raportet e përgatitura me asistencë të huaj.

Përgjatë vitit 2022 Autoriteti u fokusua edhe në forcimin e mbikëqyrjes prudenciale të subjekteve që veprojnë në tregjet e kapitalit. Për këtë qëllim, mbështetur në ligjin për tregjet e kapitalit si dhe përmes një raporti të përgatitur me asistencë teknike të huaj u identifikua informacioni i nevojshëm që duhet të raportohet nga subjektet e tregjeve të kapitalit dhe që do të përdoret për krijimin e formateve standarde të raportimit, që do t'i shërbejnë kryerjes së analizave të këtyre subjekteve, për të siguruar pajtueshmërinë e tyre me kërkesat ligjore dhe rregullatore.



Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare do të vijojë të kontribuojë në nxitjen e qëndrueshmërisë dhe zhvillimin e sigurt të tregjeve të kapitalit, në funksion të mirërregullimit dhe zhvillimit të këtij tregu. Në këtë drejtim, Autoriteti ka bashkëpunuar me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë përgjatë vitit 2022 në drejtim të finalizimit të dokumentit politik për zhvillimin e tregjeve të kapitalit përgjatë një periudhe 5-vjeçare, i cili pritet të miratohet gjatë vitit 2023.

Tregu i rregulluar – Bursa Shqiptare e Titujve, ALSE

Që prej fillimit të aktivitetit të Bursës Shqiptare të Titujve, ALSE, në shkurt të vitit 2018, deri në dhjetor të vitit 2022 në Bursën Shqiptare të Titujve është realizuar një vëllim tregtimi prej 3.6 miliardë lekë, prej të cilave 348.2 milionë lekë i përkasin volumit të tregtimit të realizuar gjatë vitit 2022. Titujt e Qeverisë Shqiptare janë të vetmit tituj që janë tregtuar në Bursë.

Tabelë 5: Ecuria në vite e vëllimit të tregtimit në bursë

(Në mln. lekë)

	2018	2019	2020	2021	2022
Vëllimi i tregtimit në bursë	1,380	1,474	452	3.03	348.2

Bursa Shqiptare e Titujve numëron aktualisht 3 anëtarë (banka), të cilët kryejnë transaksione për llogari të portofolit të tyre dhe për llogari të klientëve. Në totalin e transaksioneve të kryera gjatë vitit 2022 dominuan me 100% transaksionet në obligacione thesari, të kryera në monedhën lekë dhe për llogari të personave juridikë.


Infrastruktura e pastregtimit

Infrastruktura e pastregtimit është bërë plotësisht funksionale në mars 2021 me pranimin e shoqërisë “Regjistri Shqiptar i Titujve, ALREG”, si pjesëmarrës indirekt në sistemin AIPS të Bankës së Shqipërisë, i cili është sistem i pagesave ndërbankare me vlerë të madhe. Anëtarësimi i ALREG si pjesëmarrës në këtë sistem, mundëson finalizimin e shlyerjes së transaksioneve me tituj. Shoqëria ALREG, që prej licencimit të saj në vitin 2019, ka regjistruar 19 emetime të obligacioneve me ofertë private, me një vlerë prej rreth 10.3 miliardë lekë. Gjatë vitit 2022, ALREG ka regjistruar 9 emetime në shumën rreth 4.69 miliardë lekë, nga të cilat rreth 23.81% e kësaj shume të regjistruar është në monedhën Lekë, 75.04% në monedhën EUR dhe 1.14% në monedhën USD.

Tregu i obligacioneve me ofertë private

Tregu i obligacioneve të emetuara me ofertë private, i cili është aktiv që prej vitit 2011, ka përjetuar dinamikë në rritje. Shuma e pashlyer e këtij instrumenti financiar arriti nga rreth 10 miliardë lekë në fund të vitit 2021, në rreth 14 miliardë lekë në fund të vitit 2022, me një rritje prej rreth 40%. Aktualisht në treg janë 8 emetues aktivë të obligacioneve me ofertë private, nga të cilët 5 banka, 1 institucion mikrokredie dhe 2 shoqëri tregtare. Përgjatë vitit 2022, Autoriteti ka regjistruar 11 akt-oferta të përgatitura nga 6 emetues (5 banka dhe 1 shoqëri tregtare). Investitorët e këtyre obligacioneve janë kryesisht individë dhe një numër i kufizuar personash juridikë.

Grafik 10: Gjendja e pashlyer e obligacioneve të emetuara me ofertë private (Në mln. lekë)



2.2 Mbikëqyrja e Tregut të Sigurimeve

2.2.1 Pozicioni financiar

Autoriteti, gjatë vitit 2022, ka mbikëqyrur dhe ndjekur në vazhdimësi dinamikën e tregut të sigurimeve, duke vlerësuar pozicionin financiar të shoqërive në nivel individual dhe në tërësi të gjithë tregut të sigurimeve. Autoriteti ka vijuar ndjekjen e përmbushjes së kërkesave ligjore mbi Fondin e Garancisë të shoqërive të sigurimit dhe zbatimin e rregullave për investimin e tij, në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullatore.



Tabelë 6: Të dhëna financiare për tregun e sigurimeve, Aktivet*

(Në mln. lekë)

	31.12' 18	31.12' 19	31.12' 20	31.12' 21	31.12' 22
Totali i aktiveve	31,564	38,803	38,865	40,571	43,550
Jeta	3,327	4,105	4,814	5,075	5,264
Jo-Jeta	28,237	34,699	34,051	35,496	38,286
Totali i investimeve	20,648	22,151	25,029	27,585	30,575
Jeta	2,822	3,578	4,258	4,401	4,473
Jo-Jeta	17,826	18,574	20,770	23,184	26,102


**Në aktivet e tregut të Jo-Jetës nuk janë të përfshira investimet në kapital të shoqërisë SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA sh.a. tek Sigal Life UNIQA GROUP AUSTRIA sh.a. dhe Eurosig sh.a. tek Insig sh.a. dhe Albsig sh.a. te Albsig Jetë sh.a.*

Në 31.12.2022, totali i aktiveve të tregut të sigurimeve është rreth 43.6 miliardë lekë, ku 88% e totalit të aktiveve zotërohen nga shoqëritë e tregut të Jo-Jetës dhe 12% i përketin shoqërive të tregut të Jetës. Për këtë periudhë, aktivet kanë pësuar një rritje prej 3 miliardë lekë, ose rreth 7.3% krahasuar me 31.12.2021.

Rritja e totalit të aktiveve është ndikuar kryesisht nga rritja e sektorit të Jo-Jetës, me rreth 2.8 miliardë lekë ose rreth 8% më shumë, krahasuar me 31.12.2021. Edhe sektori i Jetës ka pësuar rritje të totalit të aktiveve me rreth 190 milion lekë ose 3.8%. Kjo rritje për të dy sektorët ka ardhur si rezultat i performancës financiare pozitive të shoqërive të sigurimit gjatë vitit 2022 dhe rritjes së zërit të investimeve.

Grafik 11: Totali i aktiveve për tregun Jo-Jetë, Jetë në vite

(Në mln. lekë)




Për sektorin e Jo-Jetës, rritja e aktiveve ka ardhur kryesisht si rrjedhojë e rritjes së zërit “Investime në toka, ndërtesa dhe investime financiare” me rreth 2.9 miliardë lekë, ose 13% më shumë krahasuar me 31.12.2021.

Për sektorin e Jetës, rritja e aktiveve ka ardhur kryesisht si rrjedhojë e rritjes së zërit “Investime në toka, ndërtesa dhe investime financiare” me rreth 72 milionë lekë, ose 2% më shumë krahasuar me 31.12.2021.

Për tregun e sigurimeve në tërësi, edhe në 31.12.2022 investimet kanë vijuar të dominojnë totalin e aktiveve me vlerë 30.6 miliardë lekë, duke zënë rreth 70% të totalit të tyre. Rritja e investimeve krahasuar me vitin paraardhës është rreth 3 miliardë lekë ose 11% më shumë.

Grafik 12: Totali i investimeve për tregun Jo-Jetë, Jetë në vite

(Në mln. lekë)




Struktura e aktiveve për të dy sektorët e tregut të sigurimeve, krahasuar me 31.12.2022 ka shfaqur zhvillimet kryesore të mëposhtme:

Depozitat vazhdojnë të zënë peshën kryesore të aktiveve me rreth 32%, ndjekur nga zëri “Toka dhe ndërtesa” dhe “Bono thesari dhe obligacione”, përkatësisht me rreth 15% dhe 12%. Krahasuar me 31.12.2021, depozitat janë rritur me 1.6 miliardë lekë ose 13%. Me rënie paraqitet vetëm zëri debitorë prej 11%, ose 356 milionë lekë, ndikuar nga rënia e debitorëve të tregut të Jo-Jetës në masën 15%, ose 440 milionë lekë, tregues pozitiv i rritjes së arkëtimeve në kohë të primeve të shkruara. Më poshtë, paraqitet grafikisht ecuria e strukturës së aktiveve për periudhën 31.12.2018 deri më 31.12.2022.



Grafik 13: Struktura e Aktivit për tregun e sigurimeve 2018-2022

(Në %)



Tabelë 7: Të dhëna financiare për tregun e sigurimeve, Pasivi*

(Në mln. lekë)


	31.12.'18	31.12.'19	31.12'20	31.12'21	31.12'22
Totali i Pasivit	31,564	38,803	38,865	40,571	43,550
Jeta	3,327	4,105	4,814	5,075	5,264
Jo-Jeta	28,237	34,699	34,051	35,496	38,286
Provigjonet teknike bruto	16,393	22,100	20,986	22,020	23,719
Jeta	1,728	1,902	2,031	2,236	2,415
Jo-Jeta	14,665	20,199	18,956	19,783	21,304
Totali i kapitaleve të veta	10,665	11,145	12,651	13,059	13,658
Jeta	1,509	2,019	2,419	2,454	2,384
Jo-Jeta	9,156	9,126	10,232	10,605	11,274
Totali i kapitalit të nënshkruar	7,366	7,366	7,473	7,743	7,783
Jeta	1,230	1,632	1,882	1,882	1,882
Jo-Jeta	6,136	5,734	5,591	5,861	5,901

*Në pasivet e tregut të Jo-Jetës nuk janë të përfshira investimet në kapital të shoqërisë SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA sh.a. tek Sigal Life UNIQA GROUP AUSTRIA sh.a. dhe Eurosig sh.a. tek Insig sh.a. dhe Albsig sh.a. te Albsig Jetë sh.a.

Struktura e pasiveve të tregut të sigurimeve vijon të dominohet nga zërat e provigjoneve teknike me 55% si dhe “Kapitalet e veta”, të cilat përfaqësojnë interesin e mbetur në aktivet e shoqërisë, pas zbritjes së të gjitha detyrimeve me 31%, ndërkohë që pjesa tjetër e pasivit janë detyrimet e tjera me 14%. Rritja e totalit të pasiveve për tregun e sigurimeve gjatë vitit 2022 është ndikuar kryesisht nga rritja e provigjoneve teknike bruto me 1.7 miliardë lekë, ose me rreth 7.7%, kjo si efekt i rritjes së provigjonit të primit të pagfuar dhe provigjonit të dëmeve.

Grafik 14: Struktura e Pasivit për tregun e sigurimeve


(Në %)



Aktivet në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike në 31.12.2022 për tregun e sigurimeve janë në vlerën rreth 31.3 miliardë lekë, ku për tregun e sigurimit të Jo-Jetës këto aktive janë 28.5 miliardë lekë dhe për tregun e sigurimit të Jetës rreth 2.9 miliardë lekë. Treguesi i mbulimit të provigjoneve teknike me aktive të përshtatshme për shoqëritë e sigurimit të Jo-Jetës, në këtë periudhë është rritur në nivelin 133.5%, nga 130.3% që ishte në 31.12.2021. Ndërsa për shoqëritë e sigurimit të Jetës, mbulimi i provigjoneve matematike në 31.12.2022 rezulton 118.3% nga 124.2% që ishte në 31.12.2021, për shkak të rritjes më të madhe të provigjoneve matematike në raport me atë të aktiveve të lejuara për mbulimin e tyre.



Grafik 15: Struktura e aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike* (Në %)




Rezultati financiar

Gjatë vitit 2022, tregu i sigurimeve ka patur një ecuri pozitive. Në tërësi rezultati financiar për 31.12.2022 ka rezultuar në vlerën 1,629 milionë lekë. Respektivisht tregu i Jo-Jetës ka rezultuar me 1,442 milionë lekë fitim dhe tregu i Jetës me 187 milionë fitim. Rezultati financiar në tregun e Jo-Jetës për vitin 2022 është ndikuar kryesisht nga rritja e primeve të shkruara bruto, të cilat kanë qenë në nivelin 19.4 miliardë lekë, ndërkohë që shpenzimet operative janë mbajtur në të njëjtat nivele me vitin e kaluar. Ecuri pozitive kanë patur dhe të ardhurat nga investimet, të cilat kanë rezultuar në vlerën 444 milionë lekë, ndikuar kryesisht nga rritja e normave të interesit. Gjithashtu edhe në tregun e Jetës rezultati financiar, është ndikuar nga rritja e primeve të shkruara bruto, të cilat kanë qenë në nivelin 1.7 miliardë lekë.

Grafik 16: Rezultati financiar për tregun e sigurimit të Jo-Jetës dhe Jetës


(Në mln. lekë)



Raporti dëme/prime: Dëmet e paguara pa përfshirë pagesën e dëmeve nga risiguruesit (dëmet neto) në raport me primet e fituara neto në 31.12.2022, për tregun e Jo-Jetës rezultuan në nivelin 36.3% nga 34.9% një vit më parë. Për tregun e Jetës raporti dëme/prime neto për 31.12.2022 është 18.7% nga 24.1% në 31.12.2021, ndikuar nga rënia e efektit të dëmeve nga pandemia Covid-19 krahasuar me vitin 2021.

Graik 17: Raporti dëme/prime për tregun e Jo-Jetës dhe Jetës

(Në %)






Raporti i shpenzimeve, përfaqëson raportin midis shpenzimeve operative neto dhe shpenzimeve të tjera neto për sigurimet kundrejt primeve të fituara neto. Për tregun e Jo-Jetës ky raport për 31.12.2022 rezulton rreth 55%, nga 60.9% në 31.12.2021. Rënia e shpenzimeve në vitin 2022 është ndikuar edhe nga hyrja në fuqi e rregullores për kufizimin e komisioneve të ndërmjetësimit për produktet e sigurimit të detyrueshëm motorik. Për tregun e Jetës raporti i shpenzimeve për 31.12.2022 është 69.4%, nga 66.8% që ka qenë një vit më parë, duke rezultuar me një rritje prej rreth 2.6%.

Grafik 18: Raporti i shpenzimeve për tregun e Jo-Jetës dhe Jetës

(Në %)



Mbikëqyrja në distancë


Në zbatim të kuadrit rregullator, AMF ka ushtruar mbikëqyrje në distancë nëpërmjet monitorimit, mbledhjes dhe verifikimit të raportimeve të depozituara nga shoqëritë e sigurimit dhe institucione të tjera. Mbikëqyrja në distancë fokusohet tek përpunimi dhe analiza e informacionit të mbledhur nga raportimet periodike apo *ad-hoc* të shoqërive të sigurimit, me theks të veçantë tek analizat financiare dhe aktuariale. Konkretisht, në fokus të mbikëqyrjes në distancë për periudhën raportuese ishin:

- Përgatitja e raporteve të analizave financiare në distancë për shoqëritë e sigurimit Jo-Jetë dhe Jetë për periudhat tremujore, bazuar në shqyrtimin dhe përpunimin e të dhënave të dërguara nga raportimet e shoqërive të sigurimit, si dhe në informacionet nga inspektimet në vend dhe analizat financiare të mëparshme;
- Shqyrtimi i raporteve të audituesve të jashtëm për shoqëritë e sigurimit dhe grupet e sigurimit për veprimtarinë e tyre gjatë vitit paraardhës;
- Monitorimi mujor i ecurisë të normës së likuiditetit për shoqëritë e sigurimit;
- Shqyrtimi i raporteve vjetore të audituesve të brendshëm të shoqërive të sigurimit;
- Shqyrtimi i planeve vjetore të biznesit të shoqërive;
- Monitorimi i publikimit të raportit vjetor të shoqërive;
- Analizimi i raporteve të vetëvlerësimit për shoqëritë e sigurimit Jo-Jetë;
- Llogaritja me bazë tremujore e provigjoneve teknike dhe matematike, si dhe llogaritja e kufirit minimal të aftësisë paguese për shoqëritë e sigurimit;
- Analizimi i marrëveshjeve të risigurimit dhe vlerësimi i cilësisë së risiguruesve;
- Monitorimi i rreziqeve me vlerë mbi 10% të kapitalit për çdo rrezik të veçantë dhe monitorimi i dëmeve mbi 10 milionë lekë;
- Llogaritja e primit të rrezikut në nivel tregu, për kontratat e sigurimit të detyrueshëm motorik, në përputhje me rregullat e profesionit të aktuarit dhe legjislacionit në fuqi.

2.2.2 Inspektimet

Inspektime të plota me fokus rrezikun

Gjatë vitit 2022, Autoriteti vijoi me inspektimin e plotë në vend tek një nga shoqëritë e sigurimit të Jetës, sipas metodologjisë me fokus rrezikun. Inspektimet me bazë rreziku përqendrohen në vlerësimin e rreziqeve kryesore, ndaj të cilave ekspozohen



shoqëritë e sigurimit sipas aktiviteteve të biznesit, si dhe administrimi dhe zbutja e këtyre rreziqeve nga drejtimi i lartë i shoqërisë, duke vlerësuar përgjegjësitë e Këshillit Mbikëqyrës dhe menaxhimit të lartë të shoqërisë së sigurimit, në drejtim të ruajtjes së shëndetshmërisë financiare të saj.

Këto inspektime synojnë vlerësimin e rrezikut të kreditit, të sigurimit, operacional, ligjor/rregullator dhe strategjik, si dhe vlerësimin e cilësisë së kapitalit, fitimeve dhe elementeve të veçantë të aktiveve të pasqyrave financiare të shoqërisë. Gjithashtu në fokus të këtyre inspektimeve është dhe vlerësimi i menaxhimit të rrezikut, të sistemeve të kontrollit të brendshëm, përfshirë edhe rolin e niveleve drejtuese të shoqërisë në veprimtarinë e saj.

Në përfundim të inspektimit, Autoriteti vlerësoi rrezikun për çdo aktivitet të shoqërisë së sigurimit dhe përditësoi profilin e rrezikut të saj. Profili i rrezikut shërben si bazë për vendosjen e prioriteteve mbikëqyrëse dhe shpërndarjen e kapaciteteve të duhura sipas nivelit të ekspozimit të rrezikut.

Inspektime tematike

Gjatë vitit 2022, janë kryer shtatë inspektime tematike pranë shoqërive të sigurimit të Jo-Jetës. Të fokusuara në çështje që lidhen drejtpërdrejtë me mbrojtjen e konsumatorëve, në zbatim të kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi.

Verifikimi i procedurave dhe afateve për dëmshpërblim, kryesisht për dëmet e sigurimit të detyrueshëm motorik, zbatimi i rekomandimeve të vendimeve të Bordit të Autoritetit, etj. kanë qenë objekt i pesë prej inspektimeve tematike të kryera, ku u verifikuan:

- Zbatimi i kërkesave ligjore dhe rregullatore në fuqi, standardeve dhe procedurave operacionale të administrimit të dokumentacionit të dëmeve, sipas linjës së raportimit dhe nivelit të kompetencave, kryesisht për dëmet pezull dhe të paguara;
- Trajtimi i ankesave për dëmshpërblim;
- Saktësia e raportimit në Autoritet të provigjoneve teknike të dëmeve, etj.

Gjithashtu, në zbatim të kuadrit rregullator në fuqi dhe kushteve të përgjithshme të miratuara nga Autoriteti për kontratat e lidhura me përgjegjësinë e ndërtuesit, janë kryer dy inspektime të tjera tematike, me qëllim shqyrtimin e procesit të marrjes në sigurim për këtë përgjegjësi, fokusuar në:

- Verifikimin e përputhshmërisë së elementëve dhe kushteve të përgjithshme të kontratave të lëshuara gjatë periudhës objekt inspektimi;
- Procedurat e brendshme të marrjes në sigurim dhe përgjegjësitë e kontraktuara nga shoqëria e sigurimit;
- Mbulimin me risigurim për kontratat e sigurimit të lidhura me përgjegjësinë e ndërtuesit.


Në përfundim të inspektimeve, Autoriteti iu komunikoi shoqërive të sigurimit gjetjet dhe rekomandimet përkatëse, duke adresuar me vendime Bordi problematikat e konstatuara dhe masat e nevojshme për zbatimin e tyre. Ndjekja dhe zbatimi i këtyre vendimeve monitorohet në vijimësi nga Autoriteti, në drejtim të respektimit të afateve dhe përmbushjes së kërkesave të tyre.

Inspektime të përbashkëta

Gjatë vitit 2022 janë kryer 2 inspektime të përbashkëta me Autoritetin Austriak të Tregjeve (FMA), zhvilluar në Austri dhe Shqipëri, bazuar në Memorandumin e Mirëkuptimit me Autoritetin e Tregjeve Financiare të Austrisë.

Objekt i këtyre inspektimeve ishte verifikimi i zbatimit të politikave të Grupit të sigurimit, konkretisht mbi:

- Funksionin e zbatueshmërisë (*Compliance*);
- Administrimin e aseteve-Investimet (*Asset management*);
- Politikat e shpërblimeve të stafit (*Remuneration policy*);
- Përshtatjen e politikave të grupit me kuadrin rregullator të AMF-së;
- Shqyrtimin e monitorimit nga grupi të zbatimit të politikave të tij mbi këto funksione;



- Funksionimin e strukturave të dedikuara në shoqëri për zbatimin e këtyre politikave;
- Raportimi tek grupi i sigurimit mbi zbatimin e tyre.

Në fund të procesit të inspektimit, konstatimet dhe rekomandimet e propozuara nga Autoriteti iu komunikuan subjekteve të inspektuara dhe Autoritetit Austriak të Tregjeve.

2.2.3 Mbikëqyrja e grupeve

Në përputhje me Ligjin nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, Autoriteti kryen mbikëqyrje plotësuese ndaj shoqërive të sigurimit të strukturuar në grup sigurimi. Grupi i sigurimit, për qëllime të mbikëqyrjes, përbëhet nga dy ose më shumë persona juridikë, ku të paktën njëri është shoqëri sigurimi dhe tjetri ka ndikim të rëndësishëm në shoqërinë e sigurimit. Ndikimi i rëndësishëm përcaktohet bazuar në kriterin e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë ose të tërthortë, ndikimit dhe/ose detyrimeve të ndryshme kontraktuale, lidhjet brenda grupit, ekspozimit ndaj rrezikut, përqendrimit të rrezikut, transferimit të rrezikut, përqindjes së zotërimit të pronësisë dhe/ose transaksionet brenda grupit.

Në tregun e sigurimeve në Shqipëri, gjatë vitit 2022, kanë ushtruar veprimtari 4 grupe sigurimi, nga të cilat 2 grupe janë me kapital vendas dhe dy të tjerat me kapital të huaj.

Mbikëqyrja efektive e grupeve të sigurimit, bazohet në parimet themelore të sigurimeve (*International Core Principles*), të miratuara nga Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve në Sigurime (IAIS), si dhe në marrëveshjet e bashkëpunimit të nënshkruara nga AMF me mbikëqyrësit e vendeve ku ushtrojnë veprimtarinë shoqëritë e sigurimit me kapital shqiptar dhe mbikëqyrësit e grupeve të sigurimit ndërkombëtar që ushtrojnë veprimtari në Shqipëri.

Në vitin 2022, janë kryer takime midis Autoritetit dhe kolegjeve mbikëqyrëse së grupeve të sigurimeve, Uniqa Group Austria dhe Vienna Insurance Group.

Këto kolegje zhvillohen në funksion të mbikëqyrjes efektive të shoqërive të sigurimit dhe risigurimit, nëpërmjet shkëmbimit të informacionit në lidhje me ecurinë e aktivitetit të tyre. Autoriteti raportoi mbi mbarëvajtjen dhe performancën e shoqërive të sigurimit, pjesë e grupeve Uniqa Group Austria dhe Vienna Insurance Group, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Shqipëri.

Autoriteti, ka vijuar edhe me takime me përfaqësues të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), në kuadër të kolegjeve mbikëqyrëse rajonale për dy grupe sigurime, në cilësinë e Autoritetit rregullator të shoqërive mëmë të grupeve të sigurimit që ushtrojnë veprimtarinë e tyre dhe në Republikën e Kosovës. Në këto kolegje janë diskutuar ecuria e shoqërive të sigurimit dhe ndikimi i ndërsjelltë i masave të marra nga dy rregullatorët.

Autoriteti, gjithashtu po shqyrton mundësinë e zgjerimit të këtyre kolegjeve rajonale, për të përfshirë edhe grupet e tjera të sigurimit që ushtrojnë aktivitet në vendet e tjera të rajonit.

2.2.4 Provigjonet Teknike

Në vlerësimin e shëndetit financiar të shoqërive të sigurimit, një tregues i rëndësishëm është niveli i provigjoneve teknike. Autoriteti vlerëson nëse provigjonet teknike janë të mjaftueshme, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe me nivelin e rrezikut të kontraktuar nga shoqëritë. Mospërbushja e këtij detyrimi përbën shkelje të rregullave të menaxhimit të rrezikut nga shoqëritë e sigurimit.

Ecuria në nivel tregu e provigjoneve teknike ndër vite shfaq një tendencë në rritje, duke ruajtur dhe strukturën e aktivitetit Jetë dhe Jo-Jetë. Në fund të vitit 2022, provigjonet teknike bruto, në total për aktivitetin Jetë dhe Jo-Jetë janë rreth 23.7 miliardë lekë. Krahasuar me vitin 2021, ku provigjonet bruto në nivel tregu rezultuan rreth 22 miliardë lekë, në vitin 2022 vihet re një rritje e këtyre provigjoneve teknike bruto me rreth 7.7%, ose rreth 1.7 miliardë lekë. Për aktivitetin e Jo-Jetës rritja rezulton të jetë rreth 1.52 miliardë lekë, ose rreth 7.7%, ndërsa për shoqëritë që ushtrojnë aktivitetin në klasat e Jetës rezulton një rritje e provigjoneve teknike bruto me rreth 180 miliardë lekë, ose rreth 8%.




Peshën më të lartë nga pikëpamja e veprimtarisë së ushtruar e mbajnë provigjonet teknike bruto të shoqërive të Jo-Jetës, me 89.8% të totalit të provigjoneve teknike bruto ose rreth 21.3 miliardë lekë. Ndërsa provigjonet teknike bruto për aktivitetin e Jetës arrijnë në 2.41 miliardë lekë, ose 10.2% e totalit. Kjo strukturë reflekton gjithashtu edhe raportin e primeve të shkruara bruto për aktivitetin e Jo-Jetës dhe atyre të Jetës kundrejt totalit, përkatësisht 92% dhe 8%.

Nga të dhënat në nivel tregu, të pasqyruara në grafikun e mëposhtëm, vihet re tendenca në rritje e treguesit të provigjionit teknik të dëmeve dhe primeve.

Grafik 19: Provigjoni teknik bruto

(Në mld. lekë)



Provigjoni Teknik

Provigjoni teknik është shuma e llogaritur në bazë të një parashikimi dhe sipas mënyrave aktuariale të caktuara, e cila mbahet nga siguruesi, për të mbuluar përgjegjësitë që rrjedhin nga kontratat e sigurimit.

Provigjonet teknike përfshijnë:

- Provigjonet për prime, të cilat përbëhen nga provigjonet për primet e pafituara dhe për rreziqe të paskaduara. Këto provigjone krijohen në përpjesëtim me primet e shkruara që lidhen me mbulimet e sigurimit, të cilat janë ende të vlefshme pas përfundimit të periudhës financiare gjatë së cilës janë krijuar këto provigjone;
- Provigjonet për bonuse dhe rabate, të cilat krijohen në nivel të njëjtë me shumën e pagesave që merr i siguruari bazuar në të drejtën për përfitimet që rrjedhin nga kontratat e sigurimit, të drejtën për reduktim të pjesshëm të primit të sigurimit (rabat) si dhe të drejtën e rimbursimit të një pjese të primit të sigurimit në rast të përfundimit të parakohshëm të kontratës së sigurimit;
- Provigjonet teknike të dëmeve, të cilat krijohen në rastin e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit para përfundimit të periudhës së sigurimit të kontratës së sigurimit dhe vlerësimi i tyre bëhet në nivel të njëjtë me përgjegjësitë e marra përsipër nga shoqëria e sigurimit nëpërmjet kontratës së sigurimit;
- Provigjone për mbrojtjen për rrezikun ndaj investimit;
- Provigjone të tjera teknike. Këto provigjone krijohen nga shoqëritë e sigurimit me qëllim për të mbuluar përgjegjësitë e pritshme dhe rreziqet për dëme të mëdha, të cilat rrjedhin nga sigurimi i përgjegjësishë për humbje nga rreziqe bërthamore, përgjegjësinë e prodhuesit të produkteve farmaceutike si dhe rreziqet e përmbytjes dhe tërmetit.

Provigjonet matematike krijohen në nivel të njëjtë me vlerën aktuale të detyrimeve të ardhshme që rrjedhin nga kontratat e sigurimit të Jetës, duke zbritur vlerën aktuale të parashikuar për primet e ardhshme për t'u paguar sipas kontratës në fjalë.

Provigjoni teknik bruto për sigurimin e detyrueshëm motorik (MTPL)

Provigjoni teknik bruto për produktet MTPL zë peshën specifike më të lartë në totalin e provigjoneve teknike të tregut të Jo-Jetës. Ky tregues, për 31.12.2022, arrin në rreth 14.17 miliardë lekë, duke pësuar kështu një rritje me rreth 7.1% krahasuar me vitin e kaluar. Pësuar e provigjoneve teknike bruto për portofolin e MTPL është 67% dhe është në të njëjtat nivele si në fund të vitit 2021.



Për sa i përket peshës dhe strukturës së provigjoneve teknike të sigurimit të detyrueshëm, vërehet që peshën më të lartë e ka provigjoni teknik i dëmeve, në krahasim me provigjonin e primit të pafituar, duke ruajtur të njëjtën strukturë ndarjeje edhe gjatë vitit 2022. Në vazhdimësi, AMF ka dhënë rekomandime për përmirësimin në rritje të treguesit të provigjonit teknik të dëmeve nga sigurimi i detyrueshëm, në përputhje me rritjen e aktivitetit të tregut të sigurimeve. Këto rekomandime janë bazuar në analizat e të dhënave të shoqërive të sigurimit, në gjetjet e konstatuara gjatë inspektimeve në vend, si dhe nga informacioni për dëmet në proces gjyqësor, lidhur me detyrimet dhe rrezikun ndaj të cilit janë të ekspozuara shoqëritë e sigurimit.

Tabelë 8: Pësha dhe struktura e provigjoneve teknike të sigurimit të detyrueshëm

(Në mld. lekë)

Pësha e provigjoneve teknike të sigurimit të detyrueshëm	2018	2019	2020	2021	2022
Provigjone bruto total MTPL	10.73	11.80	12.37	13.23	14.17
Provigjone bruto total Jo-Jeta	14.67	20.20	18.96	19.78	21.30
Pësha specifike e sigurimeve të detyrueshme kundrejt totalit për tregun (Në %)	73	58	65	67	67
Struktura e provigjoneve teknike të sigurimit të detyrueshëm (Në%)	2018	2019	2020	2021	2022
Provigjoni teknik për dëmet MTPL	54	56	56	56	56
Provigjoni i Primit të pafituar MTPL	46	44	44	44	44
Provigjone bruto total MTPL	100	100	100	100	100

Aplikacioni për përlogaritjen e dëmeve ndaj personit në aksidentet rrugore

Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 32/2021, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, dhe miratimit nga Autoriteti të Rregullores nr. 125, datë 28.07.2021, “Për përcaktimin e rregullave dhe metodologjisë së llogaritjes së dëmshpërblimit që mbulohet nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”, Autoriteti zhvilloi aplikacionin e llogaritës të dëmeve ndaj personit, në rastet e aksidenteve nga mjetet motorike në sektorin e transportit, i cili bazohet në disa supozime, vlerat e përlogaritura janë orientuese dhe synojnë të informojnë përdoruesit mbi masën e dëmshpërblimit. Aplikacioni është ndërtuar për përlogaritjen e vlerës së dëmshpërblimit në rastet e dëmit ndaj personit me pasojë paaftësinë e përhershme për punë, ose me pasojë vdekjen.

Risite kryesore që ka sjellë ky aplikacion për të siguruarit dhe profesionistët e fushës janë:

- Përlllogaritja automatike e vlerës së dëmit;
- Transparencë mbi vlerën e dëmit pasuror dhe dëmit jopasuror, dhe pasqyrimi i vlerës për çdo figurë dëmi;
- Edukim të konsumatorëve në fushën e sigurimeve.

Viti 2022 ishte viti i dytë që ky aplikacion po u vjen në ndihmë palëve përfituese, si edhe vetë profesionistëve/ekspertëve të fushës në vlerësimin e dëmit dhe trajtimin e kërkesave për dëmshpërblim. Gjatë kësaj periudhe është vënë re një përdorim i gjerë i këtij aplikacioni si nga konsumatorët, ashtu dhe nga profesionistët në fushën e sigurimeve.

2.2.5 Risigurimet

Risigurimi është forma kryesore e transferimit të rrezikut, në industrinë e sigurimeve në Republikën e Shqipërisë, duke luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin dhe stabilitetin e këtij tregu. Bazuar në kuadrin ligjor dhe aktet rregullatore, të miratuara nga Autoriteti, shoqëritë e sigurimit janë të detyruara të risigurojnë në një shoqëri risigurimi atë pjesë të rrezikut të siguruar që tejkalon limitin e lejuar prej 10% të vlerës së kapitalit. Shoqëritë e sigurimit nëpërmjet risigurimit zvogëlojnë ekspozimin ndaj rreziqeve të mëdha, përmirësojnë kërkesat për kapital (aftësi paguese), rrisin mundësinë për të siguruar më shumë rreziqe, si dhe marrin asistencë teknike dhe financiare nga shoqëritë risigurouese. Aktiviteti i risigurimit është i konsoliduar, ndikuar edhe nga kërkesat e përcaktuara në Rregulloren nr. 85/1, datë 30.09.2015, "Për kriteret e risigurimit", e ndryshuar.

Në bazë të kërkesave ligjore dhe rregullatore, shoqëritë e sigurimit raportojnë në Autoritet programin vjetor të risigurimit. Bazuar në funksionin e tij mbikëqyrës, Autoriteti ndjek ecurinë e zbatimit të këtij programi dhe kontratave të lidhura, duke synuar stabilitetin e vazhdueshëm financiar, në lidhje me standardet e mbajtjes së rrezikut nga këto shoqëri risigurimi dhe kriteret e lidhura me cilësinë e risiguroesve.

Marrëveshjet e risigurimit, në portofolet e sigurimit të Jo-Jetës, janë të formës joproporcionale, kryesisht të tipit *Excess of Loss* (Tejkalim humbjeje) dhe të formës proporcionale, të tipit *Quota Share/Surplus*. Në sigurimin e Jetës, mbulimi me risigurim është kryer nëpërmjet marrëveshjeve risiguroese të formës proporcionale të tipit *Surplus dhe Quota Share*.



Primet e ceduara në risigurim për 31.12.2022 rezultojnë:

- Për totalin e tregut të sigurimeve në vlerën e rreth 3.22 miliardë lekë ose sa 15.3% e vlerës së primeve të shkruara bruto në nivel tregu. Vlera e primeve të ceduara në risigurim, në nivel tregu, krahasuar me fundvitin 2021, është rritur me rreth 394.2 milionë lekë ose rreth 14%;
- Për aktivitetin e Jo-Jetës në vlerën prej rreth 3.13 miliardë lekë ose sa 16.2% e vlerës së primeve të shkruara bruto. Vlera e primeve të ceduara në risigurim, për gjithë aktivitetin e Jo-Jetës, krahasuar me fundvitin 2021, është rritur me rreth 371.9 milionë lekë ose rreth 13.5%;
- Për sigurimin e Jetës në vlerën prej rreth 89.7 milionë lekë ose sa 5.3% e vlerës së primeve të shkruara bruto për sigurimin e Jetës. Primet e ceduara në risigurim për sigurimin e Jetës, janë rritur me rreth 22.3 milionë lekë ose 33.1% më shumë krahasuar me fundin e vitit 2021.


Në vitin 2022, krahasuar me vitin 2021, ka rritje të primeve të ceduara në risigurim në të gjithë portofolet. Për vitin 2022, konstatohet se peshën më të madhe ndaj primeve totale të ceduara në risigurim e zënë produktet “Motorike” me rreth 55% të totalit dhe produkti “Zjarri dhe të tjera të pronës” me rreth 31.6%.

Tabelë 9: Primet e ceduara në risigurim sipas portofoleve kryesore, 2021 dhe 2022

(Në mln. lekë)

<i>Lloji i Sigurimit</i>	<i>2021</i>	<i>2022</i>
Aksidente dhe shëndet	10	52
Motorike	1,572	1,720
Zjarri e të tjera të pronës	926	987
Përgjegjësi	138	175
Të tjera	109	192
Total	2,755	3,127


Grafik 20: Pesha specifike e risigurimeve sipas portofoleve kryesore për vitin 2022 krahasuar me vitin 2021 (Në %)



Në bazë dhe për zbatim të Rregullores nr. 57, datë 26.05.2017 “Mbi llogaritjen e Mbajtjes Neto të Mbulimit Maksimal Agregat të rreziqeve që rrjedhin nga kontratat e sigurimit”, referuar ekspozimit më 31.12.2022, shoqëritë e sigurimit kanë raportuar dhe normën e mbajtjes agregate neto për sigurimin nga tërmeti. Bazuar në marrëveshjet e risigurimit në fuqi, tregu i sigurimeve mund të përballojë pa cenuar treguesit financiarë dëme, deri në rreth 195 milionë euro. Risigurimi është kryer në përputhje me kërkesat e Rregullores nr. 85/1, datë 30.09.2015 “Për kriteret e risigurimit”, e ndryshuar.

Referuar agjencive klasifikuese Standard & Poors, Fitch, Moody’s, etj., cilësia e risiguresve kryesorë të marrëveshjeve që mbulojnë aktualisht rreziqet e ceduara në risigurim nga shoqëritë e sigurimit, rezulton së paku në kategorinë e vlerësimit A, që do të thotë edhe më cilësore nga sa kërkohet nga kuadri rregullator në fuqi.

Aktiviteti i risigurimit, si element i rëndësishëm i menaxhimit të rrezikut, u vlerësua nga Ekipi i Ekspertëve të Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve në Sigurime (IAIS), në përputhje të plotë me parimet ndërkombëtare themelore të sigurimeve, të miratuara nga IAIS.



Raportet e vetëvlerësimit të rreziqeve (ORSA)

Raporti i vetëvlerësimit të rrezikut dhe aftësisë paguese (*Own Risk and Solvency Assessment – ORSA*) dorëzohet në Autoritet, me një frekuencë vjetore, nga çdo shoqëri që ushtron aktivitet në klasat e sigurimit të Jetës dhe Jo-Jetës. Detyrimi për raportim periodik parashikohet në Rregulloren nr.18, datë 28.4.2015, “Për rregullat e organizimit të sistemit të administrimit të rrezikut në shoqërinë e sigurimit”. Ky detyrim është, gjithashtu, në përputhje me standardet e Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve në Sigurime (IAIS).

Kriteret mbi përmbajtjen e raportit përcaktohen në nenin 12 të rregullores, duke siguruar kështu një formë standarde të raportit dhe krahasueshmëri të informacionit të paraqitur. Çdo raport pasqyron në mënyrë të plotë elementët e mëposhtëm:

- Kuadrin e administrimit të rrezikut;
- Kategoritë e rreziqeve;
- Kuadrin e raportimit;
- Administrimin e kapitalit;
- Rreziqet e identifikuara dhe vlerësimin e tyre;
- Planet e vijueshmërisë së veprimtarisë dhe përballimit të situatave të paparashikuara;
- Rekomandimet dhe masat;
- Profilin e përgjithshëm të rrezikut.

Ky raport lejon Autoritetin të vlerësojë në mënyrë objektive ekspozimin e çdo shoqërie sigurimi ndaj rreziqeve me materialitet të lartë, masat e saj të kontrollit, si dhe efikasitetin e këtyre masave, me qëllim mirëfunksionimin e aktivitetit, si në nivel shoqërie sigurimi ashtu dhe tregu në përgjithësi.

Shoqëritë e sigurimit në raportet e vetëvlerësimit për vitin 2022, evidentuan përballjen me rreziqe të reja pas situatës së pandemisë Covid-19 dhe dinamikave të tregut, ku rreziku parësor cilësohej rreziku kibernetik, krahas atij ligjor dhe rregullator.

2.2.6 Ecuria e Fondit të Kompensimit

Fondi i Kompensimit për vitin 2022

Fondi i Kompensimit për vitin 2022, në mbyllje të vitit financiar rezulton me një tepricë prej rreth 19 milionë lekë, ose me një realizim në masën rreth 108% të detyrimit të fondit për vitin 2022.


Bordi i Autoritetit me Vendimin nr. 28, datë 28.02.2022, ka miratuar Fondin e Kompensimit për vitin 2022 në vlerën 250 milionë lekë, nga të cilat balanca e Fondit të Kompensimit më 31.12.2021, ka rezultuar me tepricë rreth 10 milionë lekë. Byroja Shqiptare e Sigurimit (BSHS) ka pasqyruar, llogaritur dhe shpërndarë Fondin e Kompensimit për vitin 2022 sipas shoqërive të sigurimit, anëtare të saj. Referuar të dhënave të depozituara nga BSHS, gjatë periudhës janar-dhjetor 2022, vlera e paguar për Fondin e Kompensimit të vitit 2022 është rreth 259 milionë lekë, ose rreth 108% e detyrimit të periudhës.


Duke krahasuar të dhënat e raportuara, rezulton se dëmet objekt fond kompensimi pezull më 31.12.2022 janë ulur në numër me 122 dhe në vlerë me 32,589,604 lekë. Pjesë e konsiderueshme e dëmeve pezull janë dëmet në proces gjyqësor, që i përkasin ngjarjeve përpara hyrjes në fuqi të Ligjit 32/2021 (datë ngjarjeje para 1 korrik 2021), të cilat rezultojnë në vlerën 583,439,029 lekë, ose rreth 82.80% të dëmeve në proces.

Pas hyrjes në fuqi të Ligjit 32/2021, si për rastet e fondit të kompensimit ashtu edhe për rastet që trajtohen drejtpërdrejtë nga shoqëritë e sigurimit, rezulton se nuk ka asnjë çështje në proces gjyqësor.

Grafik 21: Ecuria e pagesave Janar-Dhjetor 2022

(Në mln. lekë)





Gjatë vitit 2022, shoqëritë e sigurimit anëtare të BSHS-së, përveç pagesave të detyrimeve të Fondit të miratuar, kanë kryer edhe pagesa si sigurues të drejtpërdrejtë në funksion të entit kompensues, për dëme shkaktuar nga mjete të pasiguruara/paidentifikuara, në vlerën rreth 31.5 milionë lekë, sipas kërkesave të nenit 43, të Ligjit nr. 32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”.

Klasifikimi i rasteve që trajtohen nga Fondi i Kompensimit dhe nga shoqëritë e sigurimit, si sigurues të drejtpërdrejtë, sipas Ligjit nr. 32/2021, ka ndikuar në uljen e Fondit të Kompensimit për rastet e parashikuara në nenin 41, të këtij ligji. Ky klasifikim ka adresuar rreth 80 % të rasteve drejtpërdrejtë tek shoqëritë e sigurimit, sipas nenit 43. Dëmet objekt Fond Kompensimi mbeten në vlera të konsiderueshme, për shkak të ngjarjeve të ndodhura përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Autoriteti, gjatë vitit 2022, ka kryer inspektime në vend pranë shoqërive të sigurimit dhe Byrosë Shqiptare të Sigurimit. Inspektimet pranë 8 shoqërive të sigurimit anëtare të BSHS-së, lidhen me verifikimet e pagesave të dëmeve objekt i Fondit të Kompensimit, për vitin 2021 dhe tremujorin e parë të vitit 2022, si dhe verifikimin e pagesave dhe statusin e praktikave të dëmeve, me ngjarje sigurimi pas hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 32/2021, për të cilat shoqëria e sigurimit kryen funksionin e entit kompensues. Gjithashtu gjatë këtyre inspektimeve u verifikuan dhe procedurat, afatet dhe raportimet, që ndiqen nga shoqëria e sigurimit lidhur me trajtimin, pagesën dhe rimbursimin e dëmeve.

Inspektimi pranë Byrosë Shqiptare të Sigurimit lidhet me verifikimin e masave të marra prej saj, nga rekomandimet e lëna në inspektimin e kryer gjatë vitit 2021, si dhe zbatimin e Vendimit të Bordit të Autoritetit nr.16, datë 31.01.2022.

Dalja e BSHS-së nga statusi i monitorimit

Byroja Shqiptare e Sigurimit është përfaqësuese kombëtare në Këshillin e Byrove dhe është përgjegjëse për të gjitha detyrimet që rrjedhin nga anëtarësia në sistemin e Kartonit Jeshil.

Në tetor 2013, BSHS u vendos në statusin e monitorimit nga Këshilli i Byrove. Disa nga rekomandimet e këtij Këshilli kanë qenë:

- (i) Të provuarit e fondeve/garancive që BSHS duhet të posedojë në cilësinë e Byrosë Garantuese (për dëme të ndodhura jashtë Shqipërisë), dhe cilësinë e Byrosë Trajtuese (për dëme të ndodhura në Shqipëri);

- (ii) Të provuarit e mosekzistencës së rasteve të thirrjeve të garancisë (kur anëtarët e BSHS-së, nuk paguajnë në afat, dëmet e ndodhura jashtë Shqipërisë);
- (iii) Siguria juridike në kuadrin e transparencës së kriterëve që duhet të plotësojë një subjekt për të funksionuar si korrespondent dëmsh Kartoni Jeshil në Shqipëri;
- (iv) Një frymë e mirë bashkëpunimi ndërmjet BSHS dhe byrove homologe, veçanërisht në rastet e aksidenteve në Shqipëri, me të dëmtuar shtetas të huaj.

Monitorimi i Byrosë ka qenë në fokus të Autoritetit, veçanërisht gjatë viteve të fundit, për t'u dhënë zgjidhje problematikave të mbartura ndër vite. Adresimi i këtyre problematikave ishte një nga objektivat kryesore të Ligjit të ri 32/2021 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit".

Të gjitha ndryshimet ligjore, të cilat përmbajnë dispozita që lidhen me Fondin e Garancisë, fondin për pagesën e dëmeve të Kartonit Jeshil, riorganizimin e Byrosë dhe shmangien e konfliktit të interesit, si dhe dispozita të tjera që rregullojnë trajtimin e dëmeve si dhe administrimin e Kartonit Jeshil, kanë sjellë një përmirësim të ndjeshëm të situatës me Byronë Shqiptare të Sigurimit. Gjithashtu, ato kanë mundësuar një reformim strukturor të Byrosë, përmes ndarjes së saj me dy departamente, ku tashmë Kartoni Jeshil është tërësisht i ndarë nga Fondi i Kompensimit.

Aktualisht çdo anëtar i BSHS-së ka investuar në depozita me afat Fondin e Garancisë së Kartonit Jeshil në vlerën 250,000 Euro, në favor të BSHS-së pranë bankave të nivelit të dytë. Gjithashtu Byroja disponon fondin për pagesën e dëmeve të shkaktuara nga mjete me targa të huaja dhe të pajisura me Karton Jeshil, në shumën prej 500,000 Euro, në një llogari qëllimore të veçantë.

Anëtarët e Bordit të Mbikëqyrjes së Këshillit të Byrove, në mbledhjen e tij zhvilluar në datat 30 nëntor - 1 dhjetor 2022, pasi njohën progresin e arritur në vitet e fundit nga Byroja Shqiptare e Sigurimit, si dhe konstatuan plotësimin e kriterëve të vendosura, miratuan heqjen e statusit të monitorimit të saj.

Përsa i përket kriterëve financiarë që lidhen me skemën e risigurimit dhe garancinë bankare, Bordi i Mbikëqyrjes së Këshillit të Byrove, vendosi që BSHS të vazhdojë të mbajë të njëjtat kriterë, për marrëveshjen e risigurimit të Kartonit Jeshil, ndërsa për garancinë bankare mbajtjen vetëm të garancisë së Kartonit Jeshil, të parashikuar në Ligjin nr.32/2021.

Autoriteti monitoron dhe mbikëqyr në mënyrë periodike veprimtarinë e BSHS-së lidhur me përmbushjen e detyrimeve ligjore, si nëpërmjet raportimit, ashtu dhe nëpërmjet inspektimeve në vend.



2.3 Mbikëqyrja e Tregut të Fondeve të Pensionit Vullnetar

2.3.1 Pozicioni Financiar

Tregu i fondeve të pensionit vullnetar që prej fillimit të aktivitetit të tij, ka patur tendencë në rritje, përse i përket aseteve që administrojnë dhe numrit të anëtarëve.

Totali i aseteve neto të këtij tregu më 31.12.2022 është 5.7 miliardë lekë me një numër prej 36,518 anëtarë. Asetet neto të këtij tregu më 31.12.2022 kanë pësuar një rritje me 24.32%, ndërsa numri i anëtarëve është rritur 8.78% krahasuar me fundin e vitit 2021. Ecuria e vlerës neto të aseteve të tregut të fondeve të pensionit vullnetar për dy vitet e fundit, si dhe rritja për vitin 2022 krahasuar me 2021 jepet në tabelën e mëposhtme.


Tabelë 10: Ecuria e aseteve neto të fondeve të pensionit vullnetar

Përshkrimi	Vlera (mln. lekë)		Ndryshimi (Në %)
	2021	2022	31.12.'21 - 31.12.'22
Asetet neto të tregut	4,584.54	5,699.38	24.32

Në grafikun e mëposhtëm është paraqitur ecuria e aseteve neto të tregut të fondeve të pensionit gjatë 5 viteve të fundit e shprehur në milionë lekë. Vlera e aseteve neto dhe vlera e aseteve neto për kuotë për secilin nga fondet e pensionit ka patur një tendencë në rritje që prej licencimit të këtyre fondeve.

Grafik 22: Ecuria në vite e aseteve neto të fondeve të pensionit

(Në mln. lekë)



Asetet e këtij tregu në 31.12.2022 janë investuar kryesisht në obligacione të qeverisë shqiptare. Investimet në obligacione të RSH-së përbëjnë 96.10% të totalit të aseteve të tregut të fondeve të pensionit dhe janë rritur me 30.57%, krahasuar me fundvitin 2021. Pjesa tjetër e aseteve konsiston në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare dhe në llogari të arkëtueshme. Struktura e aseteve të tregut të fondeve të pensionit vullnetar dhe ndryshimet gjatë dy viteve të fundit jepen në tabelën e mëposhtme:

Tabelë 11: Ndryshimi i strukturës së aseteve të tregut të fondeve të pensionit vullnetar, 31.12.2022 krahasuar me 31.12.2021


Përshkrimi	Vlera (Në mln. lekë)		Ndryshimi (Në %)	Pjesa ndaj totalit (Në %)	
	31.12.'21	31.12.'22		31.12.'21- 31.12.'22	31.12.'21
Periudha					
Asetet neto të fondeve të pensionit	4,584.54	5,699.38	24.32		
Totali i aseteve të fondeve	4,598.98	5,716.76	24.30	100	100
<i>nga të cilët:</i>					
Mjete Monetare dhe Ekuivalentë të Mjeteve Monetare	301.81	109.17	-63.83	6.56	1.91
Obligacione Thesari të RSH	4,207.68	5,494.05	30.57	91.49	96.10
Depozita bankare	-	-	-	-	-
Asete të tjera	89.50	113.54	26.86	1.95	1.99
Totali i Detyrimeve të Fondeve	14.44	17.38	20.32	0.31	0.30

Në grafikun më poshtë është paraqitur ecuria e investimeve të tregut të fondeve të pensionit gjatë 5 viteve të fundit.



Grafik 23: Ecuria e investimeve të tregut të фондеве të pensionit vullnetar


(Në mln.lekë)



Duke marrë në konsideratë që detyrimet e фондеве të pensionit vullnetar janë afatgjata pasi anëtarët mund të tërhiqen kur arrijnë moshën e pensionit, atëherë edhe politika e investimeve për të gjitha fondet e pensionit, të cilat ushtrojnë aktivitetin e tyre në treg është afatgjatë duke mbartur në këtë mënyrë dhe rrezikun e tregut. Politika e investimeve të фондеве të pensionit ka synuar në instrumente me maturime 5, 7, 10 dhe 15 vjeçare, siç mund të shihet dhe në grafikun më poshtë ku vihet re se pjesën më të madhe e zënë investimet në obligacione me afat maturimi 10 vjeçar në masën 59.81%.


Grafik 24: Ndarja sipas maturimit të investimeve të tregut të фондеве të pensionit vullnetar, 31.12.2022

(Në %)



Numri i anëtarëve në fondet e pensionit vullnetar më 31.12.2022 ka arritur në 36,518, duke patur një rritje prej 8.78% në krahasim me 31.12.2021. Siç tregon edhe grafiku më poshtë, i cili paraqet ecurinë e numrit të anëtarëve të tregut të fondeve të pensionit, gjatë 5 viteve të fundit numri i anëtarëve në fondet e pensionit vullnetar ka ardhur duke u rritur.


Grafik 25: Ecuria e numrit të anëtarëve të tregut të fondeve të pensionit vullnetar (Në numër)



Në 31.12.2022 në planet individuale të pensionit vullnetar janë përfshirë 19,126 anëtarë ose 52.37% e numrit të anëtarëve në treg, dhe në planet profesionale të pensionit vullnetar të krijuara nga punëdhënësit për punonjësit e tyre janë përfshirë 17,162 anëtarë, të cilët përbëjnë 47% të numrit të anëtarëve në treg. Ndërsa 230 anëtarë ose 0.63% janë përfshirë njëkohësisht në planet individuale dhe ato profesionale.



Grafik 26: Ndarja e anëtarëve të fondeve të pensionit vullnetar sipas planeve të pensionit,
31.12.2022 (Në %)



Mbikëqyrja me bazë rrezikun dhe analiza e rreziqeve të tregut

Tregu i fondeve të pensionit vullnetar mbikëqyret sipas metodologjisë me bazë rreziku, e cila synon evidentimin e rreziqeve të mëdha që prekin këtë treg dhe zbatimin e strategjive të duhura për zbutjen e tyre në një nivel të pranueshëm. Kjo metodologji, me qëllim zhvillimin e një procesi të shëndoshë për vlerësimin e rrezikut, ka parashikuar gjithashtu ngritjen e Komitetit të Rrezikut për Fondet e Pensionit, i cili mblidhet rregullisht dy herë në vit.

Gjatë mbledhjeve të Komitetit të Rrezikut në vitin 2022 janë prezantuar matricat e rrezikut të pranishëm dhe rrezikut të mbetur në sistem dhe është kryer vlerësimi i tyre, duke identifikuar rreziqet që kërkojnë ndërhyrje më të shpejtë në sistem. Kështu, si rreziku më i madh në kushtet e Shqipërisë u identifikua pjesëmarrja e ulët në skemat e pensionit vullnetar, gjë që ka lidhje edhe me besueshmërinë në sistem. Komiteti i Rrezikut, gjatë vitit 2022, ka miratuar planin e mbikëqyrjes për një periudhë afatmesme për tregun e fondeve të pensionit.

2.3.2 Inspektimet


Gjatë vitit 2022, Autoriteti ka kryer inspektime tematike pranë dy shoqërive administruese, të cilat administrojnë fonde pensioni. Fokusi i këtyre inspektimeve ka qenë vlerësimi i detyrimeve rregullatore në lidhje me kryerjen e veprimtarive promociionale për fondet nën administrim dhe vlerësimin e aseteve të fondeve.

Metodologjia e përdorur gjatë inspektimeve tematike, përfshiu mbledhjen e informacionit të nevojshëm paraprak në lidhje me objektin e inspektimit, kryerjen e intervistave dhe verifikimin në vend të këtyre informacioneve.

Disa nga çështjet që u verifikuan gjatë inspektimeve janë renditur më poshtë:

- Kryerja e veprimtarisë promociionale për fondet e pensionit që shoqëritë administrojnë;
- Zbatimi i bazës ligjore dhe rregullatore në lidhje me metodologjinë e vlerësimit të aseteve të fondeve të pensionit nëpërmjet:
 - o Dokumentacionit në lidhje me vlerësimin e aseteve të fondeve nën administrim dhe verifikimit të transaksioneve me titujt;
 - o Shqyrtimit të procedurave të llogaritjes së vlerës neto të aseteve, verifikimit të procesit të shkëmbimit të informacionit dhe rakordimit ditor me depozitarin;
 - o Verifikimit të shlyerjeve të kuotave/aseteve të anëtarit të fondit të pensionit.

Autoriteti pas çdo inspektimi ka lënë rekomandimet përkatëse, për të cilat shoqëritë administruese kanë marrë masat për zbatimin e tyre.



3.1 Rregullimi i Tregut të Fondeve të Pensionit Vullnetar

Viti 2022 shënoi zhvillime të rëndësishme sa i përket kuadrit rregullator. Gjatë këtij viti, Autoriteti hartoi Projektligjin “Për fondet e pensionit privat”, i cili synon përafrimin me Direktivat evropiane, si edhe krijimin e kushteve të favorshme për zhvillimin e tregut të fondeve private të pensionit. Ky projektligj është propozuar për shqyrtim e miratim në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, me Vendimin nr. 578, datë 12.12.2022, të Këshillit të Ministrave, pas propozimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, sipas relacionit të dërguar nga ana e Autoritetit.

Projektligji “Për fondet e pensionit privat”, përafrohet me Direktivën 2016/2341/KE “Për Veprimtarinë dhe Mbikëqyrjen e Institucioneve të Pensionit Profesional” (IORP II), si dhe me standardet më të mira ndërkombëtare. Nevoja për hartimin e një ligji të ri për pensionet vullnetare në përputhje me Direktivat evropiane është gjithashtu rekomandim i KE. Ky projektligj përmirëson bazën ligjore që rregullon tregun e fondeve të pensionit privat me kontribute të përcaktuara dhe krijon kushte të favorshme për zhvillimin e këtij tregu dhe nxitjen e kursimeve për pension.

Projektligji “Për fondet e pensionit privat” rregullon:

1. Licencimin dhe veprimtarinë e shoqërive administruese të fondeve të pensionit privat në Republikën e Shqipërisë;
2. Krijimin dhe veprimtarinë e fondeve të pensionit privat me pjesëmarrje të hapur dhe fondeve të pensionit privat me pjesëmarrje të mbyllur, me kontribute të përcaktuara në Republikën e Shqipërisë;
3. Licencimin dhe veprimtarinë e depozitarit të aseteve të fondit të pensionit privat;
4. Mbikëqyrjen e shoqërisë administruese, fondeve të pensionit privat, depozitarit të aseteve të fondit të pensionit privat dhe të subjekteve të tjerë, sipas këtij ligji;
5. Veprimtarinë ndërkufitare të shoqërive administruese që ofrojnë fonde të pensionit privat me pjesëmarrje të mbyllur.

Objektivat kryesore që synohen të arrihen nëpërmjet miratimit të këtij projektligji janë:

1. Mbrojtja e interesave të anëtarëve të fondit të pensionit privat, nëpërmjet vendosjes së standardeve më të larta për mirëinformim dhe transparencë, që nxisin besueshmërinë e investitorit në tregun e fondeve të pensionit privat;
2. Nxitja e pjesëmarrjes në skemë nëpërmjet përfshirjes automatike, të të gjithë punëmarrësve nga ana e punëdhënësit, si dhe rishikimit të politikës tatimore, me synim krijimin e lehtësirave fiskale për anëtarët ekzistues apo të mundshëm, si dhe përfituesit e fondit;
3. Forcimi i kuadrit mbikëqyrës dhe rregullator përmes kërkesave për licencimin, mbikëqyrjen e shoqërive administruese të fondeve të pensionit, përfshirë rregullimin e aktivitetit ndërkufitar, si dhe kërkesat lidhur me zbatueshmërinë e detyrimeve ligjore;
4. Rritja e profesionalizimit në administrimin e fondeve të pensionit privat nga ana e shoqërive administruese, përmes rritjes së kërkesave për qeverisjen e shoqërisë administruese dhe përshtatshmërinë e personelit kyç, krijimi i sistemit të administrimit të rrezikut, përfshirë analizën e vetëvlerësimit dhe sistemit të kontrollit të brendshëm.

3.2 Rregullimi i Tregut të Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive dhe Kapitalit

Tregu i Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive

Në zbatim të Ligjit nr. 56/2020, “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, si dhe në kuadër të shtimit të aktivitetit ndërkufitar të shoqërive administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, Autoriteti hartoi dhe ka nxjerrë për konsultim publik projektregulloret e mëposhtme:

1. “Për regjistrimin e agjentit të shitjes së sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike të licencuara në një vend anëtar të BE-së”;
2. “Për njohjen e SIK me ofertë publike të licencuar në një vend anëtar të BE-së dhe Shoqërisë Administruese apo degës së Shoqërisë Administruese të SIK të licencuar në një vend anëtar të BE-së për shitjen dhe marketimin e SIK me ofertë publike në Republikën e Shqipërisë”.



Autoriteti ka përmbyllur procesin e përshtatshmërisë për të gjithë subjektet në zbatim të Ligjit nr. 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”.

Tregu i kapitalit dhe tregu financiar i bazuar në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë


Gjatë vitit 2022, Autoriteti ka vijuar angazhimin e tij në plotësimin e kuadrit nënligjor në zbatim të Ligjit nr. 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit” dhe Ligjit nr. 66/2020 “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë”.

Në vijim të punës për plotësimin e kuadrit nënligjor që rregullon tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë, Autoriteti gjatë vitit 2022 ka hartuar dhe miratuar rregulloret si më poshtë:

1. Rregullore nr. 164, datë 29.09.2022 “Për licencimin e subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë si kujdestar të portofolit të palëve të treta”, objekti i së cilës është përcaktimi i rregullave dhe procedurave të detajuara të licencimit, llojit të dokumenteve provuese, mënyrën e shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumenteve, rregullave të brendshme të funksionimit, si dhe detyrimet për raportim të subjekteve, që ushtrojnë, ose kërkojnë të ushtrojnë veprimtarinë si kujdestar për portofolin e palëve të treta.
2. Rregullore nr. 165, datë 29.09.2022 “Për licencimin e subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë si Bursë DLT”, objekti i së cilës është përcaktimi i rregullave dhe procedurave të detajuara të licencimit, llojit të dokumenteve provuese, mënyrën e shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumenteve, rregullave të brendshme të funksionimit, si dhe rregullave të detajuara për listimin dhe tregtimin e tokeneve digjital/monedhave virtuale për subjektet, që ushtrojnë, ose kërkojnë të ushtrojnë veprimtarinë si bursë DLT.
3. Rregullore nr. 223, datë 30.11.2022 “Për procedurat e likuidimit vullnetar dhe likuidimit të detyrueshëm të bursës DLT, kujdestarit të portofolit të palëve të treta dhe sipërmarrjes së automatizuar të investimeve kolektive TD”, objekti i së cilës është përcaktimi i rregullave të hollësishme në lidhje me likuidimin vullnetar dhe likuidimin e detyrueshëm të Bursës DLT, kujdestarit të portofolit të palëve të treta dhe sipërmarrjeve të automatizuara të investimeve kolektive TD.

Zhvillime të rëndësishme ligjore ka patur gjithashtu në tregun e kapitaleve, ku në kuadër të angazhimit të Autoritetit për plotësimin e kuadrit nënligjor, në zbatim të Ligjit nr. 62/2020 “Për tregjet e kapitalit”, si dhe në përmbyllje të projektit SECO II, “Përmirësimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare - Fokus zhvillimi i tregut të kapitaleve”, përfundoi hartimi i 13 projektregulloreve të mëposhtme:

1. “Për formën dhe përmbajtjen e prospektit që publikohet kur titujt i ofrohen publikut dhe pranohen për tregtim në një treg të rregulluar”;
2. “Për kërkesat e transparencës në lidhje me informacionin e shoqërive të listuara”;
3. “Për kërkesat e licencimit dhe të funksionimit të një Platforme Shumëpalëshe Tregtimi (PSHT), një Platforme të Organizuar të Tregtimit (POT) dhe kërkesat për shoqëritë komisionere që veprojnë si internalizues sistematik”;
4. “Për ushtrimin e veprimtarisë operacionale të shoqërive komisionere dhe bankave që ofrojnë shërbime investimi”;
5. “Për kërkesat e licencimit dhe të funksionimit të depozitarit qendror të titujve”;
6. “Për mjaftueshmërinë e kapitalit të shoqërisë komisionere”;
7. “Për kërkesat e licencimit dhe të funksionimit të Shtëpisë së Klerimit dhe Kundërpalës Qendrore”;
8. “Kushtet për njohjen e një agjencie të huaj të vlerësimit të kreditit dhe kërkesat për raportim”;
9. “Për ndalimin e abuzimit me tregun dhe “shitja e shkurtër”;
10. “Për kërkesat e licencimit dhe të funksionimit të operatorëve të tregut dhe bursës”;
11. “Procedura dhe shqyrtimi i ankesave të konsumatorëve me pakicë në lidhje me aktivitetet e rregulluara të kryera nga persona të licencuar, të regjistruar ose të njohur dhe ankesat ndaj Autoritetit”;
12. “Për emërimin dhe kërkesat për auditorët ligjor të shoqërive komisionere”;
13. “Për formën dhe procedurën e regjistrimit të akt-ofertës për emetimin e titujve të ndryshëm nga titujt e borxhit”.



Autoriteti ka zhvilluar disa tryeza diskutimi, lidhur me këto projektregullore, ku katër projektregulloret e mëposhtme, pasi kaluan fazën e konsultimit publik, në fillim të vitit 2023 u miratuan nga Bordi i AMF-së:

1. “Për ushtrimin e veprimtarisë operacionale të shoqërive komisionere dhe bankave që ofrojnë shërbime investimi”;
2. “Për mjaftueshmërinë e kapitalit të shoqërisë komisionere”;
3. “Për kërkesat e transparencës në lidhje me informacionin e shoqërive të listuara”;
4. “Për formën dhe përmbajtjen e prospektit që publikohet kur titujt i ofrohen publikut dhe pranohen për tregtim në një treg të rregulluar”.

Pjesa tjetër e akteve nënligjore pritet të miratohen nga AMF, brenda gjashtëmuajorit të parë të vitit 2023. Këto akte avancojnë më tej standardet për mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë së subjekteve të tregut të kapitaleve dhe mbikëqyrjen e tyre, në funksion të mbrojtjes së investitorit. Me hartimin e projektregulloreve të mësipërme plotësohet e gjithë baza rregullatore për tregun e kapitaleve, sipas Ligjit nr.62/2020, duke e përafuar atë me legjislacionin e BE-së.

3.3 Licencimi dhe Qeverisja

3.3.1 Tregu i Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive

Aktiviteti i Licencimit

Gjatë vitit 2022, kanë përshtatur aktivitetin me kërkesat e Ligjit nr. 56/2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive” dhe rregulloreve të miratuara në zbatim të tij, 3 shoqëri administruese së bashku me fondet e investimit që administrohen prej tyre, “ABI Invest” sh.a., “Raiffeisen Invest” sh.a., “WVP Fund Management Tirana” sh.a., 2 depozitarë, “Banka e Parë e Investimeve, Albania” sh.a., “Banka Credins” sh.a., si dhe 2 fonde investimi me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike “Credins Premium” dhe “Albsig Standard”.

Gjithashtu, shoqëria administruese e fondeve të pensionit “Sigal-Life Uniqa Group Austria” sh.a., është licencuar edhe si shoqëri administruese e sipërmarrjeve të investimeve kolektive, është licencuar 1 fond investimi me ofertë publike “Albsig Selective Equity ETFs” i administruar nga “Albsig Invest sh.a. - Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive”

dhe janë miratuar 2 fonde pensioni “Smart Pension”, nën administrimin e shoqërisë administruese “Albsig Invest” sh.a., dhe “Sigal Pro” nën administrimin e shoqërisë administruese “Sigal-Life Uniqa Group Austria”.

Aktualisht në tregun e fondeve ushtrojnë aktivitet 6 shoqëri administruese, nga të cilat 3 janë shoqëri administruese të fondeve të pensionit vullnetar dhe të sipërmarrjeve të investimeve kolektive (SIK) me ofertë publike, 2 janë shoqëri administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike dhe 1 është shoqëri administruese të fondeve të pensionit vullnetar, të sipërmarrjeve të investimeve kolektive (SIK) me ofertë publike dhe të fondeve të investimeve alternative, për klientët profesionistë dhe të kualifikuar.

Shoqëritë administruese të fondeve, administrojnë 12 SIK në formën ligjore të Fondit të Investimit, me pjesëmarrje të hapur, me ofertë publike, 6 Fonde pensioni vullnetar dhe 2 Fonde të investimit alternativ për klientët profesionistë dhe të kualifikuar.

Në tregun e fondeve ushtrojnë aktivitetin e depozitarit të fondeve 6 banka, nga të cilat 3 janë të licencuara, si depozitar i aseteve të fondeve të pensionit vullnetar dhe të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, 2 janë depozitarë të fondeve të pensionit vullnetar dhe 1 bankë është depozitar i aseteve të fondeve të pensionit vullnetar, të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike dhe të fondeve të investimeve alternative, për klientët profesionistë dhe të kualifikuar.

Të dhënat mbi shoqëritë administruese, sipërmarrjet e investimeve kolektive, fondet e pensionit vullnetar dhe depozitarët, jepen në tabelën e mëposhtme:



Tabelë 12: Të dhëna mbi subjektet që ushtrojnë veprimtari në tregun e fondeve (Në numër)

<i>Subjekte</i>	<i>2018</i>	<i>2019</i>	<i>2020</i>	<i>2021</i>	<i>2022</i>
Shoqëri Administruese:	4	5	6	6	6
Shoqëri Administruese të SIK me ofertë publike	1	1	2	2	2
Shoqëri Administruese të Fondeve të Pensionit vullnetar	1	1	1	1	-
Shoqëri Administruese të Fondeve të Pensionit vullnetar dhe SIK me ofertë publike	2	3	2	2	3
Shoqëri Administruese të Fondeve të Pensionit vullnetar dhe SIK me ofertë publike dhe fondeve të investimit alternativ për klient profesionist dhe të kualifikuar.	-	-	1	1	1
Sipërmarrje të Investimeve Kolektive (Fonde investimi)	5	6	9	11	12
Fonde Investimi Alternativ	-	-	-	2	2
Fonde Pensioni Vullnetar	3	4	4	4	6
Depozitarë të fondeve:	5	6	6	6	6
Depozitar i Fondeve të Pensionit vullnetar	3	2	2	2	2
Depozitar i Fondeve të Pensionit vullnetar dhe Fondeve të Investimit	2	4	3	3	3
Depozitar i Fondeve të Pensionit vullnetar dhe SIK me ofertë publike dhe Fondeve të investimit alternativ për klient profesionist dhe të kualifikuar.	-	-	1	1	1

Qeverisja

Në mbështetje të kërkesave ligjore dhe nënligjore, shoqëritë administruese janë të organizuara sipas sistemit të organizimit me një nivel qeverisjeje. Autoriteti miratoi 2 emërimë në funksione drejtuese si administrator/anëtar të këshillit administrues/mbikëqyrës të shoqërive administruese të fondeve, 17 riemërimë në këto funksione, si dhe një personel kyç të depozitarit.

Tabelë 13: Të dhëna për aksionarët e shoqërive administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe fondeve të pensionit vullnetar


<i>Subjekte</i>	<i>Numër</i>	<i>%</i>
Shoqëri administruese	6	
Aksionarë gjithsej	17	
<i>Klasifikimi i aksionarëve sipas pjesëmarrjes zotëruese:</i>		100
nën 10%	7	41.18
mbi 10% nën 20%	2	11.76
mbi 20% nën 33 %	1	5.88
mbi 33% nën 50%	1	5.88
mbi 50%	6	35.29
<i>Klasifikimi i aksionarëve sipas vendit të origjinës:</i>		100
Aksionarë të huaj	7	41.17
Aksionarë vendas	10	58.83
<i>Klasifikimi i aksionarëve sipas statusit:</i>		100
Aksionarë individë	9	52.94
Aksionarë shoqëri	8	47.06

Në vitin 2022 janë miratuar ndryshimi i statutit të shoqërisë administruese Albsig Invest, si rezultat i rritjes së kapitalit dhe miratimi i ndryshimit të statutit të shoqërisë administruese WVP Fund Management Tirana, si rezultat i ndryshimit të strukturës aksionere.

Tabelë 14: Të dhëna mbi miratimin e ndryshimeve statutore

(Në numër)

<i>Arsyeja e ndryshimit të Statutit</i>	<i>2017</i>	<i>2018</i>	<i>2019</i>	<i>2020</i>	<i>2021</i>	<i>2022</i>
Statut i ri/ndryshime të tjera	-	-	5	1	-	-
Rritje kapitali	1	2	1	1	-	1
Ndryshim i strukturës aksionare	1	-	2	-	-	1



3.3.2 Tregu i Kapitalit

Aktiviteti i Licencimit

Gjatë vitit 2022, ka vijuar procesi i përshtatshmërinë së aktivitetit të subjekteve të tregjeve të kapitalit, me Ligjin nr. 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit”.

Autoriteti miratoi përshtatshmërinë e aktivitetit me kërkesat e Ligjit nr. 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit” dhe të rregulloreve në zbatim të tij për 2 banka “Banka Intesa Sanpaolo Albania” sh.a., dhe “Banka Alpha Albania” sh.a., si edhe përshtatshmërinë dhe zgjerimin e licencës për 4 banka - shoqëri komisionere, “Banka Amerikane e Investimeve” sh.a., “Banka Credins” sh.a., “Raiffeisen Bank” sh.a. “Banka e Tiranës” sh.a.

Zgjerimi i licencës për bankat si shoqëri komisionere konsistoi në ofrimin e disa shërbimeve investimi dhe ndihmëse shtesë, si: administrimi i portofolit; këshillimi dhe dhënia e rekomandimeve për investime; nënshkrimi i instrumenteve financiare dhe/ose hedhja në treg e instrumenteve financiare në bazë të angazhimit në transaksion, hedhja në treg e instrumenteve financiare pa angazhim shitjeje; si edhe ruajtja dhe administrimi i instrumenteve financiare në emër të klientëve për të gjitha instrumentet financiare, etj.

Këto shoqëri komisionere (banka) kanë zgjeruar gamën e instrumenteve financiare si në titujt e transferueshëm, instrumentet e tregut të parasë, kuotat e sipërmarrjeve të investimeve kolektive, kontratat e opsioneve (*options*), kontratat e së ardhmes (*futures*), marrëveshjet e shkëmbimit (*swap*).

Gjithashtu, u miratua përshtatshmëria e shoqërisë “Bursa Shqiptare e Titujve ALSE” sh.a., për ushtrimin e veprimtarisë së Bursës, “Regjistri Shqiptar i Titujve ALREG” sh.a., për të vepruar si Regjistrar dhe Depozitar Qendror i Titujve dhe e shoqërisë komisionere “Brokas Securities” sh.a.

Gjatë vitit 2022 është hequr njohja dhe janë çregjistruar 2 shoqëri si agjentë të lidhur të brokerit të huaj, është pezulluar 1 shoqëri brokerimi në tituj dhe 1 shoqëri brokerimi në letra me vlerë të Qeverisë të RSH (bono thesari) në tregun me pakicë, si dhe është çregjistruar Banka Alpha Albania sh.a. për ofrimin e shërbimeve të investimit në tituj të Qeverisë R.Sh., pas përthithjes së saj nga Banka OTP Albania sh.a.

Në tregun e kapitaleve ushtrojnë veprimtari: 1 bursë titujsh, 2 regjistrarë, 13 shoqëri komisionere që ofrojnë shërbime investimi në tituj, nga të cilat 10 janë banka, të cilat ofrojnë dhe shërbime ndihmëse të ruajtjes dhe administrimit të instrumenteve financiare në emër të klientëve dhe 1 bankë, e cila ofron shërbime investimi *online*.

Tabelë 15: Të dhëna historike mbi subjektet që veprojnë në tregun e kapitalit (Në numër)

<i>Subjekte</i>	<i>2018</i>	<i>2019</i>	<i>2020</i>	<i>2021</i>	<i>2022</i>
Bursë titujsh	1	1	1	1	1
Shoqëri komisionere/Banka	17	14	12	13	13
<i>Nga këto:</i>					
<i>Banka që ofrojnë shërbim ndihmës për ruajtjen dhe administrimin e instrumenteve financiare</i>	9	9	9	9	10
<i>Banka që ofrojnë shërbim investimi online</i>					1
Regjistrar titujsh	1	2	2	2	2
Agjentë të lidhur të shoqërive komisionere të huaja	3	5	4	2	-

3.3.3 Tregu i sigurimeve

Aktiviteti i licencimit

Aktiviteti licencues i Autoritetit në tregun e sigurimeve u fokusua kryesisht në licencimin/miratimin e ndërmjetësve në sigurime (agjentë); rinovim licence aktuar, si edhe licencim e rinovim licence të vlerësuesve të dëmeve.

Shoqëri sigurimi

Aktualisht në tregun e sigurimeve ushtrojnë aktivitet 12 shoqëri sigurimi, nga të cilat 8 në sigurimin e Jo-Jetës dhe 4 shoqëri në sigurimin e Jetës. Ky numër nuk ka ndryshuar që prej vitit 2019.

Ndërmjetës në sigurime

Veprimtaria e ndërmjetësimit në sigurime mund të ushtrohet, si broker në sigurime, ose si agjent në sigurime. Brokerimi në sigurime mund të kryhet nga individët e licencuar si broker në sigurime, si broker fizik i pavarur nga shoqëritë e brokerimit dhe bankat e licencuara për të ushtruar këtë veprimtari nëpërmjet brokerit të licencuar.



Në tregun e sigurimeve aktualisht janë të licencuara për të ushtruar veprimtarinë e brokerimit në sigurime, 13 shoqëri brokerimi, 5 banka, si dhe 4 brokera fizikë.

Nga 18 shoqëritë e brokerimit, 6 shoqëri brokerimi dhe 1 bankë, ushtrojnë veprimtari vetëm në fushën e sigurimit të Jo-Jetës, 4 shoqëri brokerimi ushtrojnë veprimtari brokerimi në sigurime të Jetës, të Jo-Jetës dhe risigurime, 3 shoqëri brokerimi dhe 4 banka, ushtrojnë veprimtarinë e tyre në të dy klasat e sigurimit, të Jetës dhe Jo-Jetës.

Tabelë 16: Shoqëri brokerimi sipas klasave të sigurimit

(Në numër)

Viti	2018	2019	2020	2021	2022
Shoqëri brokerimi Jo-Jetë	9	9	8	8	7
Shoqëri brokerimi Jo-Jetë dhe Jetë	6	6	7	7	7
Shoqëri brokerimi Jo-Jetë, Jetë, Risigurime	4	4	4	4	4
Totali	19	19	19	19	18

Autoriteti miratoi 73 persona fizikë (agjentë) për ushtrimin e veprimtarisë si agjentë në sigurime, si dhe licencoi 7 subjekte juridike për të vepruar si agjentë në sigurime. Në tregun e sigurimeve janë të miratuar 882 individë për të ushtruar veprimtarinë e agjentit në sigurime, si dhe janë të licencuar 57 subjekte juridike, nga të cilat 4 janë banka.

Të dhënat për licencimin/miratimin për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit në sigurime jepen në tabelën më poshtë:

Tabelë 17: Të dhëna mbi agjentë të licencuar në sigurime

(Në numër)

Agjent në sigurime	Të licencuar në fund të vitit 2021	Licenca të reja në 2022	Tërheqje licence, ndërprerje kontrate në 2022	Të licencuar në fund të vitit 2022
Persona juridikë	53	6	2	57
<i>Nga këto, banka</i>	4			4
Person fizikë	863	73	54	882

Vlerësuesit e dëmeve në sigurime

Në tregun e sigurimeve janë të licencuar 57 individë si vlerësues dëmsh në sigurime, nga të cilët 29 individë e ushtrojnë këtë veprimtari si të punësuar pranë një shoqërie sigurimi dhe 28 individë si vlerësues të pavarur.

Në vitin 2022 janë licencuar 17 individë si vlerësues dëmsh, janë rinovuar 7 licenca si vlerësues dëmsh dhe janë rinovuar 8 licenca si aktuar.

Të dhëna mbi numrin e vlerësuesve të dëmeve në sigurime, sipas statusit të vlerësuesit (i punësuar/i pavarur) dhe llojit të licencës (për dëme materiale dhe/ose shëndetësore), jepen në tabelën e mëposhtme:

Tabelë 18: Të dhëna mbi numrin e vlerësuesve të dëmeve të licencuar në sigurime (Në numër)

Vlerësues sipas statusit/ llojit të licencës	Të licencuar në fund të vitit 2021	Rinovuar licenca në 2022	Licenca të reja në 2022	Përfunduar afati i licencës në 2022	Hequr licenca në 2022	Të licencuar në fund të vitit 2022
Sipas statusit të personit						
Të pavarur	32	5	3	12	-	28
Të punësuar	18	2	14	5	-	29
Sipas llojit të Licencës						
Dëme materiale	4	1	4	-	-	9
Dëme shëndetësore	17	1	4	6	-	16
Dëme materiale dhe shëndetësore	29	5	9	11	-	32
TOTALI	50	7	17	17	-	57

Qeverisja

Shoqëritë e sigurimit që operojnë në tregun shqiptar janë të organizuara sipas sistemit me një dhe me dy nivele qeverisjeje. Në shoqëritë e sigurimit me një nivel qeverisjeje, këshilli i administrimit ushtron funksionet e administrimit dhe të mbikëqyrjes, ndërsa tek shoqëritë me dy nivele qeverisjeje, këshilli mbikëqyrës ushtron funksione mbikëqyrjeje dhe administratori, apo bordi i drejtorëve ushtron funksione administrimi. Nga 12 shoqëri sigurimi në fund të vitit 2022, 11 prej tyre janë të organizuara sipas sistemit me dy nivele drejtimi dhe vetëm 1 shoqëri me një nivel.



Autoriteti miratoi 5 emëtime në funksione drejtuese si anëtar të këshillit administrues/mbikëqyrës ose administrator të shoqërive të sigurimit, si dhe 9 riemëtime në këto funksione.

Për sa i përket shoqërive të brokerimit, Autoriteti miratoi 4 emëtime në funksione drejtuese si anëtar të këshillit administrues/mbikëqyrës, ose administrator të shoqërive të brokerimit, si dhe 7 riemëtime në këto funksione.

Shoqëritë e sigurimit janë me kapital vendas dhe të huaj, konkretisht nga 12 shoqëri sigurimi, 9 janë me kapital vendas dhe 3 me kapital kryesisht të huaj. Gjithashtu, nga 12 shoqëri sigurimi, 11 prej tyre kanë aksionar influencues që zotëron mbi 50% të aksioneve.

Tabelë 19: Të dhëna për aksionarët e shoqërive të sigurimit

<i>Subjekte</i>	<i>Numër</i>	<i>%</i>
Shoqëri sigurimi	12	
Aksionarë gjithsej	37	
<i>Klasifikimi i aksionarëve sipas pjesëmarrjes zotëruese</i>		100
nën 10%	18	50
mbi 10% nën 20%	4	13.16
mbi 20% nën 33 %	3	5.26
mbi 33% nën 50%	1	2.63
mbi 50%	11	28.95
<i>Klasifikimi i aksionarëve sipas vendit të origjinës:</i>		100
Aksionarë të huaj	2	5.26
Aksionarë vendas	35	94.74
<i>Klasifikimi i aksionarëve sipas statusit</i>		100
Aksionarë individë	28	76.32
Aksionarë shoqëri	9	23.68

Për vitin 2022 nga Autoriteti nuk ka patur miratime në lidhje me ndryshimet statutore të shoqërive të sigurimit.

3.5 Masat mbikëqyrëse dhe administrative

Kuadri rregullator, i cili rregullon veprimtarinë e subjekteve financiare nën mbikëqyrjen e Autoritetit dhe Ligji nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, parashikojnë masa korigjuese dhe administrative me qëllim parandalimin, korigjimin apo ndërprerjen e rrethanave dhe veprimeve, që përbëjnë shkelje të dispozitave ligjore ose akteve të Autoritetit.

Në përputhje me kompetencat e tij, gjatë vitit 2022, Bordi i Autoritetit ka marrë 35 vendime si masa administrative e korigjuese ndaj subjekteve të mbikëqyrura, kryesisht si rezultat i konstatimeve të dala nga analizimi i treguesve financiarë, nga inspektimet e kryera në vend nga Autoriteti, por edhe pezullime apo revokime licencash për ushtrimin e aktivitetit.


Në tregun e sigurimeve janë marrë 19 vendime, ku sipas llojit të masave paraqiten:

- 16 vendime për masa korigjuese dhe sanksione me gjobë ndaj shoqërive të sigurimit/person përgjegjës, duke përfshirë dhe pezullimin e një licence për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit në sigurime;
- 2 vendime me masa korigjuese dhe sanksion me gjobë ndaj shoqërive të brokerimit në sigurime;
- 1 vendim me masa korigjuese dhe sanksion me gjobë ndaj shoqërisë së agjentëve në sigurime.

Ndaj Byrosë Shqiptare të Sigurimeve janë marrë 3 masa mbikëqyrëse dhe administrative.

Në tregun e titujve janë marrë 8 vendime, ku sipas llojit të masave paraqiten:

- Ndaj 4 agjentëve të lidhur të shoqërisë së brokerimit të huaj është hequr njohja dhe regjistrimi;
- Ndaj 3 agjentëve të lidhur të shoqërisë së brokerimit të huaj është pezulluar regjistrimi;
- Një shoqëri është çregjistruar për të ushtruar veprimtarinë në tregun e titujve.



Në tregun e fondeve të pensionit vullnetar dhe SIK janë marrë 5 vendime me masa mbikëqyrëse ndaj shoqërive administruese të fondeve të pensionit vullnetar dhe SIK.

Vendimet e ankimuara si dhe vendimet e pranuar nga gjykata

Gjatë vitit 2022, në gjykatë janë depozituar 3 ankime ndaj vendimeve të Bordit të Autoritetit. Në njërën prej vendimeve, gjykata ka vendosur rrëzimin e kërkesë padisë, duke lënë në fuqi vendimin e Autoritetit. Lidhur me dy vendimet e tjera të ankimuara, shoqëritë kanë kërkuar pushimin e gjykimit dhe gjykata ka vendosur pushimin e gjykimit të këtyre çështjeve.

Kapitulli 4

Bashkëpunimi Ndërinstitucional

4.1 Parandalimi i Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit

Masat e marra nga AMF në adresim të rekomandimeve të lëna nga komiteti MONEYVAL i Këshillit të Evropës, si dhe zbatimi i Planit të veprimit të ICRG/FATF

Autoriteti ka vijuar adresimin e rekomandimeve të lëna nga Komiteti MONEYVAL i Këshillit të Evropës, në lidhje me masat e marra kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Autoriteti është pjesë e grupit ndërinstitucional, ngritur me Vendimin nr.1, datë 19.2.2020 të Komitetit të Bashkërendimit të Luftës kundër Pastrimit të Parave, për ndjekjen dhe përmbushjen e rekomandimeve të lëna nga Grupi i Posaçëm i Veprimit Financiar FATF) dhe Grupi i Shqyrtimit të Bashkëpunimit Ndërkombëtar (ICRG).


AMF ka dhënë kontribut dhe ka zbatuar Planin e Veprimit të ICRG/FATF (Shkurt 2020-Shkurt 2022). Në zbatim të këtij plani, janë kryer inspektime me objekt respektimin e kuadrit ligjor në lidhje me parandalimin e pastrimit të parave dhe luftën kundër financimit të terrorizmit, si dhe verifikimin e të dhënave të depozituara nga formularët e vetëvlerësimit (*off-site*).

Inspektimet e kryera gjatë vitit 2022 në kuadër të PPP/FT

Gjatë vitit 2022 janë kryer në total 12 inspektime, nga të cilat pesë inspektime janë realizuar në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP) dhe një në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë, më konkretisht:

- Pranë shoqërive të sigurimit të Jetës dhe risigurimit janë kryer 5 inspektime;
- Pranë shoqërive administruese janë kryer 6 inspektime, nga të cilat 4 pranë Shoqërive Administruese për Fondin e Pensioneve dhe Fondin e Investimeve dhe 2 pranë Shoqërisë Administruese për Fondin e Investimeve; dhe
- Një inspektim pranë një shoqërie që ushtron veprimtarinë e shërbimeve të investimit.

Në subjektet e inspektuara u konstatua një rritje e shkallës së ndërgjegjësimit dhe kuptimit të çështjeve dhe kërkesave ligjore, në funksion të PPP/FT. Në përfundim të inspektimeve u lanë rekomandime për dy nga subjektet.



Gjatë vitit 2022, është bërë kategorizimi i rrezikut për subjektet e ligjit për PPP/FT, nën mbikëqyrjen e Autoritetit, bazuar në formularët e vetëvlerësimit. Për subjektet banka që ushtrojnë veprimtarinë e kujdestarisë është shkëmbyer informacion me Bankën e Shqipërisë. Rezultati i analizës për kategorizimin e rrezikut, dalë nga matrica e vlerësimit të kriterit për 11 subjektet, ka rezultuar “Nivel i ulët i rrezikut”. Një informacion përmbledhës për rezultatet e rrezikut i është dërguar Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP), si autoritet përgjegjës.

Trajnime për PPP/FT

Lidhur me forcimin e kapaciteteve të AMF-së, për PPP/FT, gjatë vitit 2022 stafi i Autoritetit ka marrë pjesë në trajnime të organizuara nga Qendra Ndërkombëtare e Studimeve Parlamentare (ICPS) dhe nga Këshilli i Evropës, ku janë trajtuar tema lidhur me vlerësimin kombëtar të rrezikut, si dhe tendencat e sfidat e reja në parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

4.2 Bashkëpunimi Rajonal dhe Ndërkombëtar

Autoriteti, edhe gjatë vitit 2022, ka vijuar bashkëpunimin me organizatat, shoqatat, institucionet financiare, partnerë dhe donatorë, si edhe me autoritetet homologe rajonale dhe evropiane. AMF ka zgjeruar bashkëpunimin me autoritetet homologe evropiane nëpërmjet nënshkrimit të memorandumeve të mirëkuptimit, shkëmbimit të informacionit dhe eksperiencave në aspektin rregullator e mbikëqyrës, me synim rritjen e efektivitetit të mbikëqyrjes, rregullimit të tregjeve, si edhe garantimit të një mbikëqyrjeje të konsoliduar të tregjeve financiare jobankare.

4.2.1 Memorandume Mirëkuptimi gjatë vitit 2022

Memorandumi Shumëpalësh i Mirëkuptimit (MMoU) me Shoqatën Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS)

Në qershor të 2022, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare nënshkroi Memorandumin Shumëpalësh të Mirëkuptimit (MMoU) me Shoqatën Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS). Memorandumi Shumëpalësh u nënshkrua nga z. Ervin Mete, Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF dhe nga zj. Vicky Saporta, Kryetare e Komitetit Ekzekutiv të IAIS. Ceremonia e nënshkrimit të marrëveshjes u organizua gjatë Takimeve të Komiteteve dhe Seminarit Global të IAIS-it, ku morën pjesë drejtues të lartë të AMF dhe IAIS. U vlerësua puna e Autoritetit për

anëtarësimin e tij në MMoU, e cila do t'i shërbejë AMF-së, për një bashkëpunim më të ngushtë me autoritetet e tjera rregullatore të sigurimeve.

Memorandumi përfaqëson një kuadër global përputhshmërie dhe konfidencialiteti, për një mbikëqyrje më efektive të grupeve ndërkufitare të sigurimeve, nëpërmjet shkëmbimit të informacionit. Aderimi i AMF-së në këtë Memorandum, ka për qëllim rritjen e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit mes mbikëqyrësve në tregun e sigurimeve me qëllim garantimin e stabilitetit në tregjet financiare.

AMF është i pari rregullator në rajonin e Ballkanit Perëndimor, që bëhet pjesë e një grupi prej 77 vendesh nënshkruese të MMoU-së, pasi realizoi një proces intensiv dy vjeçar verifikimi të përputhshmërisë së bazës ligjore dhe rregullatore, me standardet ndërkombëtare të IAIS-it.


Memorandume Mirëkuptimi me Rregullatorë Evropianë

Zgjerimi i bashkëpunimit me rregullatorët evropianë, i shërbejnë shkëmbimit të informacionit dhe eksperiencave mbikëqyrëse, si dhe mbështesin Autoritetin, si institucion drejtues të negociatave për Kapitullin 9 “Shërbimet Financiare”.

Memorandumi i Mirëkuptimit (MoU) me Autoritetin të Shërbimeve Financiare të Maltës (MFSA)

Në dhjetor 2022, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe Autoriteti i Shërbimeve Financiare të Maltës (MFSA) nënshkruan një Memorandum Mirëkuptimi në kuadër të shkëmbimit të informacionit dhe bashkëpunimit mes dy rregullatorëve, në funksion të garantimit të stabilitetit financiar, arritjes së qëllimit të përbashkët për një mbikëqyrje efektive të tregjeve financiare, krijimit të një mjedisi sa më të përshtatshëm për operatorët e tregjeve, si edhe mbrojtjes së konsumatorëve e investitorëve.

Marrëveshja përcakton një kuadër të qartë bashkëpunimi në të gjitha fushat ku ata ushtrojnë funksionet e tyre mbikëqyrëse, tregun e kapitaleve, tregun e sigurimeve, fondet e investimeve, fondet e pensioneve private, si edhe atë të tregjeve financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë. Malta, si një nga vendet e para të BE-së, që ndërmoi rregullimin e shërbimeve financiare të ofruara përmes teknologjisë së regjistrave të shpërndarë, ka një ekspertizë të thelluar në këtë fushë, e cila do t'i shërbejë edhe vendit tonë.



Nëpërmjet kësaj MoU, Autoriteti i Shërbimeve Financiare të Maltës (MFSA) do të mbështesë AMF, me asistencë të nevojshme në funksion të përafrimit me legjislacionin e BE-së dhe harmonizimit të akteve rregullatore me kuadrin ligjor Evropian.

Memorandum Mirëkuptimi me Komisionin Mbikëqyrës të Sektorit Financiar të Luksemburgut (CSSF)

Gjatë vitit 2022, AMF, në kuadër të forcimit të marrëdhënieve ndërinstitucionale bilaterale, ka bashkëpunuar me Komisionin Mbikëqyrës të Sektorit Financiar të Luksemburgut (CSSF), për të finalizuar Memorandumin e Mirëkuptimit midis palëve.

Memorandumi i Mirëkuptimit synon vendosjen e urave të bashkëpunimit mes dy autoriteteve rregullatore, në funksion të mbrojtjes së interesave të konsumatorëve dhe investitorëve, promovimit të integriteti, stabilitetit dhe eficiencës së tregjeve nën mbikëqyrje.

Marrëveshja përcakton një kuadër të qartë bashkëpunimi mes dy rregullatorëve financiarë, sipas fushave ku ata ushtrojnë funksionet mbikëqyrëse, tregun e kapitaleve, tregun e fondeve të investimeve dhe fondet private të pensioneve.

Kuadri i përgjithshëm i këtij Memorandumi Mirëkuptimi është hartuar në përputhje me objektivat dhe parimet për rregullimin e tregjeve nën mbikëqyrje, të përcaktuara nga Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë (IOSCO) dhe nga Autoriteti Evropian i Tregut të Letrave me Vlerë (ESMA), për përafrimin me direktivat e BE-së.

4.2.2 Bashkëpunime me Autoritete Homologe

Një partner i rëndësishëm i AMF-së në zhvillimin e tregjeve financiare nën mbikëqyrje është **Autoriteti i Tregjeve Financiare të Austrisë (FMA)**. Bashkëpunimi me FMA është konsoliduar ndër vite (prej vitit 2009) dhe materializuar me takime të shpeshta të drejtuesve të lartë të institucioneve dhe stafit teknik. AMF bashkëpunon dhe shkëmben informacione me FMA, me qëllim mbikëqyrjen efektive të grupeve austriake të sigurimit, që ushtrojnë aktivitetin e tyre në tregun shqiptar, si pjesë e grupeve ndërkombëtare të sigurimeve. Në këtë kuadër gjatë vitit 2022, Autoriteti ka marrë pjesë në takimet e përvitshme të Kolegjeve Mbikëqyrëse të grupeve të


sigurimit, organizuar nga FMA. Këto kolegje zhvillohen në funksion të mbikëqyrjes efektive të shoqërive të sigurimit dhe risigurimit, nëpërmjet shkëmbimit të informacionit në lidhje me ecurinë e aktivitetit të tyre.

Gjithashtu, me ftesë të FMA-së, Autoriteti mori pjesë në Konferencën për mbikëqyrjen e administrimit të aseteve të SIK në Evropën Qendrore, Lindore dhe Juglindore: “Oëndrueshmëria e Rajoneve dhe Veprimtaritë Ndërkufitare”.

AMF është pjesëmarrëse aktive në nismën rajonale **“Iniciativa Rajonale për mbikëqyrjen e tregut të sigurimeve në rajonin e Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore (CESEE-ISI)”**. Si pjesë e kësaj iniciative, drejtues të lartë të Autoritetit morën pjesë në takimin e 20 të, i cili u organizua nga FMA, me mbështetjen edhe të Bankës Qendrore të Hungarisë. Përfaqësuesit e Autoritetit prezantuan dhe ishin pjesë e paneleve të diskutimit në konferencë. Pjesëmarrësit e pranishëm në konferencë shkëmbyen përvojat e tyre, paraqitën sfidat dhe problematikat e vendeve të rajonit në sektorin e sigurimeve, si dhe theksuan rolin e autoritetit rregullator në mbrojtje të interesave të policëmbajtësve dhe stabilitetit financiar të tregut.

AMF, edhe gjatë vitit 2022, ka vijuar bashkëpunimin me **Agjencinë e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Sllovenisë (AZN)**. Në shtator 2022, AMF mori pjesë në Konferencën e 7të Ndërkombëtare, në të cilën u diskutua mbi dinamikat dhe zhvillimet e fundit në tregun e sigurimeve, aspektet e ndryshimeve klimatike dhe alternativat e zgjidhjeve të qëndrueshme dhe sfidat me të cilat po përballlet sektori i sigurimeve.

Gjatë vitit 2022, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, me rekomandim të Bankës Botërore, asistoi **Komisionin e Letrave me Vlerë të Ukrainës (NSSMC)**, në procesin e përafritimit ligjor me *acquis* të BE-së. Autoriteti ka patur komunikime të vazhdueshme me Komisionin e Letrave me Vlerë të Ukrainës, me qëllim dhënien e eksperiencës dhe mbështetjen e palës ukrainase në procesin e integritetit evropian. Këto zhvillime vijnë pas hapjes zyrtare të negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë me BE dhe pasi Ukrainës iu dha të statusi i vendit kandidat nga Komisioni Evropian. Shqipëria vlerësohet të ketë një kuadër ligjor dhe rregullator të avancuar dhe të përafuar me direktivat Evropiane, veçanërisht për tregun e sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe tregjet e kapitalit.



4.2.3 Bashkëpunimi me Organizata Ndërkombëtare e Rregullatore

Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN)

Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar kanë mbështetur në vijimësi Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, si partnerë kryesorë dhe të rëndësishëm. Ky bashkëpunim i shërben forcimit institucional, përmes mbështetjes për organizimin e trajnimeve nga ekspertët ndërkombëtarë, me qëllim rritjen e kapaciteteve të stafit të AMF-së, por edhe operatorëve të tregut financiar jobankar.

Në kuadër të Takimeve të Pranverës të Fondit Monetar Ndërkombëtar në Washington, në sesionin “Paraja Digjitale - Zhvillimi i kapaciteteve për ndërtimin e një cikli virtuoz”, ekspertët e FMN-së u ndalën tek rasti i Shqipërisë, si një nga vendet që ka miratuar një kuadër ligjor për asetet virtuale dhe ka qenë përfitues i asistencës teknike të FMN-së në këtë fushë. Ata vlerësuan qasjen rregullatore dhe përgatitjen e stafit të AMF-së përgjatë kohëzgjatjes së projektit të asistencës. Misioni i ekspertëve të FMN-së vërejti se aktivitetet e lidhura me krypto-asetet në Shqipëri janë relativisht të ulëta në dukje, ndërkohë që miratimi i një kuadri ligjor mund të ndihmojë në legjitimimin e këtyre veprimtarive.

Në nëntor 2022, Autoriteti mori pjesë në konferencën rajonale të organizuar nga Banka Botërore “Konferenca për Reformën e Raportimit Financiar (CFRR)”, zhvilluar në Tiranë. Fokusi i këtij aktiviteti ishte forcimi i qeverisjes së korporatave, raportimi i qëndrueshmërisë dhe rritja e rolit të Komiteteve të Auditimit.

Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS)

AMF është anëtare e Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS), që prej vitit 2001. Objektivat e saj janë mbikëqyrja efektive e industrisë së sigurimeve për zhvillimin dhe ruajtjen e tregjeve, mbrojtjen e të siguruarve, si dhe duke kontribuar në stabilitetin financiar global.

Gjatë vitit 2022, AMF ka marrë pjesë në Mbledhjet e Komiteteve Teknike dhe Seminarin Global të IAIS. Temat e trajtuara në këto takime kishin në fokus sigurimin gjithëpërfshirës, zhvillimin e qëndrueshëm, adresimin e rreziqeve kibernetike në sigurime, tendencat e tregut të sigurimeve, etj.

Në shtator të vitit 2022, AMF mori pjesë në aktivitetin e organizuar nga **“Access to Insurance Initiative” (A2ii)**, partner i rëndësishëm i IAIS, me temë **“Inclusive Insurance Innovation Lab - International Dialogue 2022”**. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte shkëmbimi i eksperiencave midis vendeve pjesëmarrëse, në kuadër të iniciativave për mbështetjen e zhvillimit të sigurimeve gjithëpërfshirëse.

Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Titujve (IOSCO)

AMF është anëtare me të drejta të plota e Organizatës Ndërkombëtare të Komisioneve të Titujve (IOSCO) dhe njëkohësisht nënshkruese e Memorandumit Shumëpalësh të Mirëkuptimit të IOSCO-s që prej vitit 2009, i cili vendos standardet për bashkëpunim ndërkombëtar mes shteteve nënshkruese. AMF merr pjesë në mbledhjet vjetore të Komiteteve të IOSCO-s.

Drejtues të lartë të Autoritetit ishin të pranishëm në Takimin e 47^{të} vjetor, i cili përbëhet nga Mbledhjet e Komitetit Rajonal Evropian (ERC), Komiteti i Tregjeve në Rritje e Zhvillim (GEMC), Komiteti i Presidentëve, Grupi i Monitorimit të Marrëveshjeve Shumëpalëshe të Mirëkuptimit (MmoU MG) dhe konferenca globale për tregjet e kapitalit.

Gjatë mbledhjeve të komiteteve dhe seminareve u diskutuan çështje të ndryshme si: Financat e qëndrueshme, *Greenwashing*, Kripto-asetet dhe përdorimi i instrumenteve inovative, Raporti për Rishikimin e Menaxhimit të Riskut të Likuiditetit, rreziqet aktuale ndaj të cilave ekspozohen tregjet financiare dhe *IOSCO Risk Outlook*, çështje të qëndrueshmërisë dhe teknologjive të reja në shërbimet financiare (*Sustainability Task Force dhe Fintech Task Force*), etj.

Gjatë takimit, u prezantua dokumenti strategjik i ESMA-s për periudhën 2023-2028 lidhur me zhvillimet e tregut dhe përditësimet rregullatore, fokusuar në disa objektiva: nxitja e tregjeve efektive dhe stabiliteti financiar; forcimi i mbikëqyrjes së tregjeve financiare të BE-së; rritja e mbrojtjes së investitorëve joprofesionistë; mundësimi i financimit të qëndrueshëm; dhe lehtësimi i inovacionit teknologjik dhe përdorimi efektiv i të dhënave.

Gjithashtu gjatë vitit 2022 AMF ka marrë pjesë në seminare të ndryshme të organizuar nga IOSCO.



Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Pensioneve (IOPS)

AMF është anëtare me të drejta të plota, si dhe pjesë aktive e strukturave të Organizatës Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Pensioneve (IOPS), që nga viti 2006. IOPS është organizatë e pavarur ndërkombëtare e krijuar në vitin 2004, me iniciativë të OECD-së dhe Rrjetit Ndërkombëtar të Rregullatorëve dhe Mbikëqyrësve të Pensioneve (INPRS), e cila përfaqëson interesat e rregullatorëve të pensioneve private.

AMF merr pjesë rregullisht në Mbledhjen e Përgjithshme Vjetore, Mbledhjet e Komiteteve Teknike të IOPS-it, si edhe në Forumin Global për Pensionet Private, të cilat gjatë vitit 2022, u organizuan nga OECD/IOPS, në bashkëpunim me Bankën Kombëtare të Sllovakisë (NBS).

Autoriteti edhe gjatë 2022, ka marrë pjesë në të gjitha aktivitetet dhe seminarët e IOPS-it dhe Grupit të Punës së Pensioneve Private (WPPP), për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve, duke patur si prioritet përmbushjen e udhëzimeve *ad-hoc*, për periudhën 2019-2024.

Autoriteti ka kontribuar edhe në plotësimin e pyetësorëve lidhur me veprimtaritë mbikëqyrëse për të rritur efikasitetin dhe cilësinë e mbikëqyrjes në zhvillimin e praktikave më të mira ndërkombëtare, përfshirë edhe aplikimin e mbikëqyrjes me bazë rreziku (RBS).

4.3 Projekte

Projekti: “Përmirësimi i Kapaciteteve Mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare - BB/SECO- II (2019 – 2022)”

Në fund të vitit 2022 përfundoi zbatimi i Projektit “Përmirësimi i Kapaciteteve Mbikëqyrëse të AMF-së”, me fokus Tregjet e Kapitalit dhe Tregun e Sigurimeve. Ky projekt është financuar nga Oeveria e Konfederatës Zvicerane, përfaqësuar nga Sekretariati Shtetëror për Çështje Ekonomike (SECO) dhe është mbështetur nga Banka Botërore. Projekti ka mbështetur AMF-në përgjatë tre viteve të fundit, në forcimin e kapaciteteve në rregullimin dhe mbikëqyrjen e tregjeve të kapitalit dhe sigurimeve, si dhe në zhvillimin e këtyre tregjeve, përmes rritjes së ndërgjegjësimit, edukimit financiar dhe nxitjes së inovacionit financiar.

Projekti: “Përmirësimi i Kapaciteteve Mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare - BB/SECO- II: “Fokus Zhvillimi i Tregjeve të Kapitalit”

Fushat kryesore të asistencës teknike ishin:

- Fuqizimi i funksioneve rregullatore dhe mbikëqyrëse në tregjet e kapitalit


Nëpërmjet realizimit të këtij komponenti, u hartuan 13 projektregullore në zbatim të Ligjit nr. 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit”. Miratimi i tyre pritet të finalizohet brenda gjashtëmujorit të parë të vitit 2023, duke plotësuar kështu të gjithë bazën rregullatore në zbatim të ligjit për tregjet e kapitalit. Këto akte avancojnë më tej standardet e mbikëqyrjes dhe ushtrimit të veprimtarisë së subjekteve të tregjeve të kapitalit, në mbështetje të zhvillimit të këtyre tregjeve dhe mbrojtjes së investitorit. Në kuadër të këtij projekti, gjithashtu janë rishikuar edhe pesë rregullore të tjera të ligjit për tregjet e kapitalit, të hartuara dhe miratuara nga AMF, përpara fillimit të projektit.

- Fuqizimi i mbikëqyrjes me bazë rreziku për tregjet e kapitalit

Në kuadër të mbikëqyrjes me bazë rreziku, është punuar në drejtim të përmirësimit të praktikave dhe proceseve mbikëqyrëse të tregjeve të kapitalit, për të siguruar zbatimin e tyre me standarde të larta.

- Zhvillimi i kapaciteteve të AMF-së për të monitoruar dhe mbikëqyrur tregjet e kapitalit

Në kuadër të rritjes së kapaciteteve insitucionale, gjatë implementimit të projektit, janë zhvilluar një sërë trajnimesh të stafit të Autoritetit, si dhe janë organizuar nga AMF tryeza diskutimi nga ekspertët e projektit mbi kuadrin rregullator të tregjeve të kapitalit, me përfaqësues të tregjeve, institucioneve financiare, banka dhe palët e interesit. Gjithashtu, sipas programit të projektit, janë zhvilluar vizita nga stafi i AMF-së në dy autoritete rregullatore homologe, për shkëmbimin e eksperiencave dhe rritjen e kapaciteteve mbikëqyrëse në tregjet e kapitalit.



Me asistencë teknike në kuadër të projektit u hartuan edhe dokumentet e mëposhtme:

- Manuali i Zbatueshmërisë (*Enforcement Manual*) - Udhëzues për marrjen dhe zbatimin e procedurave dhe masave mbikëqyrëse në fushën e tregjeve të kapitalit;
 - Dokument për Raportimin në tregjet e kapitalit (*Prudential Reporting*) – Ky dokument synon të ndihmojë në konsolidimin e procesit të mbikëqyrjes së pjesëmarrësve në tregjet e kapitalit, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator;
 - Raport për Monitorimin e Tregut (*Market Surveillance*) - Raporti analizon dhe identifikon mekanizat e nevojshme për identifikimin dhe parandalimin e rasteve të abuzimit në tregjet e kapitalit.
 - *FINTECH Note* – Dokumenti jep rekomandime për implementimin e teknologjive të reja në fushën e shërbimeve financiare, në linjë me kuadrin ligjor e rregullator, raportimin, transparencën, privatësinë e të dhënave dhe sigurinë kibernetike.
- Mbështetja e AMF-së në punën për zhvillimin e tregjeve të kapitalit, nëpërmjet ndërgjegjësimit dhe edukimit financiar

Gjatë vitit 2022, Autoriteti organizoi dy konferenca ndërkombëtare mbi nevojën e diversifikimit të sistemit financiar përmes zhvillimit të tregjeve të kapitalit, si edhe zhvillimin e financave të gjelbra në Shqipëri, në kuadër të ndërgjegjësimit dhe rritjes së njohurive financiare. Në këto konferenca morën pjesë përfaqësues të lartë nga qeveria, institucionet financiare ndërkombëtare, bankat dhe institucionet financiare në vend, përfaqësues të dhomave ekonomike, dekanë dhe profesorë të universiteteve, etj.

Në konferencën “Diversifikimi i sistemit financiar përmes reformave të tregut të kapitaleve” u diskutua mbi rolin e institucioneve financiare në forcimin e stabilitetit, diversifikimin e tregjeve financiare, si edhe mundësitë e shfrytëzimit të potencialeve të tregjeve të kapitalit në funksion të zhvillimit ekonomik të vendit. Ndërsa në fokus të konferencës ndërkombëtare “Financat e Gjelbra – Mundësi për sektorin financiar në Shqipëri” ishte diskutimi mbi perspektivat, mundësitë dhe rëndësinë e financave të gjelbra drejt një zhvillimi ekonomik të qëndrueshëm.

Projekti “Përmirësimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare – BB/ SECO - II: “Fokus Zhvillimi i Tregut të Fondeve të Pensioneve Private”

Në kuadër të asistencës teknike të projektit “Përmirësimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare BB/SECO – II”, ekspertët e Bankës Botërore rishikuan projektligjin për fondet e pensioneve private të përgatitur nga AMF dhe dhanë rekomandime për çështje teknike lidhur me stimujt për të rritur pjesëmarrjen në fondet e pensioneve vullnetare, trajtimin e skemave të pensioneve profesionale, politikat e investimit, alternativat e pagesave, etj.

Projektligji është diskutuar me shoqëritë administruese të fondeve të pensioneve dhe aktorë të tjerë dhe ka kaluar fazën e konsultimit publik, duke vijuar procedurën ligjore të miratimit të tij. Në dhjetor 2022 projektligji u miratua nga Këshilli i Ministrave dhe pritet të miratohet gjatë vitit 2023 nga Kuvendi i Shqipërisë.

Projekti “Përmirësimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare – BB/ SECO - II: “Fokus Zhvillimi i Tregut të Sigurimeve”


Në fushën e sigurimeve, konsulentët e projektit në bashkëpunim me grupin e punës në AMF, kanë punuar në drejtim të:

- Përmirësimin të metodologjisë me bazë rreziku

Autoriteti punoi për përmirësimin e metodologjisë mbikëqyrëse me bazë rreziku, duke rishikuar treguesit e paralajmërimit të hershëm, në funksion të vlerësimit të profilit të rrezikut në nivel shoqërie dhe tregu. Qëllimi është ndërtimi i një sistemi mbikëqyrës efektiv, ku treguesit e paralajmërimit të hershëm të mundësojnë shpërndarjen efektive të burimeve të Autoritetit, adresimin në kohë të problematikave dhe parandalimin në fazë të hershme të problemeve financiare të shoqërive të sigurimit.

Metodologjia e mbikëqyrjes me bazë rreziku përfshin tregues shtesë dhe do të zbatohet nëpërmjet një moduli interaktiv, i cili përmbledh:

- Përfshirjen e treguesve dhe të referencës për tregun (benchmarks), analizën shtesë të të dhënave të tregut;
- Strukturimin dhe standardizimin e matricës së rrezikut për vlerësimin e rrezikut në nivel shoqërie; si dhe
- Përfshirjen e spektrit të rrezikut për të gjithë tregun e sigurimit Jo-Jetë.



- Hartimit të një Udhërrëfyese për zbatimin e regjimit mbikëqyrës Solvency II

Kalimi drejt regjimit të mbikëqyrjes Solvency II, i cili krijon një sistem modern të bazuar mbi rrezikun, pritet të sjellë avantazhe konkurruese për siguruesit, të kontribuojë në zhvillimin e sektorit të sigurimeve, si dhe të promovojë më tej rolin e sigurimeve në ekonominë e vendit.

Sipas udhërrëfyesit, nga momenti i fillimit të aplikimit të tij, deri në zbatimin e plotë të regjimit Solvency II, planifikohet një periudhë shtatë vjeçare. Aktivitetet përgatitore planifikohen të shtrihen në pesë vjet, ndërkohë që viti i gjashtë planifikohet për miratimin e rregulloreve dhe do të shërbejë gjithashtu si një vit ushtrimor, ku siguruesit do të raportojnë sipas Solvency II. Objektiv është fillimi i implementimit të regjimit Solvency II në vitin e shtatë.

- Zhvillimit të një moduli mbi cilësinë dhe performancën e shoqërive të sigurimit, lidhur me trajtimin e dëmeve nga sigurimi i detyrueshëm motorik, me qëllim rritjen e transparencës dhe besimit të konsumatorëve në tregun e sigurimeve.
- Përmirësimit të kuadrit ligjor e rregullator dhe procedurave të falimentimit e likuidimit të shoqërive të sigurimit
- Rishikimit të kornizës rregullatore në lidhje me mbikëqyrjen e grupeve të sigurimit
- Mbështetje në kuadër të procesit të vlerësimit të përputhshmërisë së praktikave mbikëqyrëse të AMF-së kundrejt standardeve ndërkombëtare të sigurimeve (ICP).

4.4 Bashkëpunimi me Institucionet e Vendit

AMF ka vijuar bashkëpunimin me **Bankën e Shqipërisë** edhe përgjatë vitit 2022, si në projekte të përbashkëta, ashtu edhe në vijim të bashkëpunimeve ekzistuese. AMF është anëtare e Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar (GKSF) së bashku me Bankën e Shqipërisë dhe Ministrinë e Financave. AMF ka vijuar komunikimet me Bankën e Shqipërisë edhe në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Edukimin Financiar. Të dy institucionet po punojnë për hartimin e iniciativave të përbashkëta për rritjen e edukimit dhe përfshirjes financiare. Gjithashtu AMF dhe Banka e Shqipërisë kanë zhvilluar inspektime të përbashkëta të subjektet nën mbikëqyrje.

AMF ka qenë pjesëmarrëse në takimet për Komitetin Kombëtar të Sistemit të Pagesave, KKSP, i cili synon të mbështesë dhe të kontribuojë në rritjen e sigurisë, qëndrueshmërisë dhe efikasitetit të sistemit kombëtar të pagesave në Shqipëri.

Autoriteti ka vijuar bashkëpunimin me **Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë** me qëllim finalizimin e një dokumenti politikash për zhvillimin e tregut të kapitaleve. Dokumenti strategjik 5-vjeçar synon promovimin dhe zhvillimin e tregjeve të kapitalit, duke synuar njëkohësisht edhe mbështetjen dhe rritjen e qëndrueshme ekonomike.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional në funksion të rregullimit të tregjeve nën mbikëqyrje gjatë vitit 2022, ka vijuar komunikimin me **Autoritetin e Konkurrencës**.

Autoriteti dhe **Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP)** kanë vijuar edhe gjatë vitit 2022 bashkëpunimin, përmes inspektimeve të përbashkëta dhe shkëmbimit të informacionit për tregjet dhe subjektet nën mbikëqyrje.



5.1 Mbrojtja e Konsumatorit dhe Investitorit

AMF edhe gjatë vitit 2022 ka vijuar punën për përmbushjen e objektivave të saj në drejtim të mbrojtjes konsumatore, duke u fokusuar kryesisht në:

- Shqyrtimin e ankesave të konsumatorëve apo investitorëve, lidhur me trajtimin e çështjeve dhe problematikave të tyre nga subjektet e mbikëqyrura nga Autoriteti;
- Monitorimin e veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë aktivitet në tregjet nën mbikëqyrje, për të siguruar transparencë në shërbimet e ofruara konsumatorit/investitorit, respektimin e të drejtave dhe interesave të tyre sipas parashikimeve ligjore në fuqi;
- Rritjen e ndërgjegjësimit për rreziqet që lidhen me investimet në instrumente financiare, për të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të mbikëqyrura dhe përdoruesve të shërbimeve të tyre;
- Edukimin e vazhdueshëm të përdoruesve të shërbimeve financiare duke përfshirë dhënien e informacionit përkatës në faqen e internetit, publikimin e rregulloreve përkatëse, tekste edukative, buletine, manuale dhe të dhënat mbi performancën e subjekteve të mbikëqyrura;

Shqyrtimi dhe trajtimi i ankesave të konsumatorëve dhe investitorëve


Trajtimi i ankesave të konsumatorëve është një pjesë e rëndësishme e aktiviteteve të Autoritetit. Kjo i shërben jo vetëm informimit mbi problematikat në mënyrën e trajtimit të rasteve të sigurimit nga subjektet e mbikëqyrura nga Autoriteti, por kontribuon edhe në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve financiare për tregjet nën mbikëqyrje.

Gjatë vitit 2022 Autoriteti ka trajtuar 173 ankesa dhe pas ndërhyrjes së Autoritetit janë zgjidhur rreth 67% e tyre.

Tregu i sigurimeve dominon me 95% të numrit të ankesave dhe sigurimi TPL është segmenti me numrin më të madh të ankesave, me 80% të numrit total. Autoriteti ka trajtuar gjithashtu ankesa që kanë të bëjnë me sigurimin e pronës, ku në krahasim me vitin 2020 dhe 2021, vitet pas tërmetit, vihet re një reduktim i ankesave të depozituara për vitin 2022, me vetëm 5 ankesa, kundrejt 12 ankesa që ishin në vitin 2021 dhe 33 që ishin në vitin 2020 për këtë kategori.

Grafik 27: Ankesat sipas llojit të sigurimit


(Në numër)



Në ankesat e depozituara mbizotërojnë ato me objekt dëmin material në masën 81% të totalit të ankesave, e ndjekur nga ankesat me objekt dëmin shëndetësor në masën 13% të totalit të ankesave.

Grafik 28: Ankesat sipas llojit të dëmit

(Në %)






Shkaqet kryesore të ankesave gjatë vitit 2022 ishin:

- Refuzimi i kërkesës për dëmshpërblim;
- Vonesë e pagesës së dëmshpërblimit;
- Vonesë e trajtimit të kërkesës për dëmshpërblim;
- Pretendime për vlerën e dëmshpërblimit;
- Shkaqe të tjera.

Grafik 29: Ankesat sipas arsyes së ankimit

(Në %)



Ankesat me objekt vonesën e pagesës së dëmshpërblimit dominojnë me 39% të numrit total të ankesave, ndjekur nga ankesat me objekt vonesë në trajtimin e kërkesës për dëmshpërblim me 20% të numrit total të ankesave.

5.2 Monitorimi i Ndërmjetësve Financiarë

Monitorimi i ndërmjetësve në tregun e sigurimeve

Gjatë vitit 2022, AMF ka monitoruar rast pas rasti nëpërmjet raportimeve periodike, apo verifikimeve në vend, zbatimin e kërkesave ligjore dhe rregullatore të aktivitetit të agjentëve/punonjësve, kryesisht të atyre që ushtrojnë veprimtarinë e shitjes së policave të sigurimit të detyrueshëm TPL, si dhe shoqërive të brokerimit në sigurime. Pjesë e këtyre verifikimeve ka qenë edhe shqyrtimi i ankesave të depozituara në Autoritet.

AMF ka kryer analizën e pasqyrave financiare të ndërmjetësve në sigurime, me qëllim monitorimin në vazhdimësi të treguesve kryesorë të aktivitetit. Kështu, janë monitoruar tregues si kapitali, fondi i garancisë, mjetet monetare, rezultati financiar i aktivitetit, si dhe është bërë krahasimi me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm i të ardhurave nga ndërmjetësimi. Këto rezultate i janë vënë në dispozicion edhe Bordit të Autoritetit.

Gjithashtu janë kryer dhe inspektime në vend pranë:

- Një shoqërie brokerimi në sigurime;
- Pesë agjentëve individë në sigurime, nisur nga ankimet e depozituara në Autoritet.

Inspektimet kishin në fokus kushtet teknike dhe organizative të këtyre shoqërive, kryesisht infrastrukturën për kryerjen e veprimtarisë, si dhe respektimin e kërkesave ligjore e rregullatore në fuqi. Pas mangësive të konstatuara nga mbikëqyrja në vend, Bordi i Autoritetit mori masat përkatëse ndaj subjekteve.


Monitorimi i ndërmjetësve të tregut të kapitaleve

Përveç monitorimeve të kryera nëpërmjet raportimeve periodike 3-mujore, gjatë vitit 2022, AMF zhvilloi inspektime në vend pranë një shoqërie, agjent i lidhur në tregjet e kapitalit. Nisur nga rezultati i inspektimit si dhe për arsye të ndërprerjes së kontratave me shoqëritë komisionere, Bordi i Autoritetit, vendosi pezullimin e aktivitetit dhe heqjen e njohjes dhe çregjistrimin e të gjithë agjentëve të lidhur.

5.3 Edukimi Financiar

AMF e vlerëson edukimin financiar si një proces mjaft të rëndësishëm për rritjen e besimit të konsumatorit në tregjet financiare dhe është angazhuar në veprime konkrete.

Bazuar në kalendarin vjetor të aktiviteteve, Autoriteti ka zhvilluar trajnime për kualifikim profesional dhe edukim në vazhdim për profesionistët e tregjeve nën mbikëqyrje, për të kontribuar në ofrimin e produkteve dhe shërbimeve të cilësisë së lartë për konsumatorët dhe zhvillimin e mëtejshëm. AMF ka zhvilluar trajnime për kualifikim profesional dhe edukimin në vazhdim për vlerësues dëmsh në sigurime. Gjithashtu, për edukimin në vazhdim të profesionistëve në tregun e sigurimeve u zhvillua një trajnim për broker në sigurime.



Autoriteti ka shtrirë bashkëpunimin institucional me shoqatat e profesionistëve të tregjeve nën mbikëqyrje, duke synuar një përgatitje profesionale sa më cilësore të kapaciteteve njerëzore në fushën e tregjeve financiare jobankare.

Gjithashtu, Autoriteti ka vijuar me përditësimin e faqes zyrtare me informacione të dobishme për publikun në funksion të thellimit të njohurive të tij financiare, duke ndihmuar konsumatorët, prodhuesit dhe investitorët të marrin vendime financiare të kujdesshme.

Në kuadër të edukimit financiar të të rinjve në fushën e tregut të kapitaleve, AMF bashkëpunoi me organizatën *German Sparkassenstiftung Albania*, për realizimin e projektit “Të mësojmë për Bursën”. Ky ishte viti i dytë i zhvillimit të këtij konkursi me pjesëmarrjen e skuadrave të studentëve nga fakultetet e ekonomisë të universiteteve. Skuadrat studentore, së bashku me pedagogët e tyre, morën pjesë në bursën e titujve, një platformë virtuale tregtimi, duke përdorur fonde virtuale në tregtimin e instrumenteve financiarë. Ky konkurs dhe transaksionet në bursë, u japin studentëve njohuri se si funksionon tregtimi në tregjet financiare ndërkombëtare.

Gjatë vitit 2022 Autoriteti zhvilloi dy konferenca ndërkombëtare me pjesëmarrje të gjerë në nivel të lartë, duke synuar edukimin financiar dhe ndërgjegjësimin e publikut. Konferencat u zhvilluan si pjesë e projektit “Përmirësimi i Kapaciteteve Mbikëqyrëse të AMF-së”, me fokus Tregjet e Kapitalit.

Konferenca ndërkombëtare “Diversifikimi i sistemit financiar përmes reformave të tregut të kapitaleve” - 19 maj 2022, Tiranë

Kjo ishte konferenca e parë ndërkombëtare për tregjet e kapitalit e zhvilluar në Shqipëri. Në të morën pjesë ekspertë ndërkombëtarë, përfaqësues të institucioneve të huaja financiare, autoritetet rregullatorë homologe në Evropë, bankat dhe institucionet financiare në vend, përfaqësues të qeverisë dhe drejtues të tjerë institucionesh, profesorë dhe studiues në fushën e ekonomisë.

Konferenca shërbeu si një platformë dialogu mes aktorëve kryesorë në vend, institucioneve financiare ndërkombëtare dhe eksperiencave nga autoritetet mbikëqyrëse, për të intensifikuar përpjekjet e përbashkëta drejt shndërrimit të tregjeve të kapitalit në një alternativë të qëndrueshme financimi përkundrejt burimeve tradicionale.

Konferenca hapi debatin për mundësitë e zhvillimit të shpejtë dhe progresiv për tregun e kapitalit në Shqipëri, me synimin për të shfrytëzuar potencialin e tregut të kapitalit dhe për t'i vëmë ato në funksion të zhvillimit ekonomik të vendit.

Në panelin e parë të konferencës Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë dhe Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së diskutuan mbi rolin e institucioneve financiare në Shqipëri për forcimin e stabilitetit dhe mundësitë e shfrytëzimit të potencialeve të tregjeve të kapitalit në funksion të zhvillimit ekonomik të vendit.

Po kështu në panelin e dytë dhe të tretë nga përfaqësuesit e institucioneve ndërkombëtare dhe rregullatorëve financiare në rajon ofruan këndvështrime dhe perspektiva të zhvillimit të tregjeve financiare dhe diversifikimin e tyre, si dhe sfidat e përafritit të legjislacionit me direktivat evropiane për tregjet e kapitalit.

Konferenca Ndërkombëtare “Financat e gjelbra – Mundësi për sektorin financiar në Shqipëri” - 16 nëntor 2022, Tiranë

Konferenca diskutoi perspektivat, mundësitë dhe rëndësinë e orientimit të financave të gjelbra drejt një zhvillimi ekonomik të qëndrueshëm. Aktiviteti shërbeu si një forum diskutimi me synim promovimin e rolit të sektorit financiar për një ekonomi të qëndrueshme dhe nxitjen e financave të gjelbra, rritjen e ndërgjegjësimit për efektet financiare dhe ekonomike të ndryshimeve klimatike dhe rreziqet që lidhen me faktorët mjedisorë, socialë dhe të qeverisjes korporative.

Në panelin e parë, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Zëvendësguvernatorja e Parë e Bankës së Shqipërisë diskutuan mbi perspektivat, mundësitë dhe rëndësinë e orientimit të financave të gjelbra për zhvillim ekonomik të qëndrueshëm. Gjithashtu, në konferencë, përfaqësues nga organizatat ndërkombëtare dhe institucionet financiare ndanë eksperiencat e tyre në lidhje me planet dhe politikat ESG (mjedisore, sociale dhe korporative), praktikatat e ndjekura për financimet e gjelbra dhe sfidat për të ardhmen.



5.4 Transparenca dhe Marrëdhëniet me Publikun


Komunikimi përmes faqes web ka qenë një nga format kryesore të përdorura në komunikimin publik të Autoritetit. Gjatë vitit 2022 kërkimi i informacioneve në faqen *online* të AMF-së ka arritur në 542.127 klikime. Faqja tërheq gjithnjë vizitorë të rinj. Mesatarisht një vizitor në faqe shikon më shumë se 3 nënseksione të saj, me një kohëzgjatje mesatare rreth 2 minuta për secilin nënseksion.

Faqja *online* e AMF-së është lehtësisht e aksesueshme në formatet e ndryshme teknologjike. Këtë e tregojnë edhe shifrat e klikimeve *online*, sipas të cilave rreth 69% e përdoruesve të faqes e kanë aksesuar atë nga desktop, ndërsa pjesa tjetër, e kanë vëzhguar faqen *online* nga aparatet e telefonisë celulare.

Duke ju referuar informacioneve të publikuara në faqen *online*, pjesa më e madhe e përdoruesve kërkojnë informacione lidhur me sigurimin e detyrueshëm motorik dhe ecurinë e pagesave të dëmeve, me kuadrin ligjor, rregulloret, vendimet e miratuara nga AMF, si edhe direktivat e ndryshme.

Grafik 30: Struktura e klikimeve në faqen *online* të AMF-së, 2022

(Në %)



Për t'i shërbyer edhe investitorëve apo analistëve të huaj, faqja *online* e AMF-së është e organizuar në dy gjuhë, shqip dhe anglisht. Të dyja formatet e faqes japin informacion për strukturën dhe zhvillimin e tregjeve financiare të sigurimeve, pensioneve private, fondeve të investimeve dhe letrave me vlerë në Shqipëri.

Faqja vizitohet edhe nga vizitorë jashtë vendit dhe pjesa më e madhe e tyre janë nga vende si Gjermania, SHBA, Mbretëria e Bashkuar, Italia, Franca, Kroacia, Kosova dhe Maqedonia e Veriut, etj.

Botimet e AMF-së të realizuara në vitin 2022

- Buletini Zyrtar
- Raporti Vjetor
- Raporti i Mbikëqyrjes
- Gjeografia e Sigurimeve

Publikime elektronike të AMF-së

- Periodiku mujor informativ
- Buletini Statistikor i tregut të sigurimeve
- Buletini Statistikor i tregut të letrave me vlerë
- Buletini Statistikor i tregut të pensioneve private vullnetare
- Buletini Statistikor i tregut të fondeve të investimeve



6.1 Burime Njerëzore


Në përputhje me objektivat strategjike afatmesëm të Autoritetit, administrimi i kapaciteteve njerëzore është fokusuar në përvetësimin dhe zbatimin në vazhdimësi të praktikave më të mira të menaxhimit të burimeve njerëzore.

Ndjekja e politikave për punësimin e profesionistëve me përvojë, promovimi në karrierë i stafit, si dhe një organizim strukturor efikas dhe fleksibël, mbeten në vijimësi prioritet i institucionit. Gjatë vitit 2022, përmes procedurave të konkurrimit të brendshëm, punonjës të Autoritetit janë promovuar në pozicione më të larta pune.

Në kuadër të rikonceptimit dhe të rolit të disa njësive të Autoritetit, u realizuan disa ndryshime të strukturës organizative, me qëllim përmirësimin dhe forcimin e disa proceseve të punës dhe përshtatjen më të mirë të strukturave të këtyre njësive të Autoritetit me detyra specifike.

Grafik 31: Ndarjet funksionale sipas departamenteve


(Në %)



Gjithashtu, një kujdes i veçantë i është kushtuar edhe ruajtjes së raportit të stafit profesional me përvojë me stafin e ri. Përfaqësimi gjinor në Autoritet, raporti burra-gra është 23% kundrejt 77% dhe mosha mesatare e stafit është 41 vjeç.

Grafik 32: Struktura e punonjësve të AMF-së sipas grupmoshës


(Në numër)



Kualifikimi profesional

Autoriteti është angazhuar në nxitjen e një kuadri vlerash për të zhvilluar dhe orientuar kapacitetet njerëzore, me qëllim rritjen e ekspertizës profesionale. Përmes politikave për rritjen e motivimit, është synuar ruajtja e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë së stafit, si një ndër objektivat kryesore në kuadër të menaxhimit të burimeve njerëzore.

Aktivitetet trajnuese kanë qenë të kombinuara (në distancë dhe në vend) dhe janë përqendruar në trajnimin e punonjësve të rinj, si dhe të punonjësve me njohuri të të avancuara në fushën e tregjeve financiare. Gjatë vitit, rreth 53% e stafit teknik ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese. Trajnimet e stafit janë realizuar përmes aktiviteteve brenda dhe jashtë vendit, të organizuara kryesisht nga autoritetet homologe, institucione financiare ndërkombëtare si dhe nga shoqatat ndërkombëtare të rregullatorëve. Gjithashtu, për forcimin e kapaciteteve mbikëqyrëse, stafi i Autoritetit ka marrë pjesë në aktivitete të ndryshme në kuadër të projekteve të bashkëpunimit.



6.2 Sistemet e Teknologjisë së Informacionit

Gjatë vitit 2022, Autoriteti ka kryer zhvillime në infrastrukturën e teknologjisë së informacionit si dhe përmirësime të aplikacioneve ekzistuese duke rritur sigurinë kibernetike. Këto përmirësime janë bazuar në punën e planifikuar si edhe në nevojat e tregjeve nën mbikëqyrje dhe duke i ardhur në ndihmë shoqërive dhe konsumatorit në ofrimin e shërbimit, ankesave dhe trajtimit të tyre *online*.

Aktivitetet kryesore gjatë vitit 2022 përfshijnë, si më poshtë:

- Ndjekja dhe zbatimi i politikave të sigurisë së informacionit, duke ruajtur konfidencialitetin, integritetin dhe besueshmërinë e informacioneve të AMF-së;
- Përmirësim i mëtejshëm i analizave dhe funksioneve të sistemit të raportimit *online*;
- Analizimi i sistemeve digjitale në ofrimin sa më të thjeshtë të informacionit ndaj palëve të treta si dhe monitorimi e përmirësimi i raportimit të ankesave *online*;
- Zhvillimi i mëtejshëm i sistemit të raportimit financiar për tregun e fondeve të investimeve dhe pensione;
- Ngritja e Komitetit të Sigurisë Kibernetike, i cili rregullisht rishikon masat që duhen ndërmarrë për mbrojtjen nga sulmet kibernetike;
- Rritja e sigurisë kibernetike duke implementuar antivirus të qendëruar në Cloud server, i cili përfshin mbrojtjen nga Malware, Ransomware, System and application Patch, IP blacklists, Hash blacklists, firewall USB storage controls për çdo përdorues në institucion;
- Përditësimi i faqes zyrtare *online* të AMF-së me shërbime të reja për publikun, si dhe përmirësimin e rubrikës së transparencës;
- Mirëmbajtja dhe përmirësimi i rrjetit kompjuterik qendror në AMF, si dhe në sistemet e ruajtjes pranë AKSHI (backup).

Digjitalizimi i shërbimeve në portalin e-Albania

Shërbimet *online* nga portali www.e-albania.al

Në kuadër të digjitalizimit të shërbimeve, gjatë vitit 2022, AMF ka reduktuar ndjeshëm kërkesat shkresore për shërbimet të cilat ofrohen elektronikisht, si:


- Verifikimi i policës së sigurimit motorik (MTPL, Karton Jeshil);
- Vërtetim i historikut të drejtimit të mjetit;
- Historiku i dëmeve të mjeteve motorike.


Sipas të dhënave statistikore përdorimi i shërbimeve elektronike është:

Portali www.e-albania.al

Peshën më të madhe të shërbimeve të marra nga qytetarët/subjektet e zë verifikimi i policës së sigurimit motorik (MTPL, Karton Jeshil) me 52 % nga totali i shërbimeve të përdorura, më pas vërtetim i historikut të drejtimit të mjetit me 33% dhe historiku i dëmeve të mjeteve motorike me 15 %.

Grafik 33: Shërbimet e ofruara nga portali E-Albania sipas kërkesave gjatë vitit 2022 (Në %)





Shërbimet e ofruara nga portali www.amf.gov.al

Përlllogaritësi i dëmeve

Përlllogaritësi i dëmeve ndaj personit, në rastet e aksidenteve nga mjetet motorike në sektorin e transportit, i prezantuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe i publikuar në faqen e tij zyrtare ka gjetur përdorim të zgjeruar gjatë vitit 2022.

Aplikacioni u zhvillua nga Autoriteti për t'i ardhur në ndihmë palëve përfituese, si edhe vetë ekspertëve të fushës në vlerësimin e dëmeve dhe trajtimin e kërkesave për dëmshpërblim. Përlllogaritësi bazohet në disa supozime, vlerat e përlllogaritura janë orientuese dhe synojnë të informojnë përdoruesit mbi masën e dëmshpërblimit në rastet e dëmit ndaj personit, me pasojë paaftësinë e përhershme për punë ose me pasojë vdekjen.

Verifikoni Policën tuaj

Në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit çdo policë e sigurimit të detyrueshëm motorik që shitet nga përfaqësues të autorizuar të shoqërive të sigurimit lëshohet nëpërmjet sistemit kompjuterik të lidhur *online* me AMF.

Verifikoni Historikun e Dëmeve të Mjetit

Shërbimi elektronik "Historiku i dëmeve" u mundëson qytetarëve marrjen e informacionit mbi rastet e përfshirjes në aksidente rrugore si shkaktar.

Të dhënat për dosjet e dëmeve gjenerohen nga Regjistri Elektronik *Online* i Dëmeve, sipas raportimit nga shoqëritë e sigurimeve, në përputhje me aktet nënligjore.

Verifikoni Statusin e Dosjes së Dëmit

Çdo person i dëmtuar, në proces dëmshpërblimi mund të kontrollojë *online* statusin e dosjes së tij të dëmshpërblimit për të ndjekur fazën në të cilën ndodhet dosja. Ky kontroll mundësohet nga vendosja e Kodit të Dëmit.


Depozito ankesën *online*

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit ka ofruar mundësinë e depozitimit *online* të ankesave dhe trajtimin e ankesave të personave të siguruar dhe investitorëve.

Gjatë vitit 2022, përdorimi i këtyre shërbimeve *online* është si më poshtë:

Grafik 34: Shërbimet e ofruara nga portali i AMF, www.amf.gov.al viti 2022


(Në %)



6.3 Auditimi i Brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm e ka orientuar aktivitetin në përmbushjen dhe realizimin e objektivave të përcaktuara në Planin Strategjik dhe Vjetor të miratuar me Vendim Bordi nr. 2, datë 31.01.2022. Njësia e Auditimit të Brendshëm ka funksionuar me një auditues të profilit të përgjithshëm financiar, si dhe një auditues të teknologjisë së informacionit. Veprimtaria audituese është bazuar në procedurat e auditimit të rregulluara në aktet ligjore në fuqi dhe në standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm.

Auditimi u përqendrua kryesisht në fushat e vlerësuara me nivel të lartë rreziku nga Njësia e Auditimit të Brendshëm. Cilësia e auditimit konsiderohet jo vetëm faktor i rëndësishëm në prezantimin e auditimit (raportit) dhe rezultateve të tij: opinionit, konkluzioneve, gjetjeve dhe rekomandimeve; por edhe në rritjen e përgjegjshmërisë së audituesve gjatë auditimit dhe njësive të audituara për zbatimin e rekomandimeve.



Angazhimet e auditimeve të kryera gjatë vitit 2022 janë fokusuar në dhënien e opinionit mbi mjaftueshmërinë e kontroleve të brendshme për funksionet dhe proceset e audituara, përfshirë dhe aplikacionet mbështetëse për kryerjen e aktiviteteve. Tregues kryesor i ndikimit të punës audituese është ndryshimi pozitiv që auditimi i brendshëm sjell nëpërmjet rekomandimeve mbështetur në një përjasje sistematike dhe të disiplinuar për vlerësimin dhe përmirësimin e efektivitetit të menaxhimit të rrezikut, kontrollit dhe proceseve.

STRATEGJI DHE OBJEKTIVA

Në mbështetje të Strategjisë së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare 2023-2027, gjatë vitit 2023 drejtimet kryesore të veprimtarisë së Autoritetit do të përqendrohen në objektivat e mëposhtme:

- Forcimi i stabilitetit financiar, rritja e efektivitetit të mbikëqyrjes dhe integritetit të tregjeve;
- Përafrimi i legjislacionit me standardet evropiane, zhvillimi dhe modernizimi i tregjeve;
- Mbrojtja e interesave të konsumatorit dhe investitorit;
- Zhvillimi i financimit të gjelbër dhe harmonizimi me praktikat evropiane;
- Digjitalizimi dhe përmirësimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit.

1. Forcimi i stabilitetit financiar, rritja e efektivitetit të mbikëqyrjes dhe integritetit të tregjeve

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare do të vijojë të kontribuojë në nxitjen e qëndrueshmërisë dhe zhvillimin e sigurt të tregjeve financiare nën mbikëqyrje, duke luajtur rol proaktiv në funksion të mirërregullimit dhe zhvillimit të këtyre tregjeve. Prioritet i Autoritetit do të jetë forcimi i mëtejshëm i funksionit të tij mbikëqyrës, duke zhvilluar dhe zbatuar mbikëqyrjen me bazë rreziku dhe përafrimi me standardet ndërkombëtare.

Autoriteti, me qëllim avancimin drejt standardeve më të mira ndërkombëtare në fushën e sigurimeve, do të finalizojë një vlerësim të plotë të përputhshmërisë së bazës ligjore dhe rregullatore, si dhe praktikave mbikëqyrëse të tij me Parimet Themelore Ndërkombëtare në Sigurime (ICP). Në bashkëpunim me ekspertët e Bankës Botërore, Autoriteti do të punojë për implementimin e udhërrëfyesit drejt regjimit evropian të mbikëqyrjes në sigurime, Solvency II, si angazhim i Shqipërisë në kuadrin e anëtarësimit në BE.

Do të synohet finalizimi dhe implementimi i strategjisë për zhvillimin e tregjeve të kapitalit, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Bankën e Shqipërisë, në drejtim të rritjes së pjesëmarrjes së emetuesve, zgjerimit të gamës së instrumenteve financiare, përmirësimit të eficiencës së tregut dhe zgjerimit të bazës së investitorit. Autoriteti do të vijojë mbikëqyrjen e kujdesshme të tregjeve dhe monitorimin e treguesve kryesorë financiarë të subjekteve nën mbikëqyrje.



2. Përafrimi i legjislacionit me standardet evropiane, zhvillimi dhe modernizimi i tregjeve

Në negociatat e anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, Autoriteti është institucioni drejtues i Kapitullit 9 “Shërbimet Financiare”. Përgjatë vitit në vijim, Autoriteti do vijojë me procesin e përafrimit të akteve ligjore dhe nënligjore me *acquis* të BE-së, duke marrë parasysh edhe rekomandimet e ekspertëve të Komisionit Evropian pas Takimit Bilateral të 13-14 shkurtit 2023 në Bruksel.

Autoriteti do të ndjekë në vijimësi procedurat parlamentare në lidhje me projektligjin “Për fondet e pensionit privat” dhe pas miratimit të ligjit do të vijojë me hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore në zbatim të tij. Projektligji është përafuar në një masë të konsiderueshme me Direktivën (BE) 2016/2341 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit datë 14 dhjetor 2016 “Për veprimtaritë dhe mbikëqyrjen e institucioneve të pensionit profesional (IORP II)”.

Në procesin e negociatave, Autoriteti do të vijojë të japë kontributin e tij si pjesë e grupeve ndër-institucionale për kapitujt e tjerë, pjesë e kriterit ekonomik. Avancimi legjislativ drejt standardeve evropiane mbështet zhvillimin e tregjeve nën mbikëqyrje, përmes krijimit të mundësive të reja, duke i modernizuar më tej këto tregje.

3. Mbrojtja e interesave të konsumatorit dhe investitorit

Autoriteti, duke patur si objektiv themelor mbrojtjen e konsumatorit dhe investitorit, do të vijojë punën në drejtim të rritjes së kërkesave për transparencë dhe informacion, sipas standardeve ndërkombëtare. Veprimtaria e AMF-së do të përqendrohet në zbatimin e kërkesave të sjelljes së tregut, të cilat konsiderohen të rëndësishme për zhvillim afatgjatë dhe të qëndrueshëm, duke siguruar mbrojtje të konsumatorit dhe investitorit.

Autoriteti në kuadër të strategjisë kombëtare për edukim dhe përfshirje financiare, do të bashkëpunojë me Bankën e Shqipërisë dhe institucione të tjera në vend, sa i përket nismave në funksion të edukimit financiar dhe rritjes së ndërgjegjësimit të publikut.

Autoriteti do të ketë në fokus aktivitetet e edukimit financiar, përmirësimin e sistemit të ankesave për konsumatorët dhe investitorët, si dhe përmirësimin dhe pasurimin e faqes zyrtare të AMF me informacione të dedikuara për publikun.

4. Zhvillimi i financimit të gjelbër dhe harmonizimi me praktikat evropiane

Zhvillimi i financimit të gjelbër dhe harmonizimi me praktikat evropiane në financat e gjelbra vlerësohen thelbësore për një ekonomi dhe sistem financiar të qëndrueshëm. Sektori financiar ka rol kyç në këtë drejtim, për të riorientuar investimet drejt teknologjive dhe bizneseve të gjelbra, si edhe për të financuar rritjen në një mënyrë të qëndrueshme dhe afatgjatë.

Autoriteti do të angazhohet që në bashkëpunim me institucione të tjera të ndërmarrë disa hapa konkretë në këtë drejtim, nisur edhe nga praktikat më të mira evropiane. Në koordinim me të gjithë aktorët do të synohet krijimi i një sistemi të unifikuar klasifikimi në linjë me praktikat evropiane përmes vendosjes së rregullave për taksonominë, nxitja dhe promovimi i emetimit të gjelbra, përfshirja e faktorëve mjedisorë, social dhe të qeverisje korporative (ESG) në bazën ligjore, si edhe promovimi dhe ndërmarrja e nismave ndërgjegjësuese për faktorët e gjelbër.


5. Digjitalizimi dhe përmirësimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit

Gjatë viteve të vijim, Autoriteti do të analizojë mundësinë e implementimit të teknologjive të reja, me qëllim përmirësimin e proceseve mbikëqyrëse dhe rregullatore, si dhe rritjen e sigurisë kibernetike.

Në këtë drejtim, do të vijohet me përmirësimin dhe zhvillimin e sistemeve të raportimit për tregun e fondeve të investimeve dhe të pensioneve private vullnetare, për tregun e sigurimeve, krijimin e një ndërfaqeje për regjistrin e shitjeve të produkteve të sigurimit të detyrueshëm motorik, si dhe zhvillimin e mëtejshëm të Regjistrin *Online* të Shitjeve dhe të Sistemit të Dëmeve, sipas dinamikave të tregut.

Zhvillimet e sistemeve të teknologjisë së informacionit do të shërbejnë për digjitalizimin e proceseve të raportimit, standardizimin dhe automatizimin e proceseve mbikëqyrëse, qasje në kohë reale në sistemet e subjekteve të mbikëqyrura, analizimin dhe menaxhimin e të dhënave të tregjeve nën mbikëqyrje në mënyrë efektive, si dhe për të ruajtur integritetin e tregut.

SHTOJCA A
STRUKTURA ORGANIZATIVE E AMF-SË, 2022



mazars

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (Institucioni) të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 dhjetor 2022, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në fondet e veta dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Institucionit më datën 31 dhjetor 2022, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).


Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Institucioni në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Institucionit për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të Institucionit, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart.



Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Institucionit.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënimet shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Institucionit për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin

shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Institucionit për vijimësi.

- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Institucionit, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

20 mars 2023

mazars
Emin Dyraku Str., Binjaket Build.,
No.5, 1013, Tirana, Albania
NUII: K32123006W



Teit Gjini
Auditues Ligjor



Më 31 dhjetor 2022

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
AKTIVE		
Aktivët afatgjatë		
Aktivët afatgjatë materiale	75,205,401	60,029,405
Aktivët afatgjatë jomateriale	19,503,615	26,015,998
Totali i aktiveve afatgjatë	94,709,016	86,045,403
Aktivët afatshkurtra		
Llogari të arkëtueshme	49,793,634	43,581,948
Paradhënie dhe të ardhura të përlogaritura	1,878,955	1,669,095
Garanci të dhëna	463,580	463,580
Investime në depozita dhe Bono Thesari	145,616,212	154,470,508
Mjetet monetare në arkë e në bankë	103,511,329	83,067,463
Totali i aktiveve afatshkurtra	301,263,710	283,252,594
Totali i aktiveve	395,972,726	369,297,997
KAPITALI		
Fonde bazë	119,287,505	119,287,505
Rezerva	180,287,000	174,328,000
Totali i kapitalit	299,574,505	293,615,505
DETYRIMET		
Detyrime afatgjatë		
Grante për asete	7,416,571	-
Totali i detyrimeve afatgjatë	7,416,571	-
Detyrime afatshkurtra		
Llogari të pagueshme	9,883,562	2,108,825
Detyrime për tatim taksa	7,933,913	7,814,082
Detyrime ndaj shoqërive të sigurimit	49,014,026	44,046,283
Të tjera të pagueshme	916,847	480,000
Fondi i provizionit	21,233,302	21,233,302
Totali i detyrimeve afatshkurtra	88,981,650	75,682,492
Totali i detyrimeve	96,398,221	75,682,492
Totali i kapitalit dhe detyrimeve	395,972,726	369,297,997

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 34, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave Gjithëpërfshirëse

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Nga njësi ekonomike publike dhe private financiare	317,818,423	296,525,582
Gjoha dhe kamatëvonesa, sekuestime e zhdëmtime	16,400,000	7,100,000
Total të ardhura	334,218,423	303,625,582
Shpenzime korrente	(245,744,898)	(233,701,000)
Mallra dhe shërbime të tjera	(58,172,301)	(48,765,295)
Kuota amortizimi dhe shuma të parashikuara	(16,611,118)	(17,950,407)
Total shpenzime	(320,528,317)	(300,416,702)
Të ardhura nga interesat e depozitave	1,596,724	882,440
Shpenzime nga këmbimet valutore	(9,327,830)	(3,751,320)
Fitimi/humbja para tatimit	5,959,000	340,000
Rezultati i vitit	5,959,000	340,000

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 34, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

